

Mars 2018
Numri: 120
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

ÇLIROJE VETEN!



TË
RINJ

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*


Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shoqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Shpëtoje prej pushtimit dorën, gjuhën, syrin, veshin, zemrën dhe mendjen tënde!.. Çliroje vetveten!..

Shikoje njëherë veten, a je me të vërtetë i pushtuar?

Shikoje njëherë dorën, gjuhën, syrin, veshin, zemrën dhe mendjen tënde!..

A janë të gjitha aftësitë e tua në harmoni me qëllimin e krijimit dhe a janë në të njëjtin drejtim? Apo mos ndoshta ndonjë prej gjymtyrëve të tua është hedhur tutje nga ndonjë furtunë?

Je në namaz, por pse nuk është edhe zemra jote aty? Përse po shëtit botën (në namaz)? Ke ardhur para Zotit tënd, por pse zemra dhe mendja jote ka mbetur jashtë në ndonjë vend tjetër?

Përse po e përdor gjuhën për të përgjatur një besimtar tjetër? A nuk po përmendje Zotin tënd pak më parë?..

Dora jote po i jep sadaka atij të varfrit, por përse zemra jote nuk të thotë, "ndal", ndërkohë që je duke zgjedhur atë më të pavlefshmen, duke të kujtuar fjalën e Allahut, *"...Mos dhuroni nga ato gjëra të pavlefshme të pasurisë suaj, të cilat ju nuk do t,i pranoni ndryshe veçse symbyllur..."*¹?

A e kupton se ku janë duke shikuar sytë e tu? A je i mprehtë në dallimin midis shikimit hallall dhe atij haram?

Ai (Allahu) është me ty, po ti më ke je?

Besimtari është njeri që e ka të njëjtë botën e brendshme dhe të jashtme. Besimi është çështje vendosmërie. Çështja e "dominimit të besimit në zemër", për të cilën flitet në Kuran, shpreh plotësimin e kësaj vendosmërie. Dhe kjo, është një fazë shumë më e avancuar se sa faza e hyrjes në kuadrin e Islamit. Ky është një Islam për të cilin është dhënë mund, mbi të cilin është dridhur, i cili nuk është lejuar të marrë plagë dhe që dendësia e tij në zemër ka depërtuar deri në kapilarët e gjakut.

Të tregosh kujdes të mos shkelësh mbi gjemba kur je duke ecur në një rrugë me ferra. Në kohën tonë, kur shejtani tashmë posedon edhe institucione gjigande, mbase duhet të ecim edhe në rrugë të minuar. Mirëpo, duhet të kemi sukses të kalojmë në këto fusha të minuara për ta çuar këtë amanet tek Krijuesi me "faqe të bardhë". Por, të ikësh me faqe të bardhë, nuk do të thotë të lëmë çdo pjesë të personaliteti tonë në këtë fushë të minuar.

Ne duhet të mendojmë mirë se çfarë përgjigje do të japim nëse Zoti ynë na pyet: "ku e le zemrën?", "Ç,është kjo mendje e plagosur?", "Përse në sytë e tu ka papastërti gjynahesh?", "Përse kanë ecur këmbët e tua në gjurmët e shejtanit?", "Përse në duart e tua ka gjurmë padrejtësie?" dhe "Përse në gjuhën tënde gjendet gjaku i vëllait tënd të vdekur?".

Duhet të shohim veten!


Duhet të shohim se në cilën fushë të personalitetit tonë dhe si ka ndodhur pushtimi.

Duhet të llogarisim vetveten pa ardhur dita e llogaridhënies.


Prej çdo Meke të çdo kohe, dalin edhe Medina. Ata që kapërcejnë Mekën, e çlirojnë atë. Ata që çlirojnë vetveten, çlirojnë edhe Mekën.

1. - Bekare, 267.

Përmbajtja



- 5 Çlirto vetveten
Ahmet Tashgetiren
- 10 Pastrimi prej çdo gjëje përveç Allahut
Prof. dr. Sulejman Derin
- 12 Çliruesi i zemrave
Salih Zeki Meriç
- 14 Ka kader s'ka qeder
Ali Riza Temel
- 17 Jeta që nuk vihet në pyetje
nuk është jetuar!
Mehmet Bash
- 18 Mbi suren Inshirah...
Prof. dr. Irfan Gyndyz
- 22 Lutfi Pasha
Dr. Ardian Muhaj
- 26 Pyetjet në suren Mulk
Xhafer Durmush



- Islami dhe shkenca 28
Xhihan Tashtan
- Pyetjet më të mëdha të gjithësisë 29
Muaz Erdem
- Një Ajet 30
- Një Hadith 32
- El-Fettah 40
Ilir Hoxha
- Refleksione -1 42
Nuredin Nazarko
- Rib'i ibn Amr el-Ensari 44
Mustafa Erish
- Urtësi 47
- Vlera e përmendjes së Allahut 48
Ferid Piku
- Dhikri, mendimi dhe meditimi 51
M. Sami Ramazanollu



Çliro vetveten

— Ahmet Tashgetiren —

*Si besimtarë që jemi,
kur e shohim veten, vëmë re
dobësi zemre dhe plagë brenda
e jashtë nesh. Diçka ka hyrë në
syrin tonë dhe nuk punon në
harmonitë me veshin, mendjen
dhe zemrën tonë. Njëri
fluturon në një botë, e tjetri
në një botë tjetër... Syri ynë
shkëputet prej zemrës sonë dhe
herë-herë, prej syrit përçohet
ndotje në zemër...*

Shpëtoje prej pushtimit dorën, gjuhën, syrin, veshin, zemrën dhe mendjen tënde!.. Çliroje vetveten!..

Shikoje njëherë veten, a mos je i pushtuar?

Shikoje njëherë dorën, gjuhën, syrin, veshin, zemrën dhe mendjen tënde!..

A janë të gjitha aftësitë e tua në harmoni me qëllimin e krijimit dhe a janë në të njëjtin drejtim? Apo mos ndoshta ndonjë prej gjymtyrëve të tua është hedhur tutje nga ndonjë furtunë?

Je në namaz, por pse nuk është edhe zemra jote aty? Përse po shëtit botën (në namaz)? Ke ardhur para Zotit tënd, por pse zemra dhe mendja jote ka mbetur jashtë në ndonjë vend tjetër?

Përse po e përdor gjuhën për të përgojuar një besimtar tjetër? A nuk po përmendje Zotin tënd pak më parë?..

Dora jote po i jep sadaka atij të varfrit, por përse zemra jote nuk të thotë, “ndal”, ndërkohë që je duke zgjedhur atë më të pavlefshmen, duke të kujtuar fjalën e Allahut, “...Mos dhuroni nga ato gjëra të pavlefshme të pasurisë suaj, të cilat ju nuk do t’i pranoni ndryshe veçse symbyllur...”¹?

A e kupton se ku janë duke shikuar sytë e tu? A je i mprehur në dallimin midis shikimit hallall dhe atij haram?

Ai (Allahu) është me ty, po ti më ke je?

Besimtari e ka të njëjtë botën e brendshme dhe të jashtme.

Besimi është çështje vendosmërie.

Çështja e “dominimit të besimit në zemër”, për të cilën flitet në Kuran, shpreh plotësimin e kësaj vendosmërie. Dhe kjo, është një fazë shumë më e avancuar se sa faza e hyrjes në kuadrin e Islamit. Ky është një Islam për të cilin është dhënë mund e djesë, i cili nuk është lejuar të marrë plagë dhe që dendësia e tij në zemër ka depërtuar deri në kapilarët e gjakut.

1. - Bekare, 267.

Ai është rezistent ndaj të gjitha hileve të shejtanit.

“Egoja” brenda nesh, që quhet “nefs”, në vend që t’i japë kredi shejtanit, përjeton kënaqësinë si rezultat i vetëdijes se ndodhet bashkë me Allahun dhe ka pjekurinë e duhur për të refuzuar “të gjitha ndyrësitë e shejtanit”.

Mirëpo, si besimtarë që jemi, kur e shohim veten, vëmë re dobësi zemre dhe plagë brenda e jashtë nesh. Diçka ka hyrë në syrin tonë dhe nuk punon në harmoni me veshin, mendjen dhe zemrën tonë. Njëri fluturon në një botë, e tjetri në një botë tjetër... Syri ynë shpëputet prej zemrës sonë dhe herë-herë, prej syrit përçohet ndotje në zemër...

Para shumë vitesh, poeti i famshëm Mehmet Akif Ersoj, bën një evidentim të tillë në lidhje me botën islame:

“As ndjenja, as lëvizje, as dhimbje... mos je gjë kufomë?”

Po më çudit... Ti nuk ke qenë kështu!”

Ti nuk ke qenë kështu. Vallë si e ke hallin tani?

Ti nuk duhej të ishe kështu, nuk duhet të jesh!

Sikur ka plasur ndonjë bombë dhe njerëzit tanë e kanë humbur tërësinë. Në fakt, nëse e vëmë gjendjen tonë në laboratorin e analizave, do ta shohim edhe vetë se në çfarë gjendje jemi.

Mirëpo, kemi arsyetimet tona!..

Na kanë dobësuar dhe kushtet na kanë sjellë në këtë gjendje. Vërtetë, pak a shumë nga jashtë jemi në një rrethim që të kujton periudhën e Mekës. Të jesh besimtar, kërkon një rezistencë të fortë, sa “të mund të mbash prush në dorë”.

Në fakt, edhe Islami vjen duke kapërcyer vazhdimisht periudhat e Mekës. Islami e çau atë rrethim dhe arriti deri tek ne... Pastaj, në cilën kohë

nuk është përjetuar ndonjë fragment i periudhës së Mekës?... Mbase çdo kurth i shejtanit me të cilin përballemi është një “fragment i periudhës së Mekës”.

E gjithë çështja është tek formimi i rezistencës së brendshme.

Besimtarët e parë të Islamit u pajisën në mënyrë të atillë me besim, sa që në zemrat e tyre u krijua një rezistencë e brendshme dhe ata rezistuan.

E vërtetë, jashtë sillet vërdallë lloj- lloj djallëzie e shejtanit. Ai e sulmon njeriun me kalorësinë, këmbësorinë, ushtrinë dhe mediat e tij për t’ia bllokuar atij rrugët për tek Allahu dhe ta bëjë robin e tij.

E vërtetë, nuk është e lehtë të ruash syrin, veshin, zemrën dhe mendjen. Por duhet ditur se, ndikimi i faktorëve të jashtëm, vjen si shkak i formimit të lidhjes së tyre me brendësinë tonë. “Nefsi/egoja” jonë, u përgjigjet vërshimeve që vijnë nga jashtë si një “agent i brendshëm” dhe u përgatit atyre truallin brenda nesh.

Në të njëjtën mënyrë, edhe “dëshirat e ulëta” bashkëpunojnë me egon dhe bëhen shkak që faktorët e jashtëm të na brejnë përbrenda, të zënë fole aty dhe si përfundim të të bëjnë të varur pas vetes.

Siç shprehet edhe vet Allahu, “dëshira” është një lloj prirjeje brenda njeriut e cila “luan rolin e një zoti dhe ka potencialin ta nënshtrojë njeriun”. Në fakt, edhe “çlirimi i vetvetes” ka të bëjë me rregullin që njeriu vë brenda vetes. Madje, edhe për të çliruar një kala, më parë duhet të çlirosh vetveten. Sulltani Mehmet Fatih ka thënë: “Ose e marr unë Bizantin, ose më merr Bizanti mua”.

Ai ishte i brumosur me “çlirimin”.

Nëse anijet ecën në tokë, kjo ishte për shkak se ky çlirim ishte realizuar në zemrën e Fatihut. Nëse jeni një njeri i tillë, do të bëheni një “çlirim” që jeton në çdo ushtar tuajin. Njësoj sikur jetoi



tek Hadixhja (r.a.), tek Ebu Bekri, Aliu, Omeri, Mus'abi dhe familja e Jasirit (r.anhum), gjatë vuajtjeve të Profetit tonë (a.s.) në periudhën e Mekës.

Brumosja dhe pajisja e zemrës me “përmendjen e Allahut”...

Kjo nënkupton hedhjen e “nefsit” në zjarr dhe rrahjen e tij me çekiç mbi kudhër, duke e ndarë prej papastërtive ashtu siç bëhet me hekurin për ta bërë çelik. E më pas të kalohet prej lambikut të pastrimit dhe edukimit, me qëllim që të zhvishet prej “emmare bi'ssu” dhe të ngrihet në gradën “mutmainne, radije-merdiye”...

Mehmet Akif Ersoji ka një poezi të titulluar “*Mos ki frikë!*”, në të cilën shprehet:

“E fikim në gjoksin tonë, edhe sikur Xhehenem të jetë ajo që po vjen.

Nuk dimë të kthehemi, ecim në këtë rrugë, që është rruga e të Vërtetit”

Kjo, do të thotë se do të mblidhni çfarë keni e nuk keni, gjuha do t'u lidhet pas zemrës dhe edhe nëse jashtë është e shtruar me zjarre si “xhehenem”, brenda jush do të ndjeni forcën për ta shuar atë. Madje, edhe nëse “bota shkatërrohet”, rezistenca brenda jush nuk duhet të pësojë lëkundje.

Çfarë është takua?

Të tregosh kujdes të mos shkelësh mbi gjemba kur je duke ecur në një rrugë me ferra. Në kohën tonë, kur shejtani tashmë posedon edhe institucione gjigande, mbase duhet të ecim edhe në rrugë të minuar. Mirëpo, duhet të kemi sukses të kalojmë në këto fusha të minuara për ta çuar këtë amanet tek Krijuesi me “faqe të bardhë”. Por, të ikësh me faqe të bardhë, nuk do të thotë të lëmë çdo pjesë të personalitetit tonë në këtë fushë të minuar.

Ne duhet të mendojmë mirë se çfarë përgjigje do të japim nëse Zoti ynë na pyet: “ku e le zemrën?”, “Ç'është kjo mendje e plagosur?”, “Përse në sytë e tu ka papastërti gjynahesh?”, “Përse kanë ecur këmbët e tua në gjurmët e shejtanit?”, “Përse në duart e tua ka gjurmë padrejtësie?” dhe “Përse në gjuhën tënde gjendet gjaku i vëllait tënd të vdekur?”.

Duhet të shohim veten!

Duhet të shohim se në cilën fushë të personalitetit tonë dhe si ka ndodhur pushtimi.

Duhet të llogarisim vetveten pa ardhur dita e llogaridhënies.

Prej çdo Meke të çdo kohe, dalin edhe Medina. Ata që kapërcejnë Mekën, e çlirojnë atë. Ata që çlirojnë vetveten, çlirojnë edhe Mekën.


Duhet të shohim veten!

Duhet të shohim se në cilën fushë të personalitetit tonë dhe si ka ndodhur pushtimi.

Duhet të llogarisim vetveten pa ardhur dita e llogaridhënies.

Prej çdo Meke të çdo kohe, dalin edhe Medina. Ata që kapërcejnë Mekën, e çlirojnë atë. Ata që çlirojnë vetveten, çlirojnë edhe Mekën.





Largoje mbulesën!

— Dr. Adem Ergyl —

“O njeri, o mik i shtrenjtë! Ti nuk je vetëm një person! Ti je një botë! Je një det i thellë dhe shumë i madh. Një oqean pa fund e pa anë, që është mbase nëntëqind fish më i madh se ekzistenca jote. Me qindra botë janë mbytur e janë zhdukur në atë oqean!”

Kështu i drejtohet Mevlana Xhelaleddin Rumi njeriut të shtrenjtë që dëshiron të zbulojë veten!..

Ji i vetëdijshëm për atë që je, i thotë ai! Mos e shit veten lirë dhe mos e ço dëm esencën brenda vetes! Mos u mashtro me pamjen e jashtme! Por udhëto midis shtresave të ndërthurura me njëra-tjetrën dhe zbuloji perlat që të janë lënë amanet!

Po, të gjithë profetët dhe njerëzit e ditur e kanë ftuar birin e njeriut, i cili është zhytur në errësirë totale, që ai të largojë perdet, të çlirojë veten dhe të dale në dritë. Zoti ynë i Madhëruar, i Cili është Rrahman dhe Rrahim, këta ftues dhe mesazhe hyjnore i ka dërguar për realizimin e këtij synimi:

“Është Ai që i ka zbritur robit të Vet shpallje të qarta për t’ju nxjerrë nga errësira në dritë. Allahu është vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë me ju.” (Hadid, 9)

“...Këtë Libër ta kemi shpallur ty (o Muhamed), për t’i nxjerrë njerëzit, me lejen e Zotit të tyre, nga

errësira në dritë, në rrugën e të Plotfuqishmit!..” (Ibrahim, 1)

Çfarë është “*dhulumat*”, e cila përkthehet “*errësira*” (shumës)? Çfarë janë ato perde që i zënë sytë njeriut, që i rëndojnë dhe i shurdhojnë veshët, që i kyçin mendjen dhe i ndryshkin zemrën? Si formohen ato? Si mund ta shpëtojë njeriu të vërtetën e vet prej këtij pushtimi dhe si mund të bëhet çliruesi i vetes?

Prej ajeteve të Kuranit dhe haditheve të Profetit (a.s.), mësojmë se, perdja më e trashë, është ajo e kufrit/mohimit dhe shirkut/idhujtarisë. E në fakt, kuptimi leksikor i fjalës “*kufr*” është “*të mbulosh*”. Mbulim i natyrshmërisë dhe i ndërgjegjes, i të Vërtetit dhe të vërtetës. Në përgjithësi, gjërat që e mbyllin një njeri ndaj të Vërtetit dhe të vërtetës, janë mosmirënjohja, injoranca, zhytja dhe mbetja në devijim, imitimi i verbër, paragjykim, inati pa argumente dhe fanatizmi. Këto errësira totale, janë padrejtësia më e madhe që i bën njeriu realitetit të vet. Në raste të tilla, realiteti njerëzor lëshon klithma të shumta për ndihmë, por përveç të diturve nuk ua dëgjon kush zërin!..

Perdet e gjynaheve dhe të këqijave formojnë errësira që e mbulojnë realitetin e njeriut. Dhe këto,

në varësi të madhësisë dhe të sasisë së gjynahut, e mbyllin dhe e errësojnë vetëdijen e njeriut. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *“Kur robi kryen një gjynah, në zemrën e tij shfaqet një pikë e zezë. Nëse ai largohet prej gjynahut, kërkon falje dhe pendohet, zemra e tij pastrohet. Por, nëse ai nuk vepron kështu dhe drejtohet përsëri nga ato gjynahe, pikat e zeza shtohen dhe si përfundim ato ia mbulojnë zemrën. Ja pra, pikërisht ky është “ndryshku” për të cilin Allahu i Madhëruar, thotë: «Jo, nuk është ashtu! Por vep-
rat e tyre (të këqija) ua kanë ndryshkur zemrat.»”* (Tirmidhi, Tefsir, 83; Ibn Maxhe, Zuhd, 29.)

Kur syri shikon haramin, ai vë perde dhe në zemrën e tij hapet një plagë e helmatisur. Veshi fillon të shurdhohet dhe e humbet ndjesinë e tij me fjalë të helmatisura, si përgojimi dhe gënjeshtria. Gjuha ndotet dhe nxihet me fjalë që janë haram. Në këtë mënyrë, thelbi i njeriut pushtohet, duke u bërë rob i egos dhe shejtanit.

Një tjetër perde, është mendjemadhësia, pëlqimi i vetvetes, lidhja e shpresës pas gjërave kalimtare, idhujtarizimi i dëshirave, zhytja në çështjet e kësaj bote, braktisja e së vërtetës dhe dashuria pas gënjeshtres.

Në të vërtetë, burimi i këtyre perdeve, është indifferenca e robit ndaj Zotit. Në bazë të sasisë së indiferencës shtohet edhe numri, por edhe dendësia e perdeve. Si rezultat i kësaj indifference, mendja e njeriut, zemra, syri, veshi, perceptimi dhe mbase i gjithë uni i tij qelizë më qelizë pushtohet nga egoja dhe ushtarët e shejtanit, duke i degjeneruar ato aq sa të mos kenë mundësi të kryejnë funksionet e tyre. Zoti ynë i Madhëruar, urdhëron:

“Ne kemi krijuar për Xhehenemin shumë xhinde dhe njerëz, sepse ata kanë zemra, por nuk kuptojnë, kanë sy, por nuk shohin dhe kanë veshë, por nuk dëgjojnë. Ata janë si bagëtitë, madje edhe më ulët se ato. Pikërisht këta janë të shkujdesurit (indiferentët).” (A'raf, 179)

Njeriu është i detyruar të veprojë për të shpëtuar unin e vet prej këtij pushtimi dhe të sigurojë mbizotërimin e Allahut në ekzistencën e vet. Dhe emri i këtij veprimi, është *“tezkije”*, pra, procesi i pastrimit dhe i ndriçimit. Në këtë veprim çlirimi:

Synimi, është shpëtimi i vetes sonë prej çdo su-ndimi dhe autoriteti tjetër jashtë Allahut. E shprehur ndryshe, mohimi i çdo lloj shejtani, idhulli apo njeriu, mendimi, institucioni dhe dëshire që adhurohet, të cilët në Kuranin Fisnik përmbledhen me fjalën *“tagut”*. E më pas, aprovimi i të Vërtetit dhe të vërtetës. Allahu i Madhëruar, urdhëron:

“S'ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra! Ai që mohon idhujt (dhe

gjithçka që adhurohet në vend të Allahut) dhe beson në Allahun, ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë. Allahu dëgjon dhe di gjithçka.” (Bekare, 256)

Harta e udhës, është Fjala e Allahut (Kurani) dhe Suneti i Profetit (a.s.). Vetëm kështu mund të shpëtohet prej robërisë së errësirave dhe të dilet në dritë.

Prijësit, janë dijetarët e devotshëm që gëzojnë cilësinë e trashëgimtarëve të profetëve.

Ndihmësit, janë të gjithë besimtarët e mirë dhe besnikë që ndihmohen në devotshmëri. Në fakt, edhe pse triumfi është çlirimi i vetes sonë, ky është një synim aq i madh dhe i vështirë, saqë nuk mund të arrihet i vetëm.

Detyra individuale, është përpjekja dhe lufta e madhe që do të zhvillohet me vetëmohim të lartë, duke vënë në lëvizje të gjitha mundësitë për hir të Allahut. Dhe, nëse realizohet edhe ky kusht, në ndihmë të robit do të arrijnë ndihma e veçantë e Allahut, udhëzimi dhe sukcesi, në sajë të të cilave do të arrihet edhe çlirimi me lejen e Allahut. Në Kuran urdhërohet:

“Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t'i udhëzojmë drejt udhëve Tona. Vërtet, Allahu është me punëmirët!” (Ankebut, 69)

Procesi i çlirimit fillon me teube/pendim tek Allahu, vazhdon me orientimin kah Allahu dhe arrin në sukses me bindje dhe devotshmëri ndaj Allahut. Zoti ynë i Madhëruar, na njofton se ata të cilët e pastrojnë veten do të arrijnë shpëtimin dhe se ata të cilët nuk e bëjnë këtë por e lënë veten në dorë të egos së tyre, do të pësojnë disfatë. (shih. Shems, 9-10.)

Kjo luftë dhe përpjekje do të vazhdojë derisa në trup të mos mbetet asnjë pikë e errët... Derisa të realizohet çlirimi dhe të sigurohet gjendja e sigurisë dhe qetësisë. Dhe tani le ta shohim me këtë sy dhe t'i vëmë veshin kësaj duaje të të Dashurit të Allahut (a.s.), i cili na e tregon këtë synim të madh:

“O Allah! Jepi dritë zemrës sime, syrit tim dhe veshit tim. Ma ndriço të djathtën dhe të majtën time, të sipërmen dhe të poshtmen, përball meje dhe pas meje dhe më bëj tërësisht dritë! (Në një transmetim tjetër zënë vend edhe këto shprehje): Më ndriço damarët e mi, mishin, gjakun, flokët dhe fytyrën time!” (Buhari, Deauat, 9; Muslim, Misafirin, 181.)

Padyshim se shpëtimi i trupit tonë prej robërisë dhe arritja e suksesit, mund të arrihet vetëm me ndihmën dhe mirësinë e Zotit të botëve, Allahut të Madhëruar.



PASTRIMI PREJ ÇDO GJËJE PËRVEÇ ALLAHUT

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Allahu i Madhëruar e ka krijuar këtë botë në shërbimin tonë dhe, me qëllim që të bëhemi robër të Tij e t'i shërbejmë Atij, Ai na ka dhënë shumë aftësi të çmuara. Por për fat të keq, njeriu në shumicën e rasteve këto aftësi, i ka përdorur pa kontroll dhe në rrugë të këqija. Ndër të gjithë njerëzit, ata që arrijnë të kontrollojnë egon e tyre në çdo aspekt, duke jetuar me vetëdijen se ndodhen vazhdimisht para Allahut, janë profetët. Ata i përdorin në përputhje me kënaqësinë hyjnore të gjitha aftësitë dhe organet e tyre të dukshme dhe të padukshme. Për këtë arsye, profetët kanë arritur lirinë në kuptimin e vërtetë të fjalës, duke shpëtuar prej influencës së egos.

Misticizmi/tasavufi është një përpjekje për të transferuar tek besimtarët me anë të metodës së pastrimit, gjendjet e larta të Profetit tonë (a.s.) dhe të profetëve të përmendur në Kuran. E në fakt, dije-tarët kanë trashëguar cilësi të ndryshme të Profetit tonë (a.s.). Ndër këto cilësi të larta, mistikët/sufitë, kanë trashëguar metodat e shpëtimit të njeriut nga skllavëria e egos dhe e kësaj bote. Punët e tyre kryesore, janë kurimi i sëmundjeve të zemrës tek njeriu, duke u bërë melhem për sëmundjet ezoterike. Këtë gjendje, Imam Rabbani e shpreh në këtë mënyrë: *“Robërit e devotshëm të Allahut, janë doktorë të sëmundjeve të zemrës. Eliminimi i këtyre problemeve ezoterike është specialiteti i tyre. Fjalët e tyre janë zgjidhje, ndërsa shikimet e tyre janë shërim. Ata janë njerëz të tillë, në mes të të cilëve nuk gjendet asnjë kusar.”*

Këta robër të dashur të Allahut të cilët kanë gjetur të vërtetën e sinqeritetit, i kanë lidhur zemrat e tyre plotësisht me Zotin e tyre dhe i kanë kthyer shpinën çdo gjëje tjetër përveç Tij. Ata kanë arritur të gjitha gradat e besimit të përsosur të teuhidit. I nderuari Mevlana, në veprën e tij *“Mesnevi”* jep si shembull marrjen e një qyteze shiite nga ana e Gazneli Mahmudit, për të treguar vlerën që i ka dhënë Allahu i Madhëruar këtyre njerëzve të zemrave:

Gazneli Mahmud i drejtohet popullit të kësaj qyteze, duke i thënë: *“Nëse nuk më sillni të paktën një*

person me emrin Ebu Bekër, do t'ju kaloj të gjithëve në shpatë.” Për këtë arsye, banorët e qytezës filluan të kërkonin ndonjë person me emrin Ebu Bekër, por nuk mundën të gjenin asnjë. Më në fund, në lagjet periferike të qytezës, në një rrënojë, gjetën një Ebu Bekër të këputur nga sëmundja, në sajë të të cilit shpëtuan edhe jetët e tyre.

Po ashtu, siç shprehet edhe vet Mevlana, çdo padishah bëhet skllav i skllavit, që e do me të vërtetë. Për këtë arsye, kur dashuria nuk pranon shirk as në këtë botë, a mund të pranohet shirku në dashurinë ndaj Allahut? Këtë gjendje, Imam Rabbani e shpjegon në këtë mënyrë: *“Kreu i sëmundjeve ezoterike dhe nëna e problemeve shpirtërore, është lidhja e zemrës me diçka tjetër jashtë Allahut të Madhëruar. Pa u shkëputur plotësisht prej kësaj lidhjeje, është e pamundur të gesh shpëtim, sepse në prezencë të Sunduesit të Madhëruar, nuk ka vend kurrë për shirk. Në Kuran urdhërohet: **“Vetëm Allahut i takon adhurimi i vërtetë!..”** (Zumer, 3)*

Sipas Imam Rabbanit, njeriu i cili lë Zotin e vet që e krijoi dhe i fali të gjitha mirësitë, e dashurohet pas bukurive të kësaj bote, të cilat vetë Allahu ia ka vënë në shërbim, është një shembull marrëzie.

Imam Rabbani, si tregues të dashurisë së njeriut për këtë botë, ka evidentuar preferimin nga ana e tij të interesave të kësaj bote në vend të urdhrave të Allahut. Cilën anë të mbajmë kur vihemi përballë zgjedhjes midis punëve të kësaj bote dhe të botës tjetër, ose midis urdhrave të Allahut dhe dëshirave personale, do të thotë se atë duam më shumë. Ata që mbajnë gjithmonë anën e dëshirave personale, në Librin e Allahut të Madhëruar, janë cilësuar si idhujtarë të egos së tyre: *“A e ke parë atë që e ka marrë për zot dëshirën e vet?..”* (Furkan, 43)

Mirëpo, Allahu i Madhëruar, dëshiron që jetën tonë, si atë shpirtërore, ashtu edhe atë materiale, t'ia kushtojmë Atij. Për rrjedhojë, ata që e zbatojnë fenë vetëm nga ana e jashtme dhe nuk e pastrojnë brendinë e tyre prej mohimit dhe hipokrizisë, cilësohen si dyfytirësh. Në mënyrë të veçantë, Imam

Rabbani, arsyen që njeriu krijon lidhje me çdolloj krijese në gjithësi, e lidh me faktin se ai është gjithëpërfshirës. Ndërkohë që kafshët ndiejnë nevojë vetëm për disa gjëra të caktuara, njeriu ka nevojë për shumë gjëra në këtë botë dhe për këtë arsye krijon marrëdhënie me to. Kjo, është domosdoshmëri e faktit se ai është halife/mëkëmbës i Allahut në tokë. Në fakt, edhe sundimtarët krijojnë marrëdhënie me çdokënd që kanë nën vete. Por këtu, e rëndësishme është që kjo marrëdhënie të krijohet në emër të Allahut, duke e lënë veten jashtë kësaj: *“Ashtu siç ka nevojë për qetësinë e brendshme, njeriu ka nevojë edhe për qetësinë e jashtme. Madje, qetësia e dytë, është më parësore. Ndër të gjitha krijesat, njeriu është ai që ka më shumë nevoja. Këto nevoja të shumta atij i burojnë nga fakti se ai është gjithëpërfshirës. Në botën e ekzistencës, njeriu ka nevojë për të gjitha dhe për këtë arsye, ai krijon lidhje me çdo gjë që ka nevojë. Për rrjedhojë, lidhjet dhe marrëdhëniet e njeriut, gjithmonë janë më të shumta prej çdo krijese tjetër. Mirëpo, çdo lidhje e kësaj bote, bëhet shkak që ai të largohet më shumë prej Allahut të Madhëruar. Prandaj, njeriu është edhe më i privuari ndër të gjitha krijesat prej kësaj rruge.”*

Kjo do të thotë se, ajo që e bën njeriun krijesën më superiore ndër të gjitha krijesat, që është gjithëpërfshirja, në të njëjtën kohë, bëhet shkak edhe për privimin e tij në lidhje me Allahun: *“Shkaku që njeriu është më superior ndër të gjitha krijesat, është të qenit e tij gjithëpërfshirës. Për këtë arsye, pasqyra e tij është më e plotësuar. Çdo gjë që shfaqet dhe duket (manifestimet e cilësive hyjnore) në pasqyrat e të gjitha krijesave, shfaqet në një pasqyrë të vetme të njeriut. Prandaj, nga ky aspekt, njeriu është bërë krijesa më superiore. Nga ana tjetër, (për shkak të faktit se ndodhet në gradën e fundit dhe ka shumë nevoja) njeriu është edhe më i keq prej krijesave, sepse nga njerëzit ka dalë edhe më i larti, siç është Profeti Muhammed (a.s.), por edhe më i ulëti siç është Ebu Xhehli (mallkuar qoftë)”*.

Nisur nga kjo, ajo që kërkohet prej njeriut, është që marrëdhëniet që ata kanë me gjërat e tjera jashtë Allahut, t'i vazhdojnë në emër të Allahut, e jo në emër të egos së vet. Braktisja e çdo gjëje nga ana e besimtarit, nuk është gjë e pranuar, siç mund të kujtojnë disa. Nëse do të ishte kështu, më parë do ta vepronte vetë Profeti (a.s.). Mirëpo, ai ia kushtoi gjithë jetën e vet njerëzve, xhinëve, bimëve, e madje edhe kafshëve. E megjithatë, kjo marrëdhënie e Profetit me gjërat e tjera jashtë Allahut, nuk ka qenë në emër të egos së vet. Për këtë arsye ajo nuk e ka dëmtuar atë: *“Treguesi i shkëputjes së lidhjes së zemrës me gjithçka tjetër jashtë Allahut, është harrimi i plotë dhe largimi prej tyre. Aq sa edhe nëse e sforcon kujtesën, ajo nuk duhet të të vijë në mendje. Në këtë gradë, është e pamundur të krijohet lidhje me gjërat e tjera jashtë Allahut. Ndër robërit e devotshëm të Allahut, kjo pozitë njihet si pozita “fena/e shkrirjes”.*

Sipas Imam Rabbanit, pozita në të cilën njeriu ndërpret lidhjet me të gjitha gjërat e panevojshme të kësaj bote, është ajo e “shkrirjes”. Tashmë, njeriu është bërë i përkohshëm për këtë botë dhe i përjetshëm me Allahun. Nakshibenditë, këtë pozitë e quajnë “*halvet/izolim*”, pra qëndrim në vetmi. Ky është një qëndrim vetëm për vetëm me Allahun në mes të njerëzve. Ndërsa ata që nuk e bëjnë dot këtë dhe, në emër të “shkrirjes me Allahun”, shkojnë e izolojnë nga njerëzit në majë të malit, Imam Rabbani i konsideron si njerëz të dobët që duan të shpëtojnë vetëm vetveten.

I lutemi Allahut të Madhëruar të na bëjë robër të fuqishëm, të cilët mirësitë që Ai na i ka falur, t'i përdorim në rrugën e drejtë. Amin!..

Ajo që kërkohet prej njeriut, është që marrëdhëniet që ata kanë me gjërat e tjera përveç Allahut, t'i vazhdojnë në emër të Allahut, e jo në emër të egos së vet. Braktisja e çdo gjëje nga ana e besimtarit, nuk është gjë e pranuar, siç mund të kujtojnë disa. Nëse do të ishte kështu, më parë do ta vepronte vetë Profeti (a.s.).





ÇLIRUESI I ZEMRAVE

— Salih Seki Meriç —

Për ta kuptuar në mënyrën e duhur mesazhin islam, i cili është përtej shekujve, duhet të kuptojmë se e gjithë jeta e Profetit tonë të dashur (a.s.), ka qenë një lëvizje çliruese dhe se në fakt, kjo rrugë e bekuar është vetëm një kauzë për çlirimin zemrave.

Ai e ka treguar me veprimtaritë e tij të udhëzimit, që ishin vetë jeta e tij, se kumtimi i fesë nuk mund të bëhet duke aplikuar dhunë dhe forcë.

I Dërguari i Allahut kishte ardhur për të fituar zemra e jo për t'i rrënuar ato. Ai kishte hyrë në zemrat e njerëzve që para se t'i vinte shpallja hyjnore dhe i kishte hapur ato, duke shfaqur një karakter të lartë, të pajisur me cilësi që i shtonin vlerë jetës shoqërore në të cilën jetonte. Të gjithë, si ata që mendonin si ai, ashtu edhe ata që nuk mendonin si ai, ishin të të njëjtit mendim se ai posedonte karakter të drejtë, të besueshëm dhe të sigurt.

Veprimtaria profetike e të Dërguarit të Allahut (a.s.), që prej fillimit deri në fund, ishte një veprimtari ringjalljeje. Dera madhështore e Islamit, nga ku hyhet me çelësin e teuhidit, ishte e hapur për të gjithë ata që kishin humbur ndjenjat e tyre të natyrshme njerëzore.

Parimet që formojnë pesë kushtet themelore të Islamit, janë parime të domosdoshme për të realizuar edhe ndërtimin e botës së brendshme të njeriut, edhe ndërtimin e jetës sociale, edhe hapjen e zemrave. Këto parime janë si eliksir jete për njeriun. Këto janë kritere me rëndësi jetike në nivelin e ekzistencës dhe mosekzistencës. Njeriu që i kupton dhe i jeton në mënyrën më të drejtë këto parime, është kandidat për t'u bërë një hapës zemrash. Një njeri që nuk shpëton

dot prej dobësive njerëzore, nuk mund të jetë i dobishëm as për veten dhe as për zemrat e tjera. Ja pra, një besimtar që do të realizojë këtë hapje zemrash, duhet të studiojë dhe të kuptojë në atë mënyrë që të arrijë t'i përdorë si mjet këto pesë parime Islame për të vënë në jetë veprimtarinë e hapjes së zemrave.

Njeriu që e kupton përmbajtjen e kelime-i teuhidit dhe arrin këtë vetëdije, vërteton mosekzistencën e të gjithë idhujve, duke filluar që prej egos së vet dhe duke e pranuar se Allahu është Zoti i tij i vetëm. Për rrjedhojë, ky njeri konsiderohet brenda rrethit të Islamit. Më pas, për të ndërtuar zemrën dhe për të plotësuar përgjegjësitë ndaj Zotit, vjen namazi, i cili është një adhurim pastrimi me qëndrimin në këmbë dhe vënien e ballit në sexhde. Namazi, është një mjet me anë të cilit njeriu arrin të çlirojë vetveten. Ai është ndriçim me dritën e Allahut i anëve të errëta në botën e brendshme njerëzore dhe vazhdimi i udhëtimit me atë dritë hyjnore. Namazi, më tepër se një formë, është një adhurim me thellësi shpirtërore.

Për t'u bërë një hapës zemrash, besimtari duhet të përjetojë një proces pastrimi. Dhe kjo, mund të arrihet vetëm me anë të agjërit, i cili mund ta edukojë egon në mënyrën më të mirë. Në muajin e agjërit, besimtarit, i cili arrin të realizojë çlirimin e duhur shpirtëror në botën e zemrës me anë të agjërit, i shtohet edhe forca e besimit në mënyrë të shumëfishtë. Kështu, ai arrin të ketë një zemër të butë e delikate, ndjenja të forta dhe urtësi të madhe. Zemrat e tjera, që do të hapë një mendje e tillë, gjejnë jetë në fjalët e tij që ua ngrohin zemrat dhe pinë ujin e jetës prej syve të tij që janë burim i mëshirës.

Një pikë tjetër e këtij çlirimi, është arritja e një niveli të caktuar në dhurim nga ana e besimtarit. Kjo, është përpjekja për të qenë vetëmohues në dhurim, pa qenë nevoja të jesh i pasur. Në një ajet fisnik, Allahu numëron disa cilësi të besimtarëve dhe shprehet se, *“ata i besojnë të fshehtës, falin*

namazin dhe japin zekatin!..”. Këtu na bëhet e qartë se një prej kushteve themelore të cilësisë së besimtarit, që është edhe dhurimi, konsiderohet si një mjet për arritjen e çlirimit të zemrave. Ai vepron me vetëdijen se mirësitë e kësaj bote, të cilat nuk janë dhe nuk do të jenë kurrë pronë e tij, janë dhuratë e Allahut. Ai përpaket që sadakanë ta japë me edukatë të lartë, zekatin ta japë si një urdhër të Allahut dhe dhurimin ta bëjë si një tregues i cilësisë së lartë të besimit të tij. Për çdo besimtar që e merr në dorë çelësin e kelime-i teuhidit, kjo vepër mendohet të jetë një hapje zemrash, sepse zekati është adhurimi më i rëndësishëm që ndikon drejtpërsëdrejti në strukturën shoqërore të umetit islam. Ai është rregullimi i drejtësisë sociale dhe dorëzimi i një pjese të pasurisë me edukatën e duhur, si e drejtë e të varfrit nga ana e të pasurit. Dhe, besimtari është i vetëdijshëm se vjedhja më e madhe dhe më e shëmtuar është mosdhënia e zekatit që është e drejtë e të varfrit.

Gjithashtu, një tjetër faktor i hapjes së zemrave, është haxhi, takimi i përvitshëm i besimtarëve. Haxhi është një adhurim që zhvillohet në një vend të veçantë me disa kushte të posaçme. Besimtari që e kryen këtë adhurim ashtu siç duhet, do të ketë përparuar edhe në realizimin e çlirimit të brendshëm, por do të zotërojë edhe aftësitë e duhura për t'u bërë një hapës/çlirues zemrash.

Në edukimin e sahabëve fisnikë nga ana e Profetit tonë (a.s.), shihet qartë në të gjitha ndodhitë, se synimi i tij ka qenë gjallërimi dhe fitimi zemrave të njerëzve. Dhe për të bërë këtë, ekziston dëshira për të shfaqur karakterin që kërkon Allahu me anë të pikave që ne i cekëm më lart.

Është e pamundur të bëhesh fitues/çlirues zemrash me besim të dobët, adhurime të mangëta, me namaze formale, me agjëtime të padobishme, me zekate që jepen për sy e faqe të botës dhe me një haxh që bëhet për të fituar një titull të kësaj bote.



KA KADER, S'KA QEDER!

— Ali Riza Temel —

Dija dhe caktimi nga ana e Allahut e gjërave që do të ndodhin, përfshi kohën, vendin, cilësitë, format dhe radhitjen e tyre, quhet “kader”. Kjo, shpreh ligjin hyjnor i cili rregullon sipas një sistemi dhe një mase të caktuar gjithësinë dhe të gjitha krijesat dhe ndodhitë në gjithësi.

Fakti që Allahu i di gjërat që më parë, nuk e eliminon vullnetin e robit, sepse dija është në bazë të njohurisë. Një gjë nuk ndodh për shkak se Allahut e di atë, por Ai e planifikon atë, sepse

e di që ajo do të ndodhë. Eklipsi diellor dhe hënor nuk ndodhin sepse ato dihen që më parë, por regjistrohen sepse dihet se ato do të ndodhin.

Sipas nesh, koha ndahet në të shkuar, të tashme dhe të ardhme. Ndërsa për Allahun koha është një e tërë. Për Të, ekziston vetëm një “e tashme” që nuk ka as fillim dhe as fund. Ne i mësojmë ndodhitë pasi ato vijnë në ekzistencë. Ndërsa Allahu i di ato pa ndodhur dhe pa ekzistuar ende. Asgjë nuk ndodh pa e ditur Ai. Gjithësia nuk



funksionon sipas rastësive qorre, por sipas ligjeve dhe programeve hyjnore.

Besimi në “kader”, është një prej kushteve të besimit. E mira dhe e keqja ndodhin në sajë të krijimit të Allahut. Krijues të dytë nuk ka! Ne e kërkojmë (e meritojmë), Allahu e Krijon. Vullneti i Allahut është gjithëpërfshirës dhe absolut, ndërsa vullneti ynë është i pjesshëm. Nëse gjithçka e bëjmë ne, atëherë përse nuk bëjmë dot çdo gjë që dëshirojmë? Nga ana tjetër, nëse gjithçka e bën Allahu pavarësisht vullnetit tonë, atëherë përse turpërohem ne për shkak të fajit që bëjmë? Përgjegjësia jonë buron prej dëshirës dhe vullnetit tonë. Veprat vlerësohen sipas qëllimeve. Në vepra nuk ka detyrim. Një vrasës, nuk mund të pretendojë se është i pafajshëm duke thënë se kështu ishte shkruar për mua. Detyra e tij, është të mos kryejë vrasje. Dikush që bën aksident në rrugë, fajësohet për shkak se nuk i ka respektuar rregullat e qarkullimit. Mirëpo, aksidenti mund të ndodhë edhe nëse rregullat e qarkullimit respektohen, me ç'rast njeriu nuk fajësohet. Detyra e njerëzve është të respektojnë ligjet dhe të marrin masat sipas mundësive. Për shembull, mund të ndodhin tërmete, përmytje, epidemi, etj., por ne nuk jemi përgjegjës për ndodhitë që janë përtej vullnetit tonë.

Shkurtimisht, Zoti ynë është Ai që di gjithçka para se të ndodhë, që planifikon dhe krijon. Ndodhitë procedojnë në bazë të programit të kaderit. Nëse i dorëzohemi dhe ndjekim këtë program, do të jemi të qetë. Rregulli i parë i notit, është të mos bësh panik. Deti e mban atë që i dorëzohet, por e fundos atë që lëkundet. Për shkak se trupi nuk kundërshton, ai noton mbi ujë. Dorëzohu dhe shpëto! Myslimani është njeri që dorëzohet. Bota makro dhe mikro janë të lidhura pas ligjeve të Allahut. Këtë e tregon qartë harmonia në Gjithësi. Prej mosbindjes formohet kaosi, ndërsa prej bindjes formohet rregulli. Po ashtu, edhe detyra jonë është të lidhemi pas ligjeve të Allahut, të tregojmë aprovimin tonë ndaj kaderit dhe të jetojmë pa bërë panik. Prej kaderit nuk mund të iket. Ata që përpiqen t'i ikin, jetojnë gjithmonë me frikë. E megjithatë, në fund ata pësojnë atë prej së cilës iknin dhe kishin frikë.

Në lidhje me kaderin ka shumë ajete dhe hadithe fisnike. Allahu i Madhëruar, urdhëron: **“S’ka fatkeqësi që godet tokën dhe ju, që të mos jetë e shënuar në Libër (Leuhi Mahfûdh) më parë**

se ta krijojmë atë. Kjo për Allahun është vërtet e lehtë! (Këtë paracaktim e kemi bërë) që ju të mos dëshpëroheni për atë që ju ka kaluar, por edhe për të mos u gëzuar së tepërmi për atë që Ai ju ka dhënë...” (Hadid, 22-23)

Çdo gjë që ka ndodhur dhe do të ndodhë, është e regjistruar në dijen e Allahut. Ai që i beson kësaj, nuk qahet për mundësitë e humbura dhe nuk e shpërdoron jetën e tij duke u kapluar në dehjen e mundësive që i ka dhënë Allahu. Nëse pëson diçka, ai duron dhe merr mësim prej saj. Nëse arrin një mirësi, ai falënderon, nuk mburret dhe as nuk lazdohet. Kjo, sepse që të dyja ndodhin në bazë të vullnetit dhe caktimit të Allahut. Besimtari nuk mburret me pasurinë si Karuni, por falënderon për mirësitë si profeti Sulejman (a.s.) dhe duron ndaj fatkeqësive si profeti Ejub (a.s.).

“Thuaj: “Do të na godasë vetëm ajo që na ka caktuar Allahu; Ai është Mbrojtësi ynë dhe vetëm tek Allahu le të mbështeten besimtarët!” (Teube, 51)

Ai që ia atribuon gjithçka Allahut, është i fuqishëm dhe vetëm Atij i nënshtrohet. Ai beson se nuk mund të dilet jashtë kaderit. Ai e di se frika nuk të bën dobi para vdekjes. Ai vepron me guxim në përputhje me këtë dije dhe besim. Po ashtu, ai bën gjithçka që ka mundësi dhe, për atë që nuk ka mundësi ia lë në dorë Allahut. Kërkon ndihmë prej Tij dhe nuk i përulet askujt tjetër përveç Tij.

Gjithashtu, myslimani i ka parasysh gjithmonë këshillat që Profeti (a.s.), i dha Abdullah bin Abbasit (r.a.), kur i tha: **“Bëj kujdes ndaj urdhrave të Allahut, që Allahu të kujdeset për ty dhe të të ruajë. Syno kënaqësinë e Allahut në çdo punë, që ta gesh Atë para teje. Nëse do të kërkoish diçka, kërkoje prej Allahut. Nëse do të kërkoish ndihmë, kërkoje prej Tij. Dhe dije se, nëse mblidhen të gjithë njerëzit për të të siguruar ndonjë dobi, ata mund të sigurojnë vetëm atë dobi të cilën Allahu e ka caktuar për ty. Po ashtu, edhe nëse të gjithë njerëzit ngrihen të të dëmtojnë, ata mund të të dëmtojnë vetëm aq sa ka caktuar Allahu për ty. Kjo, sepse lapsi që shkruan kaderin, nuk shkruan më dhe shkrimet janë qartësuar aq sa nuk mund të ndryshohen më.”** (Tirmidhi, Kijamet, 59.)

“Teuekkul”, do të thotë, të mbështetesh dhe t'i besosh Allahut, të strehohesh tek Ai, t'i kërkoish

Atij, çdo gjë t'ia atribuosh Atij, të jesh i kënaqur me atë që të vjen prej Tij dhe t'i shohësh të bukura të gjitha ato që bën Ai.

Për njeriun, nuk ka ndjenjë më qetësuese se sa besimi se ekziston një kader që do të përjetohet. Nuk ka asnjë burim tjetër ngushëllimi më efikas që do t'i qetësojë revoltimet tona dhe do të na bëjë t'i pranojmë peripecitë e jetës. Kur jemi përballë një fatkeqësie, ne strehohemi tek besimi i kaderit, nën hijen e aprovimit dhe pas mburojës së besimit. Kjo, sepse nuk ka asnjë strehim dhe mburojë tjetër. Asnjë mirësi dhe mundësi materiale nuk mund ta ngushëllojë njeriun për humbjen e një të dashuri. Feja është ajo që i jep kuptim ndodhive, ekzistencës dhe zhdukjes. Një botëkuptim materialist dhe pozitivist ia humbet kuptimin gjithçkaje. Mohimi i Allahut, e bën gjithçka të pakuptueshme. Ateistët përpiqen ta shpjegojnë ekzistencën me anë të “mosekzistencës”. Fundi i mosekzistencës, është përsëri mosekzistenca. Si pas jobesimtarëve, vdekja është vetëm një vrimë e zezë dhe në fund gjithçka shkon kot. Besimi në botën tjetër, u jep kuptim krijesave dhe ndodhive. Ai është shpëtim prej gjërave të kota dhe absurditeteve. Përveç fesë, asnjë ideologji dhe filozofi nuk mund t'u japë një përgjigje të arsyeshme pyetjeve, “përse ekziston bota, nga erdhëm, pse erdhëm dhe ku po shkojmë?”.

Një besimtar që i beson Allahut, programit të Tij të kaderit dhe mënyrës së Tij të veprimit, nuk ankohet duke thënë: “Përse unë, përse më ra mua kjo fatkeqësi?”. Ai beson se gjithçka është një provë dhe se buron prej një urtësie. Për rrjedhojë, ai nuk ankohet, nuk revoltohet dhe nuk tenton të vrasë veten. Ky ishte besimi dhe dorëzimi që i bëri të fortë profetët dhe të dashurit e Allahut.

Këtu po japim një shembull në lidhje me pranimin e kaderit dhe dorëzimin ndaj Zotit: Tenisti amerikan Arthur Ashe, i cili kishte fituar turneun e tenisit në Wimbledon më 1975, shtrohet në spi-

tal për shkak të infektimit me virusin e AIDS, që e kishte marrë gjatë një transplantimi të gjakut. Ky lajm u përhap me shpejtësi në të gjithë botën. Një prej admiruesve të tij, i shkroi një letër të cilën e fillon me pyetjen: “Përse ti?” Pastaj vazhdonte duke thënë: “Në botë ka 5 miliardë njerëz. Përse të ra ty kjo sëmundje? Përse Zoti të zgjodhi ty midis gjithë këtyre njerëzve?..” Kampioni, i cili tashmë gjendej në shtratin e vdekjes, i kthen këtë përgjigje admiruesit të tij: “Në të gjithë botën rreth 50 milion fëmijë fillojnë të luajnë tenis, por vetëm 5 milion prej tyre e mësojnë atë. 500 mijë prej tyre bëhen profesionistë, 50 mijë marrin pjesë nëpër gara, 5 mijë garojnë nëpër turne, 50 arrijnë deri në Wimbledon, 4 arrijnë në gjysmëfinale, 2 në finale dhe vetëm 1 prej tyre fiton kupën e turneut. Kur unë fitova Wimbledonin dhe ngrita kupën e kampionit, nuk e pyeta Zotin, “përse unë?” E si mund ta pyes unë tani, “përse unë”, kur ndodhem në një qoshe të spitalit duke vuajtur nga krizat? Kjo është shprehja e një dorëzimi të vërtetë. Ky besim nuk ka ndikim kalimtar si ilaçet qetësues.

Besimi në kaderin, është ilaçi i qedereve. Ky është besimi që ëmbëlson dhimbjet, që lehtëson vështirësitë, që i kthen të përpjetat në tatëpjeta, vuajtjet në mirësi dhe depresionin në qetësi. Profeti ynë (a.s.), me këtë besim dhe me këtë dorëzim, ka realizuar revolucionin më të madh në botë. Ashtu siç e ka jetuar vetë këtë dorëzim, ai ia ka këshilluar edhe besimtarëve. Kur ai bëhej gati për të fjetur, merrte abdest, shtrihej në të djathë dhe bënte këtë dua: “O Allahu im! Shpirtin tim ta dorëzova Ty. Çështjen time ta kam dorëzuar Ty, fytyrën time e ktheva kah Ti, shpinën time e mbështeta tek Ti, duke shpresuar tek Ti e duke u frikësuar prej Teje. Nuk ka shpëtim dhe as strehim tjetër përveçse tek Ti; I kam besuar librit Tënd, Kuranit, të cilin e ke zbritur dhe Profetit Tënd, Muhamedit, të cilin e ke dërguar!” (Buhari, Udu, 75.)



JETA QË NUK VIHET NË PYETJE, NUK ËSHTË E JETUAR!

— Mehmet Bash —

Njeriu duhet të pyesë. Njeriu që nuk pyet, është i dënuar të skllavërohet. Çdo njeri duhet t'ia bëjë vetes pyetjet: “Përse kam ardhur në këtë botë?” dhe “Cila është urtësia e qëndrimit tim të përkohshëm në këtë botë?” Një jetë që nuk është vënë në pyetje dhe nuk i është dhënë përgjigje, nuk është reale. Një jetë e tillë, është si një çek fals.

Nëse ia dorëzojmë vullnetin tonë sistemit të kohës si një gjethe në erë, nuk mund të jemi asgjë tjetër përveçse një objekt konsumi brenda imponimit ekonomik ekzistues dhe një botëkuptimi materialist. Pra, do të ulemi vetëm në nivelin e një objekti. Nëse ia mbyllim gojën mendjes, zemrës dhe ndërgjegjes, të cilat e bëjnë njeriun më superior ndaj krijesave të tjera, atëherë nuk do të konsiderohemi më të gjallë.

Si do të jetë në fakt, po ta pyesim njëherë veten!? A kemi ardhur në këtë botë për të paguar kështet e sendeve që i blejmë me kredi? Kemi ardhur që dashurinë, të cilën nuk e tregojmë për njeriun, ta tregojmë për ndërtesat prej guri dhe makinat prej metali? Kemi ardhur për t'i vënë llozin zemrës ndaj të varfërve dhe të bëhemi servilë para të pasurve? A mos kemi ardhur në këtë botë për ta konsumuar jetën duke rendur pas gjërave të kota e të padobishme? Po, njeriu duhet të pyesë. Ai duhet ta dijë përse ka ardhur në këtë botë. Njeriu nuk e kupton dhe nuk e percepton një çështje për të cilën nuk është i vetëdijshëm. Ekzistenca jonë varet nga kuptimi që ne i japim asaj.

Ta zëmë se i shijuar të gjitha kënaqësitë e botës. Çdo ditë e jona kaloi në lumturi, pa shqetësime, pa hidhërime. Por, deri kur do të vazhdojë kështu? Çfarë tjetër ka bërë kjo botë përveçse ka bluar atë që kemi korrrur në këtë jetë? Çfarë tjetër ka bërë kjo tokë që e shkelim përditë, përveçse na ka marrë të dashurit një nga një? A nuk është vendi ku do të shkojmë edhe ne?

Le ta ngremë pak kokën prej programeve të garave, ndeshjeve të futbollit dhe telenovelave ku jemi zhytur dhe të shohim trenin e jetës që është duke shkuar. A

nuk e vëmë re ndërtesën e jetës tonë se si po bëhet gërmadhë, duke iu shkëputur përditë nga një gur? A nuk u mërzitëm së pozuari lumturinë tonë falsë?

Shumica prej nesh, në bazë të besimit, e dinë shumë mirë se jeta e kësaj bote është vetëm lojë dhe argëtim. Po ashtu, në bazë të besimit, e dimë edhe se ne nuk jemi krijuar vetëm për këtë botë. E megjithatë, ne investojmë çdo gjë në jetën e kësaj bote, sikur vdekja të mos ekzistonte dhe sikur do të jetojmë përjetë në këtë botë.

Shejtani dikujt prej nesh i afrohet nga e majta dhe ai haramet i bën hallall në mënyrë të hapur. Dikujt tjetër i afrohet nga e djathta, duke ia përlyer veprat e tij të pastra me mendjemadhësi. Ai na mbyt në shirkun e fshehtë, ndërsa ne pandehim se kemi fituar. Mirëpo nuk e kuptojmë fare se kemi humbur.

Të gjithë e dimë se jeta e kësaj bote nuk është një vend i domosdoshëm, sepse, nëse do të ishte i domosdoshëm, bota nuk do të konsumohej kështu vetvetiu. Jeta shpenzohet dhe ikën duke rendur vazhdimisht pas shtëpisë, makinës dhe pozitës. Ndërkohë, pas mbetet një libër i mbushur me armiqësi, thyerje zemrash, turli farë dallaveresh dhe gjynahe të shumta.

A kaq e lirë dhe e pakuptimtë është jeta? Fakti që shumë njerëz e kanë lënë veten nën drejtimin e stomakut dhe organit seksual, a nuk tregon se ata kanë mbetur në nivelin e kafshës, në mos edhe më ulët se ato? Ndërkohë që grada më e lartë është të krijohesh si njeri dhe të dërgohesh në këtë botë si njeri, cili është kuptimi i faktit se njeriu e hedh veten në humnerën e indiferentizmit?

Ne jemi të detyruar të gjejmë të vërtetën duke ardhur rreth e qark këtyre pyetjeve dhe çështjeve. Për këtë arsye, ne themi se një jetë e cila nuk vihet në pyetje, nuk është jetuar fare. E lusim Allahun e Madhëruar që zemrat tona ta shohin bregun e së vërtetës si shpëtim dhe t'i drejtojnë anijet për në atë liman.



Mbi Suren Inshirah...

*Surja
el-Inshirah,*

— Prof. dr. Irfan Gyndyz —

*është zbritur në Mekë pas
sures ed-Duha dhe ka tetë ajete.
Asaj i është dhënë ky emër për shkak se
i ka sjellë qetësi shpirtërore të Dërguarit të
Allahut (a.s.). Kjo sure ishte qetësimi i zemrës së
Profetit (a.s.), me besim, ndriçimi i tij me urtësi e dituri
dhe pastrim prej gjynaheve.*

Të Dërguarit të Allahut (a.s.), i ishte ndërprerë shpallja dhe kishte filluar një periudhë pikëllimi e quajtur “fetret-i uahj / ndërperja e shpalljes”. Pas ditëve kur i Dërguari i Allahut (a.s.), i kishte fiksuar sytë nga qielli duke pritur me një gjendje shpirtërore prej nevojtarit, si shpërblim i mbështetjes tek Allahu i Madhëruar, Profecia e tij iu bë e ditur botës me anë të ndërrimit të Kiblës. Më pas, suret ed-Duha dhe Inshirah, u zbritën si myzhde për qetësimin e shpirtit të tij.

Këtu bëhet fjalë për një, “dik-i sadr / ngushtim gjoksi”, i cili duhet të vlerësohet dhe të kuptohet drejt. Pra, nuk është e drejtë të mendohet se Profeti (a.s.), ka pësuar një lloj gjendjeje shpirtërore të thjeshtë siç është stresi. Kjo ishte një gjendje e rëndë që Profeti po përjetonte për shkak të përgjegjësisë së madhe që ai ndjente.

Në periudhën kur u ndërpre shpallja, në zemrën e Profetit (a.s.), duhet të jetë shfaqur një shqetësim i tillë, si “*vallë a mos kam bërë diçka që ka shkaktuar ndërprerjen e shpalljes!*?”. Ashtu

si njerëzit që u janë plasur buzët nga etja për vite me radhë dhe i mbajnë sytë nga qielli duke u lutur dhe duke pritur për shi, ashtu edhe ai priste shiun e shpalljes prej Allahut të Madhëruar.

Folja “*neshrah*”, në ajetin: “**Vallë, a nuk ta hapëm ty kraharorin!?**”, ka kuptimin e hapjes së gjërave, si mish apo diçka të ngjashme, të çash dhe të zgjerosh. Ndërsa fjala “*sadr*”, do të thotë “gjoks ose kraharor”.

Si shprehje, “*sherh-i sadr*”, do të thotë, “*hapje e kraharorit*”, ndërsa si koncept, do të thotë, “*qetësim shpirti dhe zemre*”. Po ashtu, ajo nënkupton një gëzim shpirtëror, një ankth të madh, dije dhe durim të madh. Profeti (a.s.), ishte mërzuar jashtë mase për shkak të ndërprerjes së shpalljes. Atë kishte filluar ta kapte shqetësimi se, “*mos vallë u braktisa?*”. Madje, një grua e cila e vuri re këtë gjendje të tij, e pyeti: “*Nuk po të shoh më bashkë me shokun tënd. Mos vallë edhe ai është mërzuar me ty e të ka braktisur?*”. Në suren ed-Duha, duke aluduar këtë ndodhi, jepet myzhdeja: “**Zoti yt**

nuk të ka braktisur, e as nuk të urren!”. E më pas është zbritur surja el-Inshirah.

Përdorimi i fjalës “sadr/kraharor”, në vend të fjalës “kalb/zemër”, ka një urtësi të madhe. Shejtani përpiqet të hyjë nga kraharori për t’i futur vesvese zemrës. Kraharori është mburoja e zemrës. Nëse shejtani hap qoftë edhe një të çarë aty, ai fillon t’i fusë zemrës vesvese. Në këtë mënyrë, në zemër fillon të lindë hidhërimi, pikëllimi dhe mendimet e gabuara.

Lehtësimi i barrës, që shprehet në ajetin: “**A nuk ta hoqëm barrën?**”, nënkupton barrën që është e pamundur të mbahet nga fuqia njerëzore dhe dhënia e një force që mund ta pranojë dhe ta bartë peshën e shpalljes hyjnore. Kjo është edhe ajo që dëshiron të thotë Ebu Hajjan kur shprehet se: “*Të hapësh kraharorin, do të thotë: Ta ndriçosh atë me urtësi dhe të qetësosh dikë me qëllim që ai të pranojë atë që i shpallet*”.

Transmetohet se që prej fëmijërisë, e deri në mrekullinë e Miraxhit, fenomeni i “sherh-i sadr / hapja e kraharorit”, ka ndodhur katër herë tek Profeti (a.s.). Kurse fenomeni i “Shakk-i sadr / çarjes së kraharorit”, pranohet unanimisht nga dijetarët se ka ndodhur në dimensionin shpirtëror, edhe pse disa dijetarë mendojnë se mund të ketë ndodhur edhe në dimensionin fizik. Me sa duket, ekziston një proces pastrimi dhe rafinimi, me qëllim që të gjithë profetët të ngrihen në pozitën e pranimit të shpalljes. Në Kuranin Fisnik, për të gjithë profetët dhe Merjemen përdoret folja “*të zgjedhësh*” në disa forma, si “*istafa, istafejtuke, istafaki dhe jestafi*”, ndërsa për Profetin tonë (a.s.), kjo fjalë përdoret edhe si mbiemër, “*Mustafa/ i zgjedhur*”. Kjo fjalë shpreh faktin se të gjithë Profetët kanë kaluar nga një proces i tillë përzgjedhjeje, i cili në suret ed-Duha dhe el-Inshirah, nënkuptojnë një pastrim dhe purifikim të zemrës dhe të shpirtit. Fakti që fjala Tasavuf, që do të thotë “pastrim i njeriut nga dobësitë”, tregon se ajo vjen prej së njëjtës rrënjë dhe se tasavufi ka për qëllim pastrimin e zemrës dhe të egos. Kjo, është shumë e rëndësishme edhe në aspektin e tregimit të burimit të kësaj dijeje, edhe në aspektin e tregimit të metodologjisë së saj.



*Në jetën tonë
të përditshme,
nuk ka vend për punë të
panevojshme dhe fjalë të
padobishme. Myslimani
është një njeri që largohet
prej punëve të kota dhe të
pakuptimita, nuk u lë vend
atyre në jetën e vet dhe
përpiqet të bëjë punë të
mira dhe të jetë
prodhues.*

Folja “ueda’na” do të thotë, të vendosësh, të ngresh, ndërsa fjala “uizr”, do të thotë barrë, vështirësi dhe gjynah. Mirëpo, shprehja, “*barra që të kërrus belin*”, nuk është në kuptimin, barra e gjynahut, por në kuptimin e vështirësisë, peshës dhe ankthit që përjetohet. Fjala “uizr” në këtë ajet, shpreh përgjegjësinë shpirtërore. Kjo mendohet të jetë pesha e amanetit të shenjtë që toka dhe qiejt ngurruan ta pranojnë, pesha e rëndë e shpalljes hyjnore që do t’i copëtonte edhe malet.

Ashtu si ngjitja e Profetit (a.s.), në shpellën Hira nuk ishte një ikje nga Meka, por përkundrazi një marshim drejt çlirimit të saj, edhe takimi i tij me shpalljen hyjnore, nga një anë ishte shpëtim prej vështirësive, ndërsa nga ana tjetër ishte takim me përgjegjësi të reja. Në ajetin, “**(barrën) e cila ta kërrus tepër kurrizin!?**”, folja “*enkada*”, do të thotë, “*të përkulë, të thyen*”, ndërsa fjala “*dhahr*”, do të thotë, “*kurriz ose mbrapa*”. Nisur nga kjo, shprehja, “*inkad-i dhahr*”, do të thotë, “*thyerje ose kërcitje e shpinës për shkak të peshës së rëndë*”. Fjala “*nakid*”, shpreh zërin që nxjerrin koshat ose brinjët, kur mbi deve vendoset ndonjë peshë e rëndë. Kur Profeti (a.s.), tha: “*Mua më ka plakur surja Hud*”, ai u pyet: “*Përse o i Dërguar i Allahut?*”. Dhe Profeti (a.s.), u përgjigj: “*Përpikëria që kërkon urdhri i Allahut «Bëhu i drejt ashtu siç je urdhëruar!», ma kërrusi belin.*” Kjo shprehje e Profetit (a.s.), na ndihmon

shumë në kuptimin e kësaj peshe për të cilën bëhet fjalë.

Ne mendojmë se kjo “barrë”, është përgjegjësia e rëndë e të qenit profet. Duke u nisur edhe nga ajeti: “**Ne do të të dërgojmë vërtet një fjalë me peshë të rëndë!**”, mund të themi se është e qartë se barra që i është ngarkuar Profetit tonë (a.s.), është vetë shpallja hyjnore.

Folja, “*rafe’na*”, në ajetin: “**(a nuk) e ngritëm lart emrin/famën tënde?**”, ka kuptimin, “*të ngresh*”, ndërsa fjala “*dhikr*”, ka kuptimin, “*famë, lavdi, nder, shpallje dhe Kuran*”. Kurse shprehja “*ngritëm lart emrin/famën tënde*” që përdoret në këtë ajet, nënkupton përmendjen e emrit të Profetit tonë (a.s.), së bashku me emrin e Allahut

në “formulën e dëshmisë Islame” dhe në “tehijat”. Po ashtu, emri i Profetit (a.s.), filloi të përdorej edhe në ezan, në hutbe, në vaaze, në ligjërime, në libra dhe në salavate.

Ngritja e emrit të bekuar të Profetit tonë (a.s.), duke u përmendur në mënyrë të bukur në këtë ajet, ka parandaluar nënvlerësimin e emrit të tij. Gjatë historisë ka pasur prej atyre që i kanë nënvlerësuar dhe përçmuar emrat e profetëve, por megjithatë, ata nuk mund t’ua ulin vlerat atyre. Në fakt, ata dhe ndjekësit e tyre vetëm sa ulin veten e tyre.

Ai ishte një njeri që Allahu i Madhëruar e ngriti me cilësitë si, “*i Dërguari i Allahut*”, “*Vula e Profetëve*”, “*Shembulli më i bukur*” dhe “*Mëshirë për botët*”. Për rrjedhojë, asnjë njeri nuk mund ta përçmojë atë. Përveç kësaj, në Kuran urdhërohet respekti ndaj Profetit (a.s.), me këtë shprehje: “**Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe melekët e Tij lutën për atë. O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me “selam”!**” (Ahzab, 56)

Në ajetin: “**Me të vërtetë, pas vështirësisë - vjen lehtësimi!**”, theksohet se ashtu siç vështirësitë e shkuara ia kanë lënë vendin lehtësive, edhe për vështirësitë e ardhshme do të jepen lehtësi të reja.

Ndërsa në ajetet: “**Prandaj, kur të çlirohesh (nga një punë), përpiku fort dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!**”, tërhiqet vëmendja në dy çështje: E para është se botëkuptimi i “kohës së lirë” nuk mund të zërë vend në axhendën e një myslimani dhe e dyta, është domosdoshmëria e kërimit të kënaqësisë së Allahut në çdo punë. Fjala “*Usr*”, ka kuptimin e vështirësisë, vuajtjes, ngushtimit të gjoksit, peshës së detyrës, etj. Ndërsa fjala “*Jusr*”, do të thotë, lehtësi.

“Lehtësimi” në këtë kuptim, shpjegohet edhe në ajetet 5-7 të sures el-Lejl, ku urdhërohet: “**Sa për atë që jep (për hir të Allahut), ka frikë (nga Ai) dhe dëshmon për vërtetësinë e më të bukurës (besimit), Ne do t’ia lehtësojmë atij rrugën drejt shpëtimit.**”, dhe në ajetin 100 të sures en-Nisa: “**Kush mërgon për çështjen e Allahut, ai gjen shumë vendbanime dhe begati në tokë. Kush lë shtëpinë e vet, duke u shpërngulur për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij dhe ndodh që t’i vijë vdekja, Allahu me siguri do ta shpërblejë. Se Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.**”

Mesazhi që na jepet këtu, është se, në vend që

të mos përballemi me vështirësitë që hasim dhe të mos bëhemi pjesë e problemeve duke ikur prej tyre, ne duhet të luftojmë pa u mërzhitur dhe pa u demoralizuar. Nëse vihet re me kujdes, shprehja që përkthehet, “*sapo të lirohesh*”, tërheq vëmendjen drejt vendosmërisë së vazhdueshme...

Folja “*feragte*”, do të thotë, “*të mbarosh, të lirohesh*”, ndërsa urdhri “*insab*”, do të thotë, “*të ngrihesh, të qëndrosh drejt*”. Kurse urdhri “*irgab*” në fjalinë “**drejtohu nga Zoti yt**”, do të thotë, “*të dëshirosh, të orientoresh, të drejtoresh*”.

Këtu, në mënyrë të veçantë i drejtohet Profetit (a.s.). Kur realizohet një çështje e urdhëruar në lidhje me shpalljen, tërhiqet vëmendja që menjëherë të kalohet në realizimin e një çështjeje tjetër. Myslimani është i detyruar që çdo ditë të përparojë. Këtë ka dashur të thotë edhe Profeti (a.s.), kur është shprehur: “*Është në humbje ai që i ka dy ditë të njëjta.*”

Fjala “*nesab*”, do të thotë, obelisk ose lapidar. Duke u nisur nga kjo, mund të themi se, kuptimi i ajetit, është: “*kur të mbarosh një punë, ose të kesh shpëtuar prej një vështirësie, qëndro drejt dhe i fortë!*” Këtu përballemi me një tjetër urdhër të rëndësishëm që u jepet besimtarëve. Myslimani është njeri i cili qëndron drejt pa u lëkundur përballë vështirësive.

Fjala “*fergab*” që përmendet në ajet, është lexuar edhe në formën “*feraggib*”. Nisur nga kjo, kuptimi i ajetit, mund të jetë edhe: “*...dhe drejtoji të tjerët vetëm tek Zoti!*”. Kjo, sepse myslimani, përveç vetes, ka për detyrë që edhe të tjerët t’i orientojë tek Allahu.

Në jetën tonë të përditshme, nuk ka vend për punë të panevojshme dhe fjalë të padobishme. Kjo çështje, e cila në Kuranin Fisnik shprehet me fjalën “*lagv*”, Profeti (a.s.), e shpjegon duke thënë: “*Qëndrimi larg prej punëve dhe fjalëve të padobishme e të panevojshme, është prej bukurisë së moralit të njeriut.*” Myslimani është një njeri që largohet prej punëve të kota dhe të pakuptimta, nuk u lë vend atyre në jetën e vet dhe përpiqet të bëjë punë të mira dhe të jetë prodhues.

Fakti që shprehja “*ila rabbike*” vjen para urdhrit “*fergab*”, është për të theksuar se pika e vetme ku duhet të përqendrohet orientimi, është Allahu i Madhëruar.

Edukata dhe finesa NË SHËRBIM

— Mustafa Imamollu —

Përreth mbretërve gjenden shumë shërbëtorë dhe skllavë. Këta garojnë me njëri-tjetrin kush e kush t'i ofrojë mbretit një shërbim sa më të mirë. Në këtë mënyrë, në bazë të nivelit të tyre të edukatës, delikatesës, mirëkuptimit, aftësisë dhe urtësisë në shërbim, ata fitojnë dashurinë e mbretit dhe bëhen të afërt me të. Për këtë arsye, shërbyesit dhe skllavërit presin gjithë ditën një mundësi për t'i shfaqur mbretit dashurinë, respektin dhe aftësitë e tyre. Ata garojnë me njëri-tjetrin për të shfaqur shërbimin më të sinqertë, më të përsëritshëm dhe më delikat. Kjo, sepse ata mendojnë se afërsia ndaj mbretit arrihet vetëm me anë të shërbimit dhe se ajo është mundësia më e madhe për të arritur dashurinë e tij. Në këtë garë për shërbim nuk mungojnë asnjëherë edhe ndjenjat e këqija, si smira dhe zilia. Mirëpo, njeriu ia shton vlerën vetes me anë të fjalëve dhe sjelljeve, delikatesës dhe edukatës në shërbim. I dashuruari e kalon kohën me atë që dashuron dhe përpiqet t'i shërbejë me gjithë shpirt njeriut që dashuron.

Në Tefsirin *"Ruhu'l-Bejan"*, shënohet një tregim shumë mbresëlënës dhe mësimdhënës:

"Na ishte njëherë një mbret, i cili e kishte marrë më afër vetes njërin prej skllavëve dhe shërbyesve të tij. Ai e donte dhe e vlerësonte atë më shumë se të tjerët. Aq sa shërbëtorët e tjerë nuk e duronin dot atë. Madje, ata nuk arrinin ta kuptonin se nga buronte gjithë kjo dashuri e mbretit për atë skllav. Në pamje të jashtme, ai skllav nuk ishte as më i bukur dhe as më i aftë se të tjerët. Mirëpo, mbreti e kishte bërë të afërt ndaj vetes dhe dashurinë që kishte ndaj tij e mbante shumë më lart se të tjerët. Shërbëtorët e tjerë e vinin re këtë, por nuk arrinin t'i jepnin asnjë kuptim kësaj gjendjeje.

Një ditë, mbreti deshi t'u japë atyre një mësim. Prandaj mori shokët dhe shërbëtorët dhe doli për shëtitje në pyll. Ishte stinë vere, shumë nxehtë. Sytë e mbretit u fokusuan për një moment tek një mal i largët, maja e të cilit ishte mbuluar me borë. Mbreti

pa vetëm njëherë për pak çaste nga mali, pastaj e uli shikimin para vetes.

Skllavit që kishte fituar afërsinë me mbretin, nuk i shpëtoi ky detaj. Ai mori një kalë dhe u largua menjëherë prej aty. Të gjithë ishin çuditur nga fakti se skllavi e shaloi kalin dhe iku pa i thënë gjë mbreti. Asnjëri prej tyre nuk arriti të kuptonte ikjen e shpejtë të atij skllavi.

Pa kaluar shumë kohë, skllavi kthehet me një sasi bore, të cilën ia ofroi menjëherë mbretit. Për rrjedhojë, mbreti mbeti shumë i kënaqur prej urtësisë dhe shërbimit të tij. Prandaj e shpërbleu mirë atë. Ata që ishin pranë mbretit, iu afruan skllavit dhe, duke dashur ta kuptonin më mirë këtë punë, e pyetën atë:

"Si e kuptove që mbreti dëshiroi borë?"

Skllavi, zemra e të cilit ishte e mbushur me dashuri, u përgjigj duke buzëqeshur:

"Sepse ai pa drejt e në majën ku gjendej bora dhe jo në ndonjë pjesë tjetër të malit." Pastaj vazhdoi duke thënë një fjalë të urtë:

"Mbretërit nuk shohin kot asgjë dhe asnjë anë!"

Pas kësaj përgjigjeje, të pranishmit e kishin kuptuar se përse mbreti e donte shumë atë skllav. Tashmë ishte e qartë se vlerësimi i lartë i mbretit për atë skllav, ishte për shkak të zgjuarsisë dhe urtësisë së tij. Kur mbreti e dëgjoi përgjigjen e tij, u tha të pranishmëve:

"Ja pra, pikërisht për këtë arsye unë e kam marrë atë afër vetes, e dua dhe e vlerësoj më shumë se ju. Ju shihni gjithmonë veten tuaj, ndërsa ai më ruan dhe është gjithmonë në shërbimin tim."

Po!.. Njeriu e bën veten të dashur në sajë të shërbimit që bën! Dhe në sajë të edukatës në shërbim, urtësisë dhe mirëkuptimit, ai shton afërsinë e tij me të tjerët!.. I dashuruari e tregon dashurinë e tij gjithmonë duke shërbyer!..



LUFTI PASHA

BURRËSHTETAS DHE MENDIMTAR I PËRMASAVE BOTËRORE

— Dr. Ardian Muhaj —

Lutfi Pasha i njohur si Damat Çelebi Lutfi Pasha lindi rreth vitit 1488 dhe vdiq më 27 Mars 1564.

Ai ishte shqiptar. Arriti deri në shkallën e kryevezirrit ose sadrazam i shtetit osman në kohën e Sulejmanit I, në vitet 1539 deri në 1541. Detyrën e tij të parë me rëndësi e arriti kur u emërua sanxhakbe i Kastamonit. Më pas u emërua bejlerbe i Karamanit dhe sanxhakbe i Ajdinit, përpara se të transferohej në Rumeli si sanxhakbe i Janinës. Në vitet 1534-1535 u bë Vezir i Tretë. Mori pjesë nën Sulejmanin I në fushatat e Beogradit më 1521, të Rodit më 1522 dhe Vjenës më 1529. Ishte pa dyshim përveçse një nga burrështetasit më të rëndësishëm të botës në shek. XVI edhe një nga mendimtarët më të mëdhenj të kohës.

Në maj të vitit 1541 Kryeveziri Lutfi Pasha, pas një mandati të shkurtër por të suksesshëm, u shkarkua nga Sulejmani I. Shkarkimi i tij nga posti i dytë më i rëndësishëm në shtetin osman ai i Kryevezirrit nuk erdhi si pasojë e paaftësisë apo korrupsionit, por për shkak të mosmarrveshjeve familjare. Ai ishte martuar me të motrën e sulltan Sulejmanit të Madhërishëm dhe vdiq disa vite më vonë, i tërhequr në pronat e tij në Dimetokë, një qytezë që sot ndodhet në Greqi në afërsi të kufirit me Turqinë. Në vendin e pleqërimit të detyrueshëm ai iu kushtua studimeve dhe sidomos historisë dhe filozofisë dhe fesë. Ka shkruar 21 vepra, 13 prej tyre në arabisht dhe 8 në osmanisht. Dy nga veprat më me rëndësi të tij janë "Asafname", një manual për mënyrën e sjelljes dhe suksesit të ministrave dhe vepra historike "Tevârih-i Âl-i 'Osmân", që trajton historinë osmane duke përfshirë edhe përvojën e dëshmitë e veta në sundimin e Bajazitit II, Selimit I dhe Sulejmanit I.¹ Libri i Asafit, titullohet kështu sipas figurës biblike që në traditën myslimane ishte veziri i Mbretit Solomon dhe modeli ideal i ministrit të mençur dhe besnik.² Libri i Lutfi Pashës, megj-

thatë, është më shumë se një manual këshillash për qeverimin e mirë.³ Ai na thotë se kur u bë Kryevezir e gjeti Divanin e Lartë në një pështjellim të madh dhe shumë gjëra në kundërshtim me ligjet themelore të Perandorisë. Prandaj ndjeu përgjegjësinë për të përshkruar rezultatet e përvojës së tij, për udhëheqjen e atyre që pas tij do të thirren të plotësonin këtë detyrë të madhe përtej së cilës asnjë nënshtetas osman nuk mund të aspirojë. Pra për të dhënë këshilla praktike dhe parime etike për kryerjen e punëve të shtetit.

Lutfi Pasha thekson se Kryeveziri duhet të ruajë sovranin, pra Sulltanin, nga dashuria për para dhe nga pasojat negative të lakmisë. Të kontrollojë dhe të kujdeset që të respektohen të drejtat pronësore të nënshtetasve «sepse përvetësimi masiv i pasurisë së popullit dhe kalimi i saj në pronën e sovranit është një shenjë e kalbjes në shtetit.» Veziri i Madh apo Kryeministri, duhet të jetë i sinqertë dhe i drejtë në marrëdhëniet e tij me Sulltanin dhe pa frikë nga shkarkimi. «Është më mirë të dorëhiqemi dhe të jemi të respektuar nga njerëzit sesa të bëjmë shërbim të pandershëm».⁴ Mbi të gjitha, ai duhet të jetë i vetëdijshëm për rrezikun e dhuratave nga burimet e pista. «Për zyrtarët e shtetit, korrupsioni është një sëmundje pa ilaç. Kini kujdes, ruhuni nga korrupsioni. O Zot, na shpëto prej tij!».⁵ Lutfi Pasha rrëfen gjithashtu në shifra konkrete se të ardhurat e tij si Kryevezir arri- nin në rreth 2 milion e gjysmë akçe, «që falë Zotit, është, në shtetin osman, një bujari të mjaftueshme». Nga këto gjysmë milioni i jepte për bamirësi, gjysmë milioni i kursente në thesarin e tij dhe pjesa tjetër shkonte për shpenzime të oxhakut dhe rangut të tij. Ai gjithashtu shpreh këndvështrimin e tij mbi koston e jetesës së popullsisë. «Kontrolli i çmimeve është një përgjegjësi e rëndësishme publike, dhe Veziri i Madh duhet t>i kushtojë kujdes të veçantë kësaj. Nuk është e drejtë që një zyrtar i lartë të jetë tregtar i orizit ose që postin e tij ta përdorë për privilegje në tregti. Mbajtja nën kontroll i çmimeve dhe luftimi i

1. M. Th. Houtsma, sv, në *First Encyclopaedia of Islam*, E. J. Brill's, 1913-1936, f. 55.

2. Bernard Lewiss, "Ottoman observers of Ottoman decline", *Islamic Studies*, Vol. 1, No. 1 (1962), pp. 71-87.

3. Botuar gjermanisht nga Rudolf Tschudi, *Das Asafname des Lutfi Pascha*, Berlin 1910. Mbi Lutfi Pashën shih edhe F. Babinger, *Die Geschichtsschreiber der Osmanen und ihre werke*, Leipzig 1927, f. 80-1.

4. Asafname 12-13.

5. Asafname 14-15.

spekulimit me to, është në interes të të varfërve”.⁶

Në lidhje me emërimet në postet qeveritare Lutfi Pasha porositi që Kryeministri duhet të bëjë emërime dhe promovime vetëm në bazë të meritës dhe kompetencës, pa favorizim apo interes. Ai duhet të japë vetëm disa prona të vogla për ndjekësit e tij, të mbajë disiplinën dhe të respektojë rendin e përparësisë dhe vjetërsisë. Ai nuk duhet të pranojë asnjë ndikim ose presion në emërimin e funksionarëve shtetërorë, por të ndjekë gjykimin e tij. Ai duhet të hetojë ankesat kundër zyrtarëve të vegjël dhe gjyqtarëve, dhe, kur është e nevojshme të urdhërojë edhe shkarkimin e tyre.

Në kapitullin e dytë, mbi funksionin ushtarak të Vezirit të Madh, Lutfi Pasha tërheq vëmendje të veçantë për nevojën e forcimit të flotës detare. Ai citon me miratim një vërejtje të Kemalpashazades (vdekur më 1533-4), për Selimin I: «Madhëri, ju banoni në një qytet, furnizuesi i të cilit është deti. Nëse deti nuk është i sigurt, asnjë anije nuk do të vijë». Ai vetë i kishte thënë Sulltan Sulejmanit, që shumë prej Sulltanëve të mëparshëm sundonin tokën, por pak prej tyre sunduan detin. “Në aspektin e fuqisë detare, të huajt janë para nesh, prandaj ne duhet t > ua kalojmë atyre.” Kapitujt e tretë dhe të katërt merren me buxhetin dhe çështjet agrare. “Sulltanati i ka themelet në thesarin e vet. Thesari mbahet përmes menaxhimit të mirë. Nga padrejtësia (zulmi) të ardhurat bien dhe thesari boshatiset.”⁷ Veziri i Madh duhet të shohë e të sigurojë që të ardhurat të jenë më të mëdha se shpenzimet dhe duhet të ruhet nga rritja e stafit të tij. Ushtria duhet të jetë e mirë dhe jo e madhe. Listat e pagave të ushtrisë duhet të mbahen të sakta dhe të përditësuara. Një ushtri me page, prej 15.000 burrash është e mjaftueshme dhe të paguhet rregullisht. Tatimi i të ardhurave dhe mbledhja e tyre duhet t > u caktohet komisionerëve të qeverisë dhe jo tagrambledhësve të nënkontraktuar. Taksat e jashtëzakonshme të mbledhura nga fshatarësia nuk duhet të jenë as shumë të rënda e as shumë të shpeshta dhe duhet të ndërmerren hapa për të parandaluar shpëpullimin e fshatrave.

Kështu, në mes të shek. XVI, kur Perandoria Osmane ishte në kulmin e fuqisë dhe të lavdisë së saj, një burrë shteti shumë i vëmendshëm, tashmë ishte thellësisht i shqetësuar për fatin dhe mirëqenien e këtij shteti dhe ishte në gjendje të tërhiqte vëmendjen pikërisht në ato çështje që u bënë, në vitet në vijim, shenjat karakteristike të rënies osmane. Inflacioni, spekulimi dhe paaftësia, zmadhimi i ushtrisë dhe i burokracisë së padobishme dhe parazitike; rrethi vicioz i shpërdorimit fiskal, shtrëngimi financiar dhe ekonomik, prishja e integritetit dhe besnikërisë dhe përtej këtyre të gjithave, hija gjithnjë e më kërcënuese e shteteve detare të Perëndimit, të gjitha këto tashmë

ishin parashikuar nga Lutfi Pasha ndërsa qëndronte në fermën e tij. Siç e thekson Bernard Lewis, “debati i gjatë mbi arsyet e rënies së Perandorisë Romake filloi, mbasi plaçkitja e Romës nga Alariku dhe Visigotët e tij e bënë të qartë dobësinë e shtetit romak, ndërsa debati mbi rënien e Perandorisë Osmane filloi kur Perandoria ishte në kulmin e saj dhe filloi nga mesi i vetë osmanëve.”⁸

Ndjeshmëria e Lutfi Pashës, aftësia e tij për të perceptuar dhe lidhur kauzën dhe efektin në procesin historik në të cilin ai ishte pjesë, ndërgjegjja e tij e shqetësuar për dobësinë dhe prishjen e trupit politik e gjen shprehjen e qartë në doracakun e tij për ministrin ku, ndryshe nga euforia e zakonshme e historiografisë orientale, ai tregon jo vetëm gabimet dhe dështimet e kolegëve dhe paraardhësve të tij ministrorë, që është mjaft e zakonshme, por edhe krisjet dhe plasaritjet që janë shfaqur në shtyllat e shtetit dhe shoqërisë. Vepra e Lutfi Pashës ishte e para e një serie të gjatë të shkrimeve të ngjashme, në të cilat kërkesa urgjente për reforma jep mundësi që pesimizmi për një epokë të humbur të Artë të shndërrohet kohë mbas kohe në besim të osmanëve në aftësinë e tyre për të rivendosë madhështinë e venitur të së kaluarës.

Ja si e përshkruan Lutfi Pashën një autor me të cilin u takua në Mekë gjatë kryerjes së haxhit. “Në ministrinë e lartë u emërua Lutfi Pasha që i përkiste racës shqiptare dhe ishte memalik i Sulltan Selim Hanit. Njeri me vlera, personalitet dhe autor i shumë punëve të mira. Ka shkruar në turqisht një libër ku shpjegon ‘Fikhul-ekber’ të imanit tonë të madh Ebu Hanife En-nu‘manë. Në detyrën e kryeministrit ka lënë gjurmë të mira, mes të cilave spikat prej nënshtrimi i «vlllehëve» të cilët në kohën e tij ishin të shumtë në numër dhe shkaktonin shumë grabitje ndaj i tyre udhëtarëve. Rrugët nuk rrinin kurrë pa to, të cilët grabitnin udhëtarin, i merrnin kafshën me forcë e kështu me radhë nuk shpëtonte asnjë udhëtar. Kështu që sapo mori në dorë Veziratin e Lartë zvogëloi numrin e tyre dhe vendosi që mos t’u ngarkojë «vlllehëve» detyra të shumta përveçse për gjëra tepër të rëndësishme sulltanore që kishin të bënin me lajmërimin e shfaqjes së armiqve kundër mbretërisë e të ngjashme. Në këtë mënyrë u zvogëlua sherri i tyre ndaj udhëtarëve dhe njerëzit filluan të bënin dua Kryevezirin për shkak të zhdukjes së atij zullumi... Lutfi Pasha vazhdoi në këtë post kryeministrit derisa lindi mes tij dhe gruas së tij ngatërresë, e cila ishte motra e Sulltanit Sulejmanit. Shkaku ishte dëshira dhe animi i tij nga robëreshat. Kështu që ajo iu ankua të vëllait për këtë gjë. Ai e thirri e rrahu dhe e urdhëroi ta ndante gruan. Ai u detyrua ta bënte këtë gjë në sajë të detyrimit dhe imponimit të vëllait të gruas. Merr leje për në haxh dhe u njohëm atje ku më kërkoi të shkruaja për të sipas dëshirës së tij ku edhe më shpërbleu për këtë gjë.”⁹

6. Asafnâme 23.

7. Asafnâme 32-35.

8. Lewis, “Ottoman observers of Ottoman decline”, f. 73.

9. En Nahravali el Mekki, *Alam bil alam bejtuallahil haram*, bot. i F. Wustenfeld, fl. 399.



Dëmtuesit e shoqërisë SË BASHKUAR

— Prof. dr. Ismail Lutfi Çakan —

Tema, “*Profeti, Teuhidi dhe Bashkimi*”, ka cilësinë të jetë një shkak për autokritika të sinqerta dhe horizonte të reja në lidhje me besimin dhe unitetin shoqëror të umetit islam. Duke u nisur nga kjo, është ndjerë nevoja e një vlerësimi në lidhje me dëmtuesit e shoqërisë së bashkuar ose të unitetit në shoqëri.

Ashtu si të gjithë profetët e tjerë, edhe synimi i Profetit tonë të dashur (a.s.), ka qenë edukimi i besimtarëve që do të zbatojnë fenë e Allahut në jetën individuale dhe shoqërore, pra sistemin e besimit të bazuar në Teuhid. Dhe, thelbi i kësaj përbëhet nga përvetësimi i virtyteve të takuasë (frikë-respektit ndaj Allahut) në aspektin individual dhe të bashkimit (unitetit) në aspektin shoqëror.

Ashtu siç e forcon dhe e bën superior njeriun virtyti i “takuasë”, ashtu edhe virtyti i “unitetit” e bën shoqërinë të fortë dhe me një strukturë shoqërore jo lehtësisht të lëkundshme. Që të dyja virtytet, si takua ashtu edhe uniteti, janë të kategorizuara në Teuhid, njëra në dimensionin e besimit dhe ndjenjave, ndërsa tjetra në aspektin e veprimit dhe aksionit.

Virtytet e takuasë dhe unitetit, janë dy forca

dinamike që në fakt i udhëzojnë myslimanët në rrugën e përsosmërisë dhe shpëtimit pa bërë asnjë ndasi ndërmjet tyre. Dhe natyrisht se sundimi i një force të tillë, sjell me vete edhe pjekurinë e individit, unitetin e umetit, qetësinë dhe shëndetin shoqëror të umetit. Ndërsa qëndrimet dhe formacionet jashtë kësaj, ndikojnë si viruse të dëmshme që e sulmojnë atë strukturë.

Vetëdija dhe virtytet e takuasë dhe unitetit, pikësëpari kanë në rend të ditës “ruajtjen e myslimanëve nga ngatërresat me njëri-tjetrin”. Për këtë arsye, në mënyrë të veçantë liderët dhe kuadrot e ngarkuar me detyrën e kumtimit të fesë, kanë përgjegjësi shumë serioze, si ruajtjen dhe kujdesien për myslimanët që kanë nën vete, zhvillimin e edukimit të tyre dhe mos shkaktimin në asnjë lloj mënyre të ndasive midis tyre.

Ashtu siç ka rëndësi teuhidi në strukturën e besimit Islam, ashtu ka rëndësi edhe uniteti në strukturën e shoqërisë Islame. Ashtu siç nuk kanë vlerë besimi dhe veprat pa teuhidin, në të njëjtën mënyrë është e pamundur që edhe virtytet, qetësia dhe siguria të gjejnë jetë në shoqërinë Islame pa unitetin. Kjo, sepse siç shprehet edhe Profeti (a.s.): “*Uniteti sjell mëshirë, ndërsa ndarja*

sjell dënim!" (Ahmed b. Hanbel, Musned, IV, 278, 375;)

Rëndësinë që të gjithë duhet ta tregojnë ndaj teuhidit në aspektin e uniteti Islam, duhet ta tregojnë edhe në aspektin e unitetit shoqëror. Përçarja dhe copëtimi i shoqërisë myslimane në grupe, nuk ka se si t'i shërbejë besimtarëve dhe për rrjedhojë, as Islamit. E thënë ndryshe, tradhtia nuk mund të konsiderohet si shërbim. Kumtuesit e fesë dhe grupet që i shërbejnë Islamit, mund të kenë arsyetime në shumë pika. Por padyshim se nuk mund të bëhet fjalë për arsyeime kur kryen një krim si përçarjen, copëtimin dhe sjelljen në kundërshtim me unitetin e shoqërisë myslimane me burim injorancën dhe konkurrencën

Një prej pikave më delikate të kumtimit të Islamit dhe të shërbimit ndaj fesë, është që në vend "të përpjekjes së izoluar në vetvete", të merret për bazë përpjekja dhe munda në realizimin e një shoqërie të bashkuar si domosdoshmëri e besimit monoteist, që do të përshtatet edhe me kuptimin e ajetit, *"ata janë të mëshirshëm ndaj njëri-tjetrit"*¹.

Shkaqet kryesore të dëmtuesve të unitetit shoqëror dhe të përpjekjeve dhe debateve të izoluar në vetvete, mund t'i radhisim në këtë mënyrë:

1. Shkaqe fetare: Dobësi besimi, mangësi në vepra, rivalitet ndërmjet feve ose fetarëve.
2. Shkaqe njerëzore: Racizmi dhe nacionalizmi.
3. Shkaqe morale: Varësia ndaj alkoolit dhe drogave, gënjeshtria dhe dyfytërsia.
4. Shkaqe politike: Militantizëm i tepruar.
5. Shkaqe ligjore: Padrejtësitë (mos mbajtja e anës së të drejtës dhe të drejtit).
6. Shkaqe ekonomike: Çekuilibrim i të ardhurave dhe sigurimit të jetesës. Pakujdesia në çështjet e hallallit dhe haramit.
7. Shkaqe të lidhura me dijen: Injoranca dhe pranimi i diplomës si kriter (i vetëm) diturie.
8. Shkaqe psikologjike: Besimet e kota dhe besëtytnitë, varësia nga të tjerët, imitimi dhe ndjenja e inferioritetit.

Në fakt, analizimi një për një i këtyre viruseve që luajnë rol të rëndësishëm në pamundësinë e arritjes së unitetit dhe bashkimit që dëshirohet në shoqëri, do të thotë të zbresësh në thellësi të çështjes. Mirëpo, tani për tani do të mjaftohemi vetëm me një analizë të përgjithshme.

Parimi që nuk duhet harruar është ky: Përjetimi i një feje, është i mundur në sajë të mbrojtjes së

parimeve të saj të besimit, adhurimit dhe veprave. Përndryshe, devijimi në fe dhe përçarja në shoqëri është e pashmangshme.

Mirëpo, ajeti fisnik ku urdhërohet se, *"Allahu nuk ka krijuar askënd me dy zemra!"*² e refuzon në mënyrë të qartë gjendjen e pakuptimtë të disa personave, të cilët ndryshe kanë fenë, e ndryshe botën e tyre. Ashtu siç nuk bëhen dot dy zemra në një krahavor, ashtu edhe në një zemër nuk mund të bëhen bashkë besimi dhe mohimi, teuhidi dhe shirku, pranimi dhe refuzimi...

Nëse do të shprehemi me fjalët e Shah Velijullah ed-Dihlevit (1176/1762), mund të themi se, e përbashkëta e përpjekjeve të profetëve, është se ato janë të përqendruara në "edukimin e individit dhe drejtimin e shoqërisë/umetit"³.

Mendoj se ky evidentim i Shah Velijullahut, ka cilësinë e shpjegimit të përbërjes së shoqërisë virtuale dhe madje edhe të konceptit të qytetërimit. Kjo, sepse edukimi i individit, nënkupton edukimin e egos personale, ndërsa drejtimi i shoqërisë, nënkupton zhvillimin dhe unitetin.

Edukimi i Profetit tonë (a.s.), shpreh vlerat e vërteta të edukimit islam. Dhe, qytetërimi Islam, është një qytetërim origjinal, i zhvilluar dhe i formësuar me vlera të posaçme për të. Parimi për të mos i ngjarë shoqërive të tjera, është disiplina e mos imitimit të të tjerëve. Me anë të kësaj disipline arrihet përjetimi dhe mbrojtja e cilësive origjinale.

Në sajë të propagandave perëndimorizuese në të shkuarën dhe të parullave të sotme në lidhje me "ngritjen e vlerave perëndimore", janë bërë dhe po bëhen vazhdimisht përpjekje që të mbi-zotërojnë një botëkuptim dhe një orientim, rrënjët, formimi dhe synimi i së cilës nuk përputhet që në themel me qytetërimin dhe vlerat tona. Për rrjedhojë, është e pamundur të aprovohet dhe të tolerohet prirja për hapjen pa doganë të të gjitha deryve të strukturës sonë shoqërore ndaj një propagande të tillë që është e huaj për ne. Përndryshe, kuptimi i gjithë kësaj do të ishte se ne ia përgatisim vetë truallin prodhimit dhe shumëzimit të dëmtuesve/viruseve të shoqërisë së bashkuar.

Ajo që duhet të bëjmë, nuk është shtimi i ndasi-ve në trupin e umetit, duke u bërë elementë përçarjeje, por kërkimi dhe realizimi i unitetit, në mënyrë që besimin e teuhidit ta bëjmë të dukshëm dhe të jetueshëm si një shoqëri e bashkuar.

1. shih. Surja el-Fet'h, 29.

2. shih. Surja el-Ahzab, 4.

3. Hüccetullahi'l-bâliğa, I, 253 (Tercüme, I, 322-323, İstanbul, 1994)

PYETJET NË SUREN MULK

— Xhafer Durmush —

Surja Mulk është deklarata që tregon se gjithësia është në dorën e Allahut të Madhëruar. Ajo na njofton për urtësinë e jetës dhe të vdekjes. Na njofton për faktin se pas vdekjes njerëzit do të ringjallen dhe se ata që kanë besuar do të shpërblehen me mirësi, ndërsa mohuesit e Allahut dhe gjynahqarët do të dënohen. Profeti ynë (a.s.), na nxiti ta lexojmë këtë sure, duke thënë: *“Kush e lexon suren Mulk, do të ndërmjetësoj për të (në Ditën e Gjykimit).”* (Ebu Daud, Ramazan, 10.) Po ashtu, ai na jep myzhdënë se *“leximi i kësaj sureje do të jetë mburojë ndaj dënimt të varrit.”* (shih. Tirmidhi, Fedailu’l-Kuran 9.)

Në suren Mulk, gjenden shumë pyetje që i drejtohen njeriut. Allahu kërkon që në këtë mënyrë, njerëzit të mendojnë për të vërtetat, të cilave askush nuk mund t’u thotë “Jo”. Pyetja e parë, është kjo: *“E si të mos dijë Ai që ka krijuar gjithçka!?”* (Mulk, 14)

“Sido që të flisni ju, fshehtas apo haptas, Ai e di mirë ç’ka në zemrat tuaja. E si të mos dijë Ai që ka krijuar gjithçka, kur Ai njeh çdo gjë me imtësi dhe është i Gjithëinformuari!?” (Mulk, 13-14)

Përgjigja që mund t’i jepet kësaj pyetje, është: *“Sigurisht që e di!”*

Sipas një transmetimi të Ibn Abbasit (r.a.), Profeti tonë (a.s.), i bëheshin të ditura me anë të shpalljes edhe disa prej thashethemeve të idhujtarëve në lidhje me vetë atë (a.s.). Për këtë arsye, ata thoshin: *“Fshihini fjalët tuja që të mos i dëgjojë Zoti i Muhammedit!”* Për rrjedhojë, në lidhje me këto fjalë, u zbrit ajeti i mësipërm dhe në këtë mënyrë iu bë e ditur të gjithë njerëzve se asgjë nuk mund të

mbetet e fshehur nga dija e Allahut të Madhëruar.

Këtu duhet të përmendim ata që bëjnë gjynahe në këtë botë, ose nuk besojnë se Allahu i sheh, ose i harrojnë detyrat e veta ndaj Allahut, duke rënë në indiferencë për shkak të lakmisë dhe dashurisë ndaj kësaj bote. Nëse një besimtar e mban të gjallë vetëdijen se asgjë nuk i mbetet e fshehtë Allahut, a mundet që ai të jetë indiferent qoftë edhe për një çast? Ai jo vetëm që nuk mund zhytet në gjynahe, por edhe kohën nuk mund ta shpërdorojë me gjëra të padobishme.

Disa pyetje të tjera pas kësaj, janë: *“A jeni të sigurt se kush është në qiell, nuk do ta bëjë Tokën t’ju kapërdijë, kur të fillojë të dridhet papritmas? A jeni të sigurt se kush është në qiell, nuk do t’ju çojë furtunë gurësh?..”* (Mulk, 16-17)


“Kush është ai, që mund t’ju ndihmojë si një ushtri e tërë, përveç të Gjithëmëshirshmit? Mohuesit janë pre e mashtrimt (të shejtanit). Kush janë ata, që do t’ju japin mjete jetese, në qoftë se Ai jua ndalon ato?..” (Mulk, 20-21)

“...Nëse ujërat tuaja ju shteren, kush (përveç Allahut) do t’ju sjellë ujë rrjedhës?!” (Mulk, 30)

“A është më mirë ai që shkon rrëshqanas e kokulur apo ai që ecën ballëlart në rrugën e drejtë?” (Mulk, 22)

Dy pyetjet e para në këto ajete, na kujtojnë pakufishmërinë e fuqisë hyjnore.

Në fakt, njeriu duhet të ruhet nga zemërimi i Allahut, i Cili ka fuqi të pakufishme. Kjo, sepse nuk ekziston asgjë që mund ta shpëtojë atë nga



dënimi i Tij. Besimtarët dinë dhe besojnë se, katastrofat që vijnë prej tokës dhe qiellit, nuk janë të lidhura vetëm me shkaqe fizike dhe se menaxhimi i gjithçkaje i takon Allahut. Nisur nga kjo, ekzistenca e mundësive që theksohen në ajete, nuk i frikëson dhe nuk i shqetëson ata. Përkundrazi, ato ia shtojnë atyre dorëzimin dhe besnikërinë ndaj Allahut.

Po ashtu edhe tre pyetjet në vijim, na kujtojnë madhështinë e Allahut dhe se përveç Tij, asnjë ushtri nuk mund t'i ndihmojë ata. Në të njëjtën kohë, bëhen edhe këto pyetje: *“Nëse furnizimi juaj me ushqim dhe me ujë ndërpritet, kush mund t’ju japë këto? A është e mundur?”* Sigurisht që jo! Pra, njeriu duhet t'i dijë limitet e veta. Ai nuk duhet të mashtrohet me forcën e tij të limituar, me të cilën mund të bëjë disa gjëra dhe nuk duhet të harrojë se ndodhet në dorën e Allahut të Plotfuqishëm. Ai duhet ta kuptojë dobësinë e vet dhe duhet të falënderojë vazhdimisht. Po ashtu, ai duhet t'ia kujtojë vetes pyetjet që bëhen në këto ajete, duke i lexuar ato në kohë të caktuara për të mbajtur gjallë vetëdijen.

Ndërsa përgjigja e pyetjes, ***“A është më mirë ai që shkon rrëshqanas e kokulur apo ai që ecën ballëllart në rrugën e drejtë?”***, që na është dhënë edhe si një krahasim, padyshim se duhet të jetë, “e dyta”. Kjo, sepse i pari nuk mund të ecë drejtë për shkak të rrugës së shtrembër dhe për shkak të mënyrës së ecjes. Ai është udhëtari i rrugës së devijuar. Kurse i dyti, është njeriu i arsyeshëm që ecën në rrugë të drejtë. Ai është udhë-

tari i rrugës së drejtë, i cili e rregullon jetën e vet duke marrë parasysh fuqinë e Allahut të Madhëruar. Dallimi midis këtyre të dyve, është aq i qartë saqë nuk ka nevojë as për krahasim. E megjithatë, Zoti ynë dëshiron që një krahasim i tillë të jetë gjithmonë në vetëdijen tonë. Pra, të dimë vlerën e njërës me qëllim që të mos biem në devijimin e tjetrës.

Në fakt të gjithë njerëzit -jo vetëm besimtarët-, e dinë dhe e ndjejnë se çështjet që trajtohen në ato pyetje janë pikërisht ashtu... Megjithatë, ata harrojnë shpesh, sepse ashtu ju vjen më lehtë. Ata që e lexojnë suren Mulk me pasionin e adhurimit, konsiderohen si zbatues të sunetit të Profetit (a.s.), aq sa arrijnë ta bartin në jetë vetëdijen që kërkojnë të ngjallet me këto pyetje. Pikërisht atëherë do të marrë kuptim edhe myzhdeja se kjo sure do ta mbrojë lexuesin e saj nga dënimi i varrit.

Lexo-Mendo!

VLERA E KËSAJ BOTE

“Ta dini, se jeta në këtë botë, nuk është tjetër veçse lojë, dëfrim e zbukurim, si dhe mburrje ndërmjet jush e rivalitet për më shumë pasuri dhe fëmijë! Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut rritet dhe i gëzon bujqit, por më vonë zverdhet, thahet dhe mbetet pa vlerë. Në botën tjetër ju presin vuajtje të mëdha ose falja e Allahut dhe kënaqësia e Tij; jeta në këtë botë është vetëm kënaqësi e rreme.” (Hadid, 20)

Në këtë ajet ku bëhet krahasimi i jetës së kësaj bote me jetën e botës tjetër, tërhiqet vëmendja në mënyrë të veçantë në aspektet mashtruese të kësaj bote, ndërkohë që në ajete të tjera na bëhet e ditur se kjo botë dhe gjithçka në të nuk janë krijuar kot. Kjo, sepse vetë jeta e kësaj bote nuk është e pavlerë. Ato që dënohen, janë të këqijat, gjynahet, mospërdorimi i mundësive sipas urdhrave të Allahut të Madhëruar, neglizhimi i botës tjetër duke u zhytur vetëm në dëshirat e kësaj bote dhe duke u kapluar prej të këqijave të saj.

Ndërkohë që kërkojmë përgjigje për pyetjet: “Si e shohim ne këtë botë dhe gjithçka ka në të kur i lexojmë këto ajete dhe ajete të ngjashme?” dhe “A kemi arritur të vendosim ekuilibrin midis kësaj bote dhe botës tjetër në jetën tonë?”, na del përpara një transmetim i shënuar në Ihyau Ulumu’ d-Din. Kur Imam Gazaliu shpjegon “përçmimin e kësaj bote”, na vë përpara kriterin e pagabueshëm të peshores profetike:

I Dërguari i Allahut (a.s.), dëgjoi një person që bënte këtë dua: “O Allah! Ma trego botën ashtu siç e sheh edhe Ti!” Për këtë arsye, ai e qortoi dhe i tha të lutej kështu: “O Allah! Ma trego botën ashtu siç ia tregon njerëzve të mirë!”

Pyetja e sotme duhet të jetë kjo: ***“Sa i ngjajnë punët tona të kësaj bote, punëve të njerëzve të mirë dhe sa përputhen shikimet dhe dëgjimet tona me ato të tyre?”***

ISLAMI DHE SHKENCA

— Xhihan Tashtan —

Teksa “The Economist” shkruan për revolucionin shkencor të shkencës në botën islame, nuk e kup-ton se pika kyçe nuk është shkenca, por bota jonë e brendshme. Përndryshe, nuk do të na gjykonin për faktin se disa prej vendeve tona të adhurimeve janë më të mëdha se vendet e punës.

Me siguri e keni dëgjuar fjalën “Sa vend i bukur! Si xhenet!”... Mbase vjet ka qenë hera e parë që e kemi përdorur këtë fjalë me sineritet të plotë. Dhjetëra njerëz të shkencës ishin mbledhur në njërin prej universiteteve më të mirë të botës, në Harward. Ishim të emocionuar sepse e kuptonim shumë mirë se çfarë kuptimi kishte një mundësi e tillë për njerëzit e botës akademike. Ashtu si fëmijëve u tregohen përralla me vende të bukura, ashtu edhe neve na tregohej për zbulimet e bëra në Harward. Por fjalën “xhenet” nuk e përdorëm si pasojë e një emocionit të tillë...

Shkencëtarët dilnin në skenë njëri pas tjetrit dhe flisnin për zbulimet shkencore që kishin publikuar në revistat më prestigjioze të botës. Unë ngela me gojë hapur, nuk më zinte vendi nga emocionit... Mbase fjala “Elhamdulillah” nuk dilte vetëm nga gojë të tona; mbase sipër kokave kishim engjëj që bënin adhurim. Koha e namazit përkoj me një pushim të seminarit. Ne nuk fshiheshim nga asnjë mësues, sepse nuk kishim turp. Nuk merrnim abdest me shpejtësi nga frika se mos na shikonin dhe nuk kishim shqetësimin e të mos gjeturit një vend për t’u falur. Dhjetëra burra e gra, krijuan një xhemat në vendin të cilin na e kishin përgatitur më përpara. Ishim në Harward dhe po falnim namaz së bashku me shkencëtarët më të njohur të botës.

Pikërisht në atë moment e përdora shprehjen: “Si në xhenet!”. Shkencëtarët myslimanë nuk e fshihnin krenarinë e fesë së tyre, as nuk ndjenin inferioritet nga mbulesa... Teksa ishim akoma nën ndikimin e këtyre kujtimeve, na tërhoqi vëmendjen një shkrim i “The Economist”... Shkrimi fliste për rëndësinë që ka filluar të ketë shkenca në Botën Islame. Fjalja e parë na tërhoqi vëmendjen. Në vitin 2005 numri i artikujve shkencorë të botuar në Harward ishte

më i madh se numri i botimeve të universiteteve të 17-të vendeve arabe. Në fakt ekzistonte diçka që “The Economist” nuk e kishte marrë në konsideratë: numri i shkencëtarëve myslimanë që jetonin në perëndim. Tashmë nuk tregoheshin më si pakica “Myslimanët e Harwardit”, por si një xhemat i madh. Artikulli vazhdonte me një fjalë tjetër pikëlluese. Bota e madhe islame me 1,6 miliardë njerëz ka nxjerrë vetëm 2 Nobelistë ndërsa bota çifute me 16 milionë njerëz ka plot 79 fitues të Nobelit. Edhe dy myslimanët që kanë fituar Nobel emigruan për në perëndim. Sigurisht që këtë diferencë kaq të madhe mund ta lidhim me disa shkaqe, por gazeta vetë e jepte përgjigjen në vendin tonë. Në kohën kur shkenca islame ishte në lulëzimin e saj, pushteti ishte në duart e njerëzve të lidhur pas fesë ndërsa tani një pjesë e madhe e këtyre shteteve janë nën regjime diktatoriale...

Zhvillimet e dhjetë viteve të fundit në vendet islame duhet ta kenë emocionuar “The Economist”, sepse kur tregon që artikujt shkencorë të publikuar në Turqi dhe Iran janë rritur 4-5 herë, si dhe kur thotë që Turqia e financon shkencën më shumë se Zvicra, nuk e fsheh krejtësisht një ndjenjë habie. Tashmë Turqia ka arritur atë zhvillim sa të nisë në hapësirë raketa kozmike. Shumica e njerëzve (!) shikonin qiellin me krenari dhe duartrokisnin. Tashmë shkencëtarët tanë mund të shkrepin fotografi të yjeve. Tashmë motrat tona mund të shkojnë me shami në shkollë...

Teksa “The Economist” shkruan për revolucionin shkencor të shkencës në botën islame, nuk e kup-ton se pika kyçe nuk është shkenca, por bota jonë e brendshme. Përndryshe, nuk do të na gjykonin për faktin se disa prej vendeve tona të adhurimeve janë më të mëdha se vendet e punës. Ata nuk mund ta kuptojnë dhimbjen e një myslimani që nuk ka vend faljeje në shkollën ose punën e vet teksa bëjnë studime me mikroskop e teleskop për të njohur Krijuesin edhe më mirë...

(Burim: The Economist. Islami dhe Shkenca, Rru-ga drejt përtëritjes, Janar 2013)

PYETJET MË TË MËDHA TË GJITHËSISË

Muaz Erdem

Krijimi i Gjithësisë nga një grimcë krejt e vogël është një proces i gjatë dhe i komplikuar për t'u kuptuar e për t'u shpjeguar. Ndërsa nëse pyetemi për kohën kur ka ndodhur ky krijim mund të themi: afërsisht 13,7 miliardë vite.

Sa vjeçe është gjithësia?

Gjithësia... Simboli më i madh i pafundësisë. Po kur u krijua kjo Gjithësi e pafundme në të cilën ne jetojmë? Krijimi i Gjithësisë nga një grimcë krejt e vogël është një proces i gjatë dhe i komplikuar për t'u kuptuar e për t'u shpjeguar. Ndërsa nëse pyetemi për kohën kur ka ndodhur ky krijim mund të themi: afërsisht 13,7 miliardë vite.

Si u formua gjithësia?

Ekzistojnë hipoteza të ndryshme në lidhje me këtë çështje dhe për rrjedhojë janë krijuar modele të ndryshme krijimi. Ndër këto më i pranueshmi është teoria e Big Bangut (Shpërthimi i Madh). Njeriu i parë që e hodhi këtë teori është shkencëtari rus me emrin Alexander Friedmann.

Teoria e Big Bang-ut shkon më tej se një shpërthim i madh, duke treguar shpejtësinë me të cilën ka ndodhur zgjerimi. Kur nuk ekzistonte materia, ishte një pikë e vetme. (shiko: singularitetin). Kjo pikë kishte energji të fuqishme brenda vetes dhe si pasojë e disa reaksioneve subatomike filloi të zgjerohet. Ky proces u zhvillua në fraksionin e një të triliontën e sekondit dhe filloi të zgjerohej me një shpejtësi të habitshme. Në sekondat e para u formuan kuarket pas kësaj dolën në pah protonet dhe neutronet. Menjëherë pas kësaj u formuan anti-protonet dhe anti-elektronet në mënyrë që të bëhej asnjësimi. Më në fund gjithësia u mbush me dritë. Por Gjithësia është kaq e madhe sa rruga e dritës zgjati plot 380.000 vite. Më pas filluan të formoheshin yjet, galaktikat, planetët dhe trupat e tjerë qiellorë.

A zgjerohet gjithësia?

Deri në shekullin e 20-të njerëzit mendonin se Gjithësia përbëhej vetëm nga Galaktika Rruga e Qumështit. Por kjo hipotezë u hodh poshtë në vitin 1923 nga Edwin Powell i cili zbuloi Galaktikën e Andromedës. Ai vuri re një gjë të çuditshme tek Galaktikat e tjera, bëhej fjalë për një lëvizje me ngjyrë pak të kuqe. Në astronomi, për të pasur

një lëvizje të tillë duhet që objekti të jetë duke u larguar prej nesh. Kjo nënkupton zgjerimin e Gjithësisë dhe i pari që e zbuloi një gjë të tillë është Hubble.

Tashmë është pranuar fakti se universi ynë po zgjerohet madje janë bërë përpjekje për të matur shpejtësinë e këtij procesi. Sipas llogaritjeve të bëra, një galaktikë që është 1 milion vite dritë larg nesh, na largohet me një shpejtësi prej 22 km në sekond.

“Ne e kemi ndërtuar qiellin me fuqinë Tonë dhe Ne e zgjerojmë atë.” (Dhariaj, 47)

Si do të vij fundi i gjithësisë?

Ashtu si ekzistojnë shumë hipoteza mbi krijimin e Universit, ashtu ekzistojnë edhe shumë të tjera në lidhje me fundin e tij. Më e pranueshja prej shkencëtarëve është teoria Big Crunch (Kollapsi i madh) edhe kjo teori ka lindur nga babai i teorisë së Big Bangut, nga Alexander Friedmann. Pra njerëzit që kanë lodhur kokën për të kuptuar krijimin e universit, nuk janë mjaftuar me aq por kanë menduar edhe për fundin e tij.

Sipas teorisë së Kollapsit të Madh, me kalimin e kohës zgjerimi do të ngadalësohet si pasojë e forcave gravitacionale dhe do vijë një moment kur do të ndalet. Zoti ynë na e ka treguar në Kur'an këtë moment dhe kjo na bën që të zhytemi në meditime.

“Atë Ditë, Ne do të palosim qiellin, ashtu siç paloset letra e librit. Ashtu siç e filluam krijimin e parë, do ta përsërisim atë. Ky është premtimi Ynë. Ne do ta bëjmë këtë me të vërtetë.” (Enbija, 104)



“Pasha kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje, përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.” (Asr, 1-3)

Ne lindim në një fenomen të quajtur kohë, por jemi të paaftë edhe për ta përkufizuar atë. Secila prej përkufizimeve të bëra e kap këtë çështje nga një aspekt i saj. Koha është një enigmë që e jetojmë, e ndiejmë, por që nuk mund të themi dot se “është pikërisht kjo”. Ka edhe prej atyre që thonë se është një perceptim jo edhe aq i vërtetë në lidhje me lëvizjet që ndodhin në gjithësi. Gjithashtu, ka edhe prej atyre që thonë se është diçka e krijuar dhe e vërtetë. Cilado që të jetë e vërteta, i sigurt është fakti se njeriu ka një lidhje të detyrueshme me kohën. Si rezultat, edhe përgjegjësinë për ta sistemuar këtë lidhje e ka mbi supet e tij. Jeta e njeriut fiton kuptim në raport me suksesin e këtij të fundit në këtë çështje.

Kurani Fisnik, përveç theksimit që i bën kohës në mënyrë të përgjithshme duke e quajtur (asr), u jep një pozitë qendrore edhe proceseve që e kanë fillimin dhe fundin të caktuar, të cilave ne u themi “vakt”, me anë të emrave të përgjithshëm si vit, muaj, ditë dhe orë që përjetohe brenda saj. Koha, në përgjithësi tregon madhështinë hyjnore në gjithësi, fenomeni vakt që zë vend brenda në kohë luan rol themelor në sistemin që planifikohet t’i japë formë jetës së njeriut. Procesi që ne e quajmë jetë, përjetohe brenda kufijve të konceptit vakt i cili është produkt i kohës. Nga një aspekt, vakti është lënda e papërpunuar që fuqia hyjnore na e ka dhënë amanet për ta shndërruar në “produkt”.


Ndërsa theksi bazë i mesazhit është realizuar me fjalinë: **“Me të vërtetë, njeriu është në humbje.”**, që formon përmbajtjen e ajetit të dytë të sures Asr. Kjo dispozitë është aq shumë e rëndësishme për njeriun dhe e shpreh aq qartë të vërtetën saqë, nëse nuk merret seriozisht dhe nuk veprohet sipas urdhrat të saj, njeriu do të hyjë në një rrugë që nuk ka kthim prapa dhe do të bjerë në një humbje absolute.

Ndërkohë që kjo sure fillon me betim duke synuar që të na tërheqë vëmendjen, edhe fakti se ky betim bëhet mbi asrin/kohën, na tregon se humbja për të cilën njoftohemi ka të bëjë me kohën. Nisur nga shprehja e përgjithshme në fjalinë: **“Me të vërtetë, njeriu është në humbje.”**, kuptojmë se të gjithë do ta përjetojnë këtë fenomen të humbjes absolute, se kjo dispozitë i përfshin të gjitha kohët dhe se ky

është një rregull i pandryshueshëm përveçse për ata që përjashtohen në ajetin e tretë. Ndërsa nga ajo që na tregon ajeti i tretë në kuptimin: **“Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.”** (Ata nuk janë në humbje.), kuptohet se kjo humbje absolute do të ndodhë duke qëndruar larg besimit të tevhidit dhe duke mos bërë vepra të mira. Në të njëjtën kohë, ajeti fisnik na njofton se vlerësimi i segmentit kohor, i cili është lënë në amanetin tonë me emrin jetë, nëse e përjetojmë në një formë të përshtatshme me vullnetin hyjnor, është rruga e vetme e shpëtimit nga rënia në këtë humbje. Ndërsa veprat e mira, duke filluar që nga veprat e ibadeteve që na mundësojnë të jemi të përshtatshëm për adhurim, formojnë një rreth të gjerë që përfshin aktivitetet, qëndrimet dhe sjelljet konstruktive e produktive të cilat do të na bëjnë harmonikë me jetën, mjedisin dhe shoqërinë. Aftësia për ta administruar kohën është kushti themelor i arritjes së suksesit në rrugën e veprave të mira.

Koha e fiton të vërtetën e saj reale në lidhje me lëvizjet e krijesave në gjithësi. Ndërsa e vërteta e kohës nga aspekti i jetës së njeriut ka një bazë më praktike. Njeriu e sistemon jetën e tij dhe ngjarjet duke i dhënë një formë me ato që bën procesit të kohës në të cilën jeton. Ai do të thotë se e sundon kohën në vartësi me të qenët aktiv dhe influencues në këtë çështje. Këtu qëndron edhe ndryshimi ndërmjet të qenët objekt apo subjekt i kohës. Ngjyra, shija dhe aroma e jetës reflekton qëndrimin tuaj ndaj kësaj bote. Nëse arrini të gjeni një mjedis ku mund të merrni frymë rehat duke i mbrojtur vlerat tuaja, do të thotë që e keni kapur kohën nga thelbi i saj.

Rënia e njeriut në humbje del në pah kur njeriu vazhdon të administrohet nga koha në vend që ai ta administrojë kohën. Një njeri që administrohet nga koha është i privuar nga të kuptuarit e një jete të planifikuar dhe për këtë arsye, bën një jetë jashtë kohës. Ai nuk mund të prodhojë dot. Si rezultat, shndërrohet në kapital të mosprodhimit. Ndërkohë që minutat dhe sekondat konsumohen me shpejtësi në këtë proces, konsumohet edhe vetë njeriu. Për këtë arsye, i konsumohet edhe koha para se t’i



mbarojë afati i jetës. Si rezultat, njeriu kthehet në një të vdekur të gjallë.

Mesazhi themelor në suren Asr jepet nëpërmjet atyre njerëzve që nuk bien në humbje për sa i përket çështjes së marrëdhënieve me kohën. Cilësia themelore e këtyre njerëzve është vlerësimi i proceseve të jetës duke bërë vepra të mira, duke e këshilluar njëri-tjetrin për të drejtën dhe duke i sugjeruar njëri-tjetrit durimin krahas kushtit për të qenë besimtarë. Ndërsa të jetuarit e gjithë jetës pa pasur dijeni për parimet që e bëjnë njeriun rob ndaj Allahut Teala, do të thotë që ta çosh dëm krejt jetën. Në çdo vend ku prishet ekuilibri dynja-ahiret, patjetër që fenomeni humbje është i pranishëm në një lloj dimension. Kjo situatë përjetohet kur përpjekja “për ta futur këtë botë në sistem” e bën njeriun t’i harrojë përgatitjet për botën tjetër. Thirrja që Kurani Fisnik i bën njeriut dhe në veçanti besimtarit është që ai të mos bjerë në një kurth të tillë. (Shik. Nur, 36-37.) Lumturinë përfundimtare do ta përjetojnë ata që e kalojnë me bindje ndaj Zotit (xh.sh.), udhëtimin e jetës duke i marrë parasysh parimet hyjnore dhe duke mos rënë në këtë kurth. Në Kuranin Fisnik dhe Sunetin e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, janë dhënë të gjitha detajet se si duhet të përparojmë në këtë udhëtim për të cilin po flasim. Krahas sures Asr, edhe i Dërguari i Allahut, alejhi’s-salam, e ka shpjeguar me shprehje mjaft të qarta e të kuptueshme dobësinë e përgjithshme që përjeton njeriu në çështjen e çuarjes dëm të kohës. Ai (s.a.s.), na ka treguar se shumica e njerëzve janë të mashtruar për sa i përket çështjes së kohës. (Shik. Tirmidhi, Zuhd, 1.)

Jeta që bën një mysliman i mirë shpreh një proces të pashkëputshëm që të shpie te i Gjithëmëshirshmi. Ndërsa ata që do të humbin, përballë do të gjejnë “ato që kanë bërë me duart e tyre”. (Shik. Inshikak, 6.) Në shoqërinë islame ku përjetohet kjo ndjeshmëri, koha është perceptuar si një vlerë që nuk mund të blihet apo shitet, që nuk mund të kursehet dhe që nuk mund t’i jepet dikujt. Pra, koha është perceptuar si vetë jeta. Koha si kapitali i jetës është konsideruar më e rëndësishme se “dirhemët dhe dinarët”. Ndërmjet tipit të njeriut perëndimor që nxiton e shqetësohet për çdo gjë dhe njeriut të Islamit që i mbështetet Zotit (xh.sh.), ka dy ndryshime: Ndërkohë që i pari është kurbani i kohës, i dyti e merr kohën nën administrimin e tij. Ndërkohë që

i pari ka hyrë në një mjedis jetese i shqetësuar me telashin për t’u bërë ballë të gjitha problemeve duke e harruar kohën, i dyti ka shpikur orën si simbol të kursimit të kohës. (Rasim Ezenëren, Nga cila anë duhet ta thyejmë vezën? Botimet Iz, botimi i 4-t, Stamboll 1999, fq. 189.) Megjithëkëtë, kjo tablo për të cilën folëm, në lidhje me myslimanin e ditëve të sotme nuk reflekton gjë tjetër përveçse një gjendje që është burim për mallimi (myslimani i ditëve të sotme nuk e posedon këtë tablo). Myslimani i ditëve të sotme nuk është i aftë për ta mbartur shpirtin e atyre kohëve shembullore që kanë ngelur në të kaluarën. Myslimani i ditëve të sotme po e përjeton në një formë të rëndë dobësinë e administrimit të kohës. Të administrosh kohën dhe të bëhesh subjekt i vullnetit, planit dhe aktiviteteve që do t’u japin drejtim ngjarjeve në vend se të kaplohesh nga rryma e ngjarjeve që ndodhin në kohë, duhet ta nxjerrësh në pah shpirtin e saj me anë të moralit, kulturës, artit dhe ekonomisë. Erozioni i humbjes dhe dëmit që myslimanët po e përjetojnë në këta tre shekujt e fundit, është shenjë e qartë e paaftësisë dhe dobësisë së tyre që kanë ndikuar deri në palcë.

Shembulli më i qartë i dorëzimit ndaj kohës është të pranuarit e saj për zot. Për shkak të kësaj, veten do ta ndjeni të dëshpëruar në dorën e kohës të cilën e shikoni si subjektin e çdo gjëje, çdo gjë do t’ia lini kohës dhe kjo do t’ju pëlqejë. Në të vërtetë, kjo është një arratisje. Pra, është një arratisje e njeriut nga vullneti dhe prestigji i tij. Fakti që arabët e injorancës ia hidhnin kohës fajin për ngjarjet negative që u ndodhnin, mbart damkën e kësaj arratisjeje. (Shik. Muslim, Kitabu’l-elfaz mineddehri ve gajriha, 1.) Ndërsa sahabët e të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), sikundër kësaj, përpiqeshin për ta vlerësuar kohën me vetëdijen që u jepte surja Asr. Ndërsa kur ndahehin nga njëri-tjetri, këndonin sures Asr më qëllim për t’ia kujtuar njëri-tjetrit këto parime. (Taberani, Evsat, Nr: 5124.)

Edhe ne duhet ta sundojmë rrjedhën e jetës duke prodhuar vlera nën prijësinë e Kuranit Fisnik e të Sunetit të të Dërguarit të Allahut dhe nën udhëheqjen e shëmbëlltyrës së sahabëve të nderuar. Ajo që synojmë me vlerën, në kuptimin më të gjerë të saj, është çdo lloj pune e dobishme, materiale apo shpirtërore qoftë ajo, që do ta mbrojë njeriun për të mos rënë në regres dhe kthim prapa.



Ebu Hurejra (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Kush i beson Allahut dhe Ditës së Gjykimit,
të flasë mirë, ose të heshtë!” (Buhari, Rikak, 23; Muslim, Iman, 74.)

Fjalët kanë shpirt. Fjalët jetojnë ndërmjet nesh. Disa japin jetë, ndërsa disa të tjera marrin...

Njeriu u fryn fjalëve prej shpirtit të tij. Për këtë arsye, fjalët janë sublimë aq sa shpirti që i përkasin. Disa janë sublimë dhe disa janë të ulëta. Për këtë arsye, fjalët e Allahut Teala janë të pashoqe dhe fjalët e Pejgamberit (a.s.), janë kaq kuptimplota. Fjalët janë zëri i shpirtit. Për këtë arsye, fjalët sublimë dëgjohen vetëm prej shpirttrave të lartë.

Si mund të lartësohet fjala? Si mund të zbukurohet zëri i shpirtit? Duke bërë titur? Jo! Duke folur vazhdimisht? Jo! Mos vallë zbukurohet zëri i shpirtit duke i shtuar fjalës gënjeshtëri, apo duke folur vazhdimisht për të tjerët, apo duke ua treguar të gjithëve ato që dëgjon?

Ah sikur të heshtësh! Në këtë mënyrë do të dëgjosh. Vërua veshin fjalëve të larta! Shiko çfarë thotë pejgamberi!

Cili?

Pejgamberi i fundit të cilit i është dhënë esenca e fjalës dhe i cili ishte xhevami’ul-kelim (Muslim, Mesaxhit, 5.): “Kushdo që i beson Allahut dhe Ditës së Gjykimit, ose të flasë mirë, ose të heshtë!” (Buhari, Rikak, 23; Muslim, Iman, 74.)


Profeti (a.s.), thotë se edhe të folurit e ka një ritëm. Ai flet për ekuilibrin ndërmjet fjalës dhe heshtjes. Kur ky ekuilibër të formohet siç duhet, notat në fjalë dalin të plota dhe gjejnë ritmin e tyre melodik. Atëherë, bisedat tona nuk përbëhen nga zhurma të thata që shkaktohen prej fjalëve të shumta. Atëherë, në qiell ngelet një zë i këndshëm. Atëherë, sublimiteti i shpirtit tonë reflekton në fjalën tonë. Fjalët tona thellohen aq sa thellësia e shpirtit tonë. Ato janë të plota aq sa është i plotë edhe ai. Gjithashtu janë edhe delikate aq sa është delikat edhe ai.

Kjo ka të bëjë aq shumë, sa që kur flet i Dërguari i Allahut (a.s.), të cilit i është dhënë esenca e fjalës dhe i cili mund t’i transmetojë me hijeshi edhe gjendjet më esenciale të fjalës, gjithësia hesht. Kur sahabët e nderuar e dëgjonin atë (a.s.), magjepse-

shin. Kur fliste ai (a.s.), mbusheshin zbrazëtirat. Kur fliste ai (a.s.), vargjet e poetëve dukeshin pavlerë...

Kur fliste i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, të gjithë përfitonin nga fisnikëria e tij sipas kapacitetit të tyre. Të gjithë merrnin nga ndonjë gjë sipas kapacitetit të tyre. Me çdo fjalë të tij, ndriçohej një anë e errësirës. Fjalët e tij, në çdo periudhë, linin një aromë të këndshme të dëgjuesit. Ata që e dëgjonin i magjepste me modestinë e tij. Krahës urtësisë, ai ndikonte të dëgjuesit edhe me hijeshinë që kishte. Në fjalët e atij (a.s.), ndjehej madhështia e modestisë. Nganjëherë thoshte fjalët më ndikuese duke heshtur. Vetëm një heshtje e tij jepte mesazhe të shumta që nuk i nxinin dot fjalët. Siç ishte i dobishëm të folurit e tij, ashtu ishte e dobishme edhe heshtja. Siç nuk ishin boshe fjalët e tij, edhe heshtja e tij shprehte shumë. Sa shumë gjëra patën mësuar sahabët e nderuar nga heshtja e tij! Sa shumë gjëra që i tha dhe ia mësoi Kaab b. Malikut (r.a.), duke heshtur! Ekuilibri madhështor i fjalës dhe heshtjes ishte bashkuar në personalitetin e tij. I Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, na pati mësuar se jo vetëm fjala, porse edhe heshtja ka një vlerë. Gjithashtu na pati mësuar se edhe fjala, edhe heshtja duhet të përdoren në vendet e tyre.

Nisur nga këto që thamë më lart, çdo heshtje e vlefshme në të vërtetë është një këshillë profetike. Nëse nga goja jonë do të dalë ligësi, nëse fjalët tona do ta lëndojnë, plagosin dhe përçmojnë bashkëbiseduesin, atëherë heshtja është më e mirë. Nëse nga buzët tona nuk do të dalin fjalë në lidhje me mirësinë, nëse pas një kohe zemra jonë do të bëhet shumë e ngurtë vetëm për shkak të këtyre, atëherë heshtja është më e mirë. Nëse fjalët tona do të lënë një shije të hidhur në gojë, nëse çdo fjalë e jona do të bëhet një shkallë për të na afruar një hap më shumë drejt Xhehenemit dhe nëse thonjtë tanë do të shndërrohen në kthetra sa më shumë që të flasim, atëherë heshtja është më e mirë. Nëse do të ndërtojmë ura shpifjesh dhe mashtrimesh me çdo



fjalë që del nga goja jonë, nëse fjalët tona do të ushqejnë urrejtjen, atëherë heshtja është më e mirë. Nëse çdo fjalë e jona do të shndërrohet në mish e kocka në tubimin e madh Ditën e Gjykimit dhe ne nuk do të kemi guximin për ta parë asnjërin prej tyre kur të na dalin përballë nesh, nëse sytë do t'i largojmë prej këtyre fjalëve dhe nëse këto fjalë do të na detyrojnë të themi: "Ah sikur të ishim dhe!", atëherë heshtja është më e mirë.

Përse të themi gjithë ato fjalë kur pastaj do të dëshirojmë të ikim prej tyre? Për çfarë po flasim? Mos vallë kemi për qëllim që t'i hapim gropën vetes me fjalët tona? Me sa duket, veten po e robërojmë me fjalët tona, por nuk jemi të vetëdijshëm për këtë. Atëherë ne duhet t'i thyejmë këta zinxhirë dhe duhet të shpëtojmë nga robëria e fjalës. Ajo që neve na takon të bëjmë është një heshtje e vlefshme apo një fjalë e mirë. Vetëm se kjo nuk është e lehtë aq sa pandehet, sepse njeriu nuk mund të flasë dot drejt pa qenë vetë i drejtë dhe nuk mund të flasë dot me modesti pa qenë vetë modest. Ndërkohë që vetë është i lig, kurrë nuk mund të nxjerrë fjalë të mira prej gojës së tij. Atëherë, si mund të flasë fjalë të mira gjuha jonë ndërkohë që largësia ndërmjet nesh dhe mirësisë është shtuar kaq shumë? Si mund të jenë përgëzuese fjalët tona ndërkohë që gjendja jonë i bën të tjerët të na urrejnë? Njeriu duhet të bëjë shumë mirësi, në mënyrë që të flasë për mirësinë. Siç thonë të urtët, prej qypit rrjedh ajo që ka brenda.

Çdo fjalë që na përket neve, madje çdo shkronjë, fillon të ndërtojë një "ne" që nga momenti kur të dalë nga goja jonë. Në të vërtetë, si të jemi ne, të asaj natyre dalin edhe fjalët nga goja jonë. Pra, fjalët tona dalin prej nesh sipas thellësisë, dijenisë dhe besimit që kemi. Pra, fjalët tona dalin prej nesh sipas lidhjes që kemi me përshtatshmërinë,

Zotin dhe të vërtetën. Për këtë arsye, çdo fjalë që e ka humbur përshtatshmërinë, na largon neve nga vetja jonë. Humbja e të vërtetës dhe privimi nga përshtatshmëria, na e zbraz brendësinë tonë po aq sa edhe atë të fjalëve tona. Gënjeshtrat, thashethemet dhe shpifjet na e prishin brendësinë tonë. Për këtë arsye, plagoset rëndë personaliteti, humanizmi dhe besimi ynë.

Prej një personaliteti të tillë nuk vjen mirësi. Pastaj rreth nesh mbledhen grumbuj fjalësh si grumbujt e plehrave. Kur njerëzit të na e vënë veshin, nuk do të gjejmë dot qoftë edhe një fjalë me bazë për ta thënë në lidhje me mirësinë. Atëherë, kur të na vijë radha për të folur, nuk do të themi dot fjalë të cilat priten nga besimtarët.

Për këtë arsye, nuk do të themi dot qoftë edhe një fjalë të vetme rreth të vërtetës përderisa nuk i shembim muret që kemi ndërtuar në perceptimin tonë. Edhe ne si besimtarë jemi kapluar nga ajo rrëkeja prej të cilës janë kapluar të gjithë. Prandaj nuk e ngremë dot zërin tonë në gjithë këtë zhurmë të madhe. Për shkak se merremi vetëm me problemet e përditshme, nuk po themi dot asnjë fjalë të vlefshme për ne që të jetë shërim për zemrat tona, madje, as nuk po heshtim dot.

Sa e dhimbshme është për njeriun që e kaplon veten pas zhurmës së të tjerëve dhe që nuk e thotë dot këngën e tij! Sa e dhimbshme është që njeriu të flasë siç jeton ngaqë nuk jeton dot siç beson! Sa e dhimbshme është kur të mos gjejë fjalë të vlefshme për veshët e të tjerëve ngaqë veshët e tij gjithmonë kanë qenë të pushtuar (nga kotësitë)! Dhe sa e dhimbshme është kur të shohë se fjalët e tij nuk zënë dot vend në anën e duhur të peshores! Këtë nuk mund ta themi vetëm për fjalët, por edhe për heshtjen!



SHKOLLA E UNIVERSIT

Gjithësia, Kurani dhe Njeriu – 5

*Qielli ofron një thellësi që të merr sytë prej mistereve hyjnore
si një abazhur i mrekullueshëm kristali... Erërat, janë lajmëtarët e fshehta të
frymëzimeve hyjnore... Rrufetë, janë shkëndijat e frikës dhe të shpresës...
Gjëmimet, janë fermanët e sundimit të Kahharit/Mposhtësit dhe bombardime
që të zgjojnë prej indiferencës...*



EDHE TI PASTROHU NË QIELL!

“Kur ai ndotet e turbullohet, e nuk i mbetet më pastërti e kthjelltësi, edhe uji stresohet dhe hutohet ashtu si ne për shkak se ndotet mbi tokë. Ai fillon të rënkojë në shpirt, e thotë:

«O Zot! Unë e shpërndava dhe e dhashë gjithçka që më ke dhënë. Tani kam mbetur pa gjë. Kapitalin dhe të gjitha çfarë kisha në dorë ia hodha edhe të pastrit, edhe të pistit... O Zoti im që jep gjithçka, më dhuro edhe më tepër!»

Pas këtyre rënkimeve e përgjërimeve, Allahu i Madhëruar i dërgon ferman diellit, e i thotë:

«Ngrije atë menjëherë në qiell me nxehtësinë tënde!...»

E pasi ai pastrohet në qiell duke avulluar, ndonjëherë bie mbi tokë si shi, ndonjëherë si borë, e ndonjëherë si breshër. Më në fund, ai arrin në një det pa anë e pafund!”

Mevlana i nderuar, i cila na jep shembull këtë ndodhi imagjinare, dëshiron t’i thotë njeriut me urtësi:

“Ashtu siç pastrohen ujërat duke avulluar në qiell, ashtu edhe ti pastroje veten prej të gjitha papastërtive të egos, duke iu afruar Allahut të Madhëruar. Avulloji papastërtitë e egos! Eliminoji ato! Bëhu pjesë e misterit të Ahsen-i Takuim/Krijesës më të mirë!”

Pra, thuhet se:

“Ashtu siç konsiderohet uji si mëshirë për shkak të pastërtisë, shërimit dhe begatisë që ka, edhe ti bëhu një njeri mëshire, prej shpirtit të të cilit rrjedh paqe dhe begati!”

Krijimi i qumështit midis gjakut dhe papastërtive, është një mrekulli edhe më e veçantë.

Po ashtu, një mrekulli e jashtëzakonshme është edhe mjalti që prodhon bleta me jetëgjatësinë e saj prej një muaj e gjysmë, duke ndërtuar hoje që janë mrekulli arkitekturore më vete dhe duke realizuar mjeshtërisht atë që nuk mund ta bëjë asnjë kimist.

Nëse njeriu sheh vetëm ushqimin që ha e pi, atij do t’i mjaftojë si meditim. Në një ajet fisnik urdhërohet:



“Le të shohë njeriu ushqimin e vet!” (Abese, 24)

Sigurisht se ky shikimi, është shikim për meditim dhe për të marrë mësim. Nëse gjithësia nuk shihet me një zemër besimtare dhe të devotshme, atëherë shikimi do të jetë i turbullt dhe indiferent.

Kurani Fisnik i përngjan me kafshët ata që për shkak të mos meditimit nuk i përdorin cilësitë e tyre njerëzore që u ka dhënë Allahu i Madhëruar:

“...Ata që nuk besojnë dhe kënaqen e hanë ashtu siç gëlltisnin bagëtia, do të kenë Zjarrin si vendbanim!” (Muhamed, 12)

Ndërsa në një ajet tjetër fisnik, mohuesit që nuk e përdorin mendjen, përshkruhen në një humbje dhe nivel edhe më të ulët se kafshët.

Kjo, sepse kafshët jetojnë duke e madhëruar Allahun në gjendjen që janë krijuar. Për shkak se atyre nuk u janë dhënë mendje, zemër dhe shpirt të lartë (si njeriut), ato nuk kanë asnjë faj për atë që janë.

Kafshët janë krijuar për meditimin dhe përfitimin e njeriut, që ne të sodisim manifestimet e cilësive të Allahut, **el-Bari** (Atij që krijon në mënyrë origjinale, pa shembull, e pa kopje) dhe **el-Musauuir** (Atij që jep formën më të përsosur me mjeshhtërinë e Tij të lartë). Në Kuranin fisnik, përshkruhet shumë bukur shumëllojshmëria e ngjyrave dhe formave tek krijesat jo të gjalla, bimët, kafshët dhe tek njerëzit:

“Vallë, a nuk e sheh ti se si Allahu e lëshon ujin prej qiellit dhe nëpërmjet tij krijon fruta në lloje e ngjyra të ndryshme?!”

Nëpër male gjenden shtresa të bardha dhe të kuqe, ngjyra të ndryshme dhe krejtësisht të zeza.

Njerëzit, kafshët dhe bagëtitë janë në lloje të ndryshme gjithashtu. Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët, (që e dinë se) Allahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe Falës.” (Fatir, 27-28)



Ashtu siç janë të llojllojshme ngjyrat dhe format, ashtu janë edhe ushqimet. Tek çdo kafshë janë krijuar mekanizma të ndryshme për të siguruar ushqimin, për të kapur prentë dhe për të mbrojtur veten, siç janë brirët, dhëmbët e mprehtë, helmi, kamuflazhi, etj. Gjithashtu, edhe instinkti i krijesave për të siguruar vazhdimësinë e llojit të vet, është i mbushur plot me mistere.

Peshku i salmonit udhëton me kilometra të tërë, duke notuar në anën e kundërt të rrymës së ujit dhe në fund i lëshon vezët e tij në vendin më të përshtatshëm për llojin e vet. Të vegjlit që dalin nga vezët, vijnë në këtë botë me një program të caktuar jete... Këta peshq bartin furnizim dhe jetë kudo që shkojnë.

E gjithë jeta është brenda një harmonie ekologjike madhështore:

Në Kuran urdhërohet:

“Le të shohë njeriu ushqimin e vet! Jemi Ne që lëshojmë ujë me bollëk, pastaj e çajmë tokën në thellësi dhe nxjerrim prej saj drithërat, rrushin e perimet, ullirin e palmat, kopshtet e dendura, pemët dhe gjithë barërat, që t’i gëzoni ju dhe bagëtitë tua!” (Abese, 24-32)

Të gjitha këto mirësi, janë mundësi për meditim dhe falënderim që i janë dhënë njeriut për të kuptuar detyrën e tij kryesore.

NGA E PËRKOHSHMJA, DREJT SË PËRJETSHMES

Edhe njeriu, edhe ky univers janë të përkohshëm!

Njeriu do të nisë një udhëtim që fillon me vdekjen dhe lënien e kësaj bote. Njeriu ka frikë prej vdekjes dhe nuk e dëshiron përkohshmërinë. Mirëpo, nuk ka ku të shkojë. Atëherë, njeriu duhet t’i vërë veshin fjalës hyjnore: ***“Shkoni drejt Allahut!..”***¹,

1. -Dharijat, 50.

duke e pranuar mëshirën hyjnore si strehimin e vetëm për të.

Ata që strehohen tek Allahu i Madhëruar dhe që jetojnë me devotshmëri në rrugë të drejtë, Ai i ndihmon gjatë vdekjes dhe përtej saj. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Me të vërtetë, atyre që thonë: «Zoti ynë është Allahu», e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin melekët (para vdekjes) e do t’u thonë: «Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar.»”
(Fussilet, 30)

Ndihma e melekëve të Allahut, do të shfaqet në tre vende:

- Në çastin e vdekjes.
- Në varr.
- Në momentin e ringjalljes.

Sipas disa komentuesve të Kuranit:

Kur njerëzit e devotshëm përballen me probleme fetare dhe të kësaj bote në këtë jetë, melekët zbresin për t’ua zgjeruar atyre kraharorin me qëllim që të qetësohen dhe i frymëzojnë për t’u larguar frikën dhe hidhërimin. (Alusi, Ruhu’l-meani, XII, 372.)

Një hapje e tillë kraharori i duhet njeriut edhe për meditimin, i cili është një nga çelësat e besimit. Meditimi rreth krijesave, duhet të nxjerrë në pah tek njeriu këto ndjenja të thella dhe delikate. Përndryshe, nëse njeriu mbetet në indiferencë dhe devijim, ai do të bjerë në një gradë më të ulët se ajo e kafshëve. Këto evidencime, na bëjnë të meditojmë mbi mbështetjen e kafshëve tek Allahu i Madhëruar:

“Siç dihet, deri më sot, asnjë zog nuk është përpjekur të bëjë më shumë fole se sa fqinji i vet. Deri më sot, asnjë dhelprë nuk është mërzhitur se ka vetëm një vrimë ku të futet. Deri më sot, asnjë ketër nuk ka ngordhur prej stresit se nuk ka grumbulluar arra për dy dimra e jo për një dhe asnjë qen nuk ka kaluar netët e tij pa gjumë se nuk ka mbledhur kocka për vitet e tij të pleqërisë.”

VERBËRIA E INDIFERENCËS

Në kohën tonë teknologjia është e përparuar, ndërsa meditimi i prapambetur. Njerëzit pa besim,

duke menduar se mund të qartësojnë gjithçka me shpjegime të thjeshta në emër të shkencës, tallen vazhdimisht me meditimin e fetarëve.

Por, sa shpërdorim i palogjikshëm i mendjes është të përpiqesh të shpjegosh manifestimet e madhësisë hyjnore me rastësi dhe evoluim, larg besimit dhe devotshmërisë! Ky është një eklips i plotë mendor.

Allahu i Madhëruar, këtë lazdrim arrogant të njeriut e përshkruan dhe e dënon me këto fjalë:

“Nëse pas fatkeqësisë, Ne i japim atij që të shijojë nga mirësitë Tona, ai me siguri, do të thotë:

«Këtë e meritoj! Unë nuk besoj se do të vijë Ora (e Kiametit), por, edhe nëse kthehem te Zoti im, sigurisht që Ai do të më japë shpërblimin më të mirë.»

Në të vërtetë, Ne do t’i njoftojmë mohuesit për atë që kanë bërë dhe do t’i bëjmë të shijojnë një dënim të ashpër.”
(Fussilet, 50)

Të përfitosh prej gjithë këtyre të mirave, ta sodisësh gjithësinë, të meditosh mbi të, e më pas të mohosh Krijuesin, mund të shpjegohet vetëm me verbërinë e zemrave, gjë të cilën Zoti ynë e ka shprehur në këtë mënyrë:

“Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë, që zemrat e tyre të mendojnë dhe veshët të dëgjojnë? Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbuar sytë (në këto gjëra), por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor.”
(Haxh, 46)

Allahu i Madhëruar, ata që nuk e shohin të vërtetën i quan **“të verbuar në zemër”**, ndërsa ata që nuk e pranojnë ftesën në të vërtetën i cilëson **“të vdekur shpirtërisht”**. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Po ashtu, nuk janë kurrë të barabartë të gjallët dhe të vdekurit. Allahu bën të dëgjojë kë të dojë Vetë, kurse ti (Muhamed) nuk mund të bësh të dëgjojnë ata që janë në varre.” (Fatir, 22)

Me qëllim që besimtarët të mos pësojnë një përfundim të tillë, ata duhet të mos i largojnë zemrat nga meditimi, gjuhët nga përkujtimi i Allahut dhe gjendjet e tyre nga devotshmëria. Për këtë arsye, ata nuk duhet t’i nënshtrohen zakoneve. Nëse një personi të verbër prej lindjes do t’i hapeshe shikimi



përnjëherësh, kushedi se sa do hutohej. Kushedi sa do të mahnitej ai kur të shihte detin, pemët dhe zogjtë që fluturojnë në qiell. Këto janë gjëra që ai nuk i ka parë kurrë... Prandaj thotë, “sa bukur i ka krijuar Zoti im” dhe shikon me admirim.

Biri i njeriut, i cili përballet përditë me mijëra bukuri të tilla, në shumicën e rasteve kalon pranë tyre me indiferencë pa i vënë re dhe pa e gjetur rrugën drejt atmosferës së meditimit dhe ndjenjave të thella, njësoj si shkëmbinjtë e fortë dhe shkretëtirat që nuk përfitojnë asgjë prej shirave të begatë të Prillit edhe pse ai bie mbi to.

Një piktor i famshëm, i pasqyron në piktura disa pamje prej kësaj bote që ka krijuar Allahu i Madhëruar. Dhe për të ekspozuar ato piktura, hapen galeri, ku njerëzit shkojnë për t'i parë, duke paguar edhe shuma të majme vetëm për një tablo.

Ndërsa piktori vlerësohet si “artist i madh”. Mirëpo, artisti i vërtetë, është Mjeshtri Absolut, i Cili ka krijuar edhe piktorin, edhe pamjet e vërteta që ai zgjedh për të pikturuar. Artisti i vërtetë, është Krijuesi ynë i Madhëruar, i Cili ka krijuar njeriun dhe gjithçka tjetër.

Njeriu indiferent nuk ndjen admirim përballë artit të Mjeshtrit Absolut që ka krijuar gjithçka, por ndjen përball artit të piktorit që e imiton. Ndërsa zemrat e urta i sodisin pamjet reale dhe madhështore që janë vepër e penelit të fuqisë absolute dhe që ndryshojnë çdo sekondë për gjatë gjithë 24 orëve, pa iu pakësuar dhe pa e humbur admirimin. Buqetat e ngjyrave në agim dhe në perëndim... Manushaqet, zambakët dhe trëndafilat që dalin me njëmijenjë ngjyra prej tokës së zezë... Detet, lumenjtë, malet dhe luginat... Pra, nëse njeriu e sheh veten dhe gjithësinë me syrin e dashurisë dhe pasionit, është e pamundur që ai të mos mahnitet para madhështive dhe mrekullive hyjnore.

Meditimi nuk është vetëm në një drejtim. Nuk duhet të kuptosh vetëm ekzistencën e një Krijuesi. Meditimi duhet të jetë në disa drejtime. Për shembull le të mendojmë:

Në gjithësi çdo gjë dhe në çdo moment është aktive. Çdo gjë, që prej grimcës e deri tek objekti më i madh është vazhdimisht në lëvizje.

ÇDO GJË ËSHTË AKTIVE

Le të shohim grimcën/atomit: Elektronet rrotullohen rreth bërthamës në mënyrë të pandërprerë. Elektronet që rrotullohen përreth bërthamës së një atomi të hidrogjenit, lëvizin me shpejtësi 2 mijë km në sekondë.

Le të shohim botën e trupave të mëdhenj: Galaktikat, yjet, planetët dhe satelitët notojnë të gjithë në hapësirë me një lëvizje të vazhdueshme dhe të rregullt.

Allahu i Madhëruar na ka urdhëruar që edhe ne ta përfetojmë këtë cikël duke bërë tavaf, duke u rrotulluar përreth Bejtullahut/Qabesë gjatë umres dhe haxhit. Pra, të gjitha krijesat janë në një gjendje të vazhdueshme lëvizjeje dhe rrotullimi...

Zemra në trupin tonë nuk pushon asnjëherë. Frymëmarrja, qarkullimi i gjakut, rinovimi i qelizave, etj., janë të gjitha në gjendje pune të pandalur, qoftë edhe kur ne jemi në gjumë...

Zemra jonë nuk kërkon asnjëherë pushime vjetore. Po ashtu, as Dielli nuk bën pushim një apo dy ditë në javë.

Mesazhi që na japin të gjitha këto për jetën tonë të adhurimit dhe shërbimit, është domosdoshmëria e një përpjekje të vazhdueshme dhe të pandërprerë. Kjo, sepse Allahu i Madhëruar, edhe gjithësinë, edhe njeriun e drejton me ligje hyjnore.

“Ai e ka ngritur qiellin lart dhe ka vënë ekuilibrin (për çdo gjë), që ju të mos e prishni atë.” (Rahman, 7-8)

Kjo do të thotë se njeriu duhet të unifikohe me harmoninë hyjnore në gjithësi.

Siç është kjo botë e gjerë me krijesa, në një lëvizje dhe përpjekje të vazhdueshme, ashtu edhe një besimtar duhet të jetë vazhdimisht aktiv në jetën e tij.

Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiku fort (në adhurim) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!” (Inshirah, 7-8)

Po ashtu, edhe jeta e Profetit tonë të nderuar (a.s.), ka qenë në përputhje të plotë me këtë ajet fisnik. E gjithë dita e tij, ishte e mbushur me adhurime dhe kontribute familjare e shoqërore. Ibn Mes’udi (r.a.), i cili është edukuar pranë tij, thoshte:

“Unë habitem shumë kur shoh një njeri që nuk merret as me punët e kësaj bote dhe as me punët e botës tjetër, por rri kot.”

*Shkollimi
më i rëndësishëm
që i duhet besimtarit,
është përparimi shpirtëror
në sajë të bindjes së pandërprerë
ndaj urdhrit hyjnor,
“Lexo me emrin e Zotit
tënd që krijon!”
(Alak, 1)*



*Ata që vijnë vërdallë me fytyra të vrenjtura
e të ftohta në shkollën e sprovave hyjnore brenda së cilës jetojnë,
loja sy-mbylla që luajnë me indiferencë në këtë botë,
do t'u kthehet në një verbëri të përjetshme
në botën tjetër.*



Ndërsa Muhamed bin Ali (Allahu e mëshiroftë), thotë:

“Përtacia dhe mërzia janë çelës i së keqes, sepse kur përton, nuk e kryen punën siç duhet, ndërsa kur mërzitesh, do të thotë se nuk ke durim në atë punë.”

Ndërsa nga ana tjetër, dashuria lind emocione dhe gjallëri. Dhe kjo gjallëri, lind sakrificën. Në një vend ku gjendet një dashuri e tillë, lodhja dhe përtacia as që nuk mund të mendohen.

Pushimi dhe çlodhja e gjatë, mund të përjetohen vetëm në varr, pas një vdekjeje në paqe në fund të një jete të mbushur me begati dhe shërbim.

Një çështje tjetër, që është po aq e rëndësishme sa puna dhe përpjekja, është qëndrimi larg prej gjërave të kota dhe të padobishme. Në një ajet fisnik, lidhur me një cilësi të besimtarëve që arrijnë shpëtimin thuhet:

“(Ata) të cilët shmangen nga fjalët e kota.”
(Mu'minin, 3)

Me pak fjalë, njeriu duhet të mendohet...

Duhet të mendohet, sepse në gjithësi çdo cep është element meditimi... Edhe krijesat e Allahut janë elemente meditimi... Edhe historitë e popujve të shkuar janë elemente meditimi...

Bota mikroskopike që shihet me mikroskop dhe bota makroskopike e cila mund të shihet me teleskop vetëm në një pjesë të saj, duket sikur thonë:

“E madhëroj Allahun e Lartëmadhëruar, përballë artit të të Cili mahniten mendjet dhe me fuqinë e të Cilit mbeten pa fjalë edhe dijetarët më të mëdhenj!...”

Një tjetër aspekt madhështor i artit të Allahut të Madhëruar, që i mahnit mendjet, është madhështia që ai shfaq edhe në botën mikroskopike të atomeve, edhe në botën gjigande të universit.

Në një atom i cili mund të vëzhgohet vetëm me mikroskop elektronik, gjenden elektrone të cilët rrotullohen me një shpejtësi shumë të madhe përreth bërthamës. Nëse kjo botë e vogël do të zmadhohej, para nesh do të shfaqeshin trupa qiellorë të cilat rrotullohen rreth një ylli si në sistemin diellor.

Edhe mikrokozmosi mrekulli... Edhe makrokozmosi mrekulli...

Ata që shohin një elefant, vënë re se ai ka një feçkë të madhe dhe një tru që e komandon atë. Mirëpo, kur përballen me një feçkë dhe një tru të madh edhe tek një mushkonjë e vogël sa një kokërr gruri, atëherë mendjet mbeten të mahnitura me fuqinë hyjnore dhe pakufishmërinë e artit të tij, si në makro, ashtu edhe në mikro.

Një sëmundje e shkaktuar nga një bakter apo virus, që është aq i vogël sa nuk shihet me sy, mund të rrëzojë përtokë edhe një njeri të fuqishëm.

Për shkak se kjo gjithësi është e mbushur plot me tablo të panumërta meditimi, ajo është quajtur edhe Libri i Gjithësisë. Ashtu si Kurani i cili përbëhet nga ajetet që Allahu i Madhëruar i ka zbritur në zemrën e të Dërguarit të Tij (a.s.), ashtu edhe gjithësia është e mbushur me ajete, mrekulli, shenja dhe simbole që duhen medituuar dhe prej të cilave kemi dhënë edhe disa shembuj.

Njeriu i përsosur, që ka arritur devotshmërinë, i sheh botët me një sy pa perde, pra me syrin e zemrës. Ai i shfleton faqet plot urtësi të gjithësisë dhe fillon të lexojë. Ndërsa njeriu indiferent, e vendos gishtin e indiferencës në syrin e tij dhe nuk sheh asgjë.

Ashtu si njeriu dhe gjithësia që janë si pasqyra të cilat shohin njëra-tjetrën, ashtu edhe gjithësia me Kuranin janë binjakë. Çdonjëra prej tyre shpjegon tjetrën, duke u bërë ndihmës në përparimin në rrugën e njohjes së Allahut.

MEDITIMI I KURANIT

Kurani Fisnik, është mrekullia kryesore e Profetit të fundit, Muhamedit (a.s.), deri në Ditën e Kiametit. Ndërkohë që librat e mëparshëm hyjnorë kanë pësuar ndryshime rrënjësore, Kurani ka gëzuar mbrojtjen hyjnore.

Cilësia dalluese e popullit ku u dërgua Profeti ynë (a.s.), ishte poezia dhe letërsia. Ata organizonin panairë dhe poezitë që pranoheshin më të bukura, e më letrare, vareshin në murin e Qabesë. Në fakt, ky veprim ka qenë një urtësi hyjnore me qëllim që gjuha të zhvillohej në atë mënyrë që t'i shërbente Kuranit Fisnik.

Kur erdhi Kurani Fisnik, poetët e kohës dhe ligjëruesit oratorë i pushtoi heshtja, sepse Kurani i sfidoi ata. Ai i vuri ata me shpatulla pas muri, duke u thënë: *“Meqenëse po thonë se Kurani është fjalë njeriu, atëherë silleni ju një të ngjashëm!”*:

“Vërtet thonë ata: «Ai e ka trilluar atë»?! Nuk është kështu, por ata nuk besojnë. Atëherë le të sjellin një libër të ngjashëm me të, nëse ajo që thonë është e vërtetë!” (Tur, 33-34)

Më pas, Allahu i Madhëruar u dha edhe mundësinë për t'u ndihmuar me njëri-tjetrin, duke u kërkuar vetëm dhjetë sure të ngjashme me Kuranin:

“Nëse ata thonë: «Ai e ka trilluar atë!» Thuaju (o Muhamed!): «Sillni dhjetë sure të ngjashme (në bukuri dhe elokuencë) të trilluara dhe thirrni në ndihmë kë të mundni, përveç Allahut, nëse thoni të vërtetën!»” (Hud, 13)

Por përsëri, kësaj sfide nuk iu përgjigj askush. Më vonë, Allahu i Madhëruar e përsëriti edhe njëherë këtë ftesë duke i sfiduar vetëm me një sure:

“Nëse ju dyshoni në atë që ia kemi zbritur robit tonë (Muhamedit a.s.), atëherë hartoni një sure të ngjashme me atë që ia kemi shpallur atij! Thirrni në ndihmë edhe dëshmitarët tuaj (që i adhuroni) në vend të Allahut, nëse jeni të sigurtë.” (Bekare, 23)

“Nëse ata thonë: «Ai (Muhamedi) e ka trilluar atë (Kuranin)», thuaju: «Atëherë, sillni një sure të ngjashme me të dhe thirrni (në ndihmë) kë të mundni, përveç Allahut, nëse thoni të vërtetën.»” (Junus, 38)

Si përfundim, kur kësaj sfide nuk iu përgjigj askush edhe në kohën kur letërsia përjetonte kohën e saj të artë, atëherë Allahu i Madhëruar deklaroi se, edhe nëse do të mblidheshin të gjithë njerëzit dhe xhinët, ata nuk do të mund ta sillnin dot kurrë një Kuran të ngjashëm:

“Thuaj: «Sikur të tuboheshin të gjithë njerëzit dhe xhinët për të hartuar një Kuran të tillë, ata nuk do të mund të hartonin një të ngjashëm me

të, madje, edhe sikur ta ndihmonin njëri - tjetrin.»” (Isra, 88)

Pas kësaj iu dha fund edhe organizimit të panairëve letrarë. Ndërsa poezitë e varura në muret e Qabesë u zbritën poshtë, sepse ardhja e fjalës së Allahut, i kishte lënë të gjithë të mahnitur.

Kurani Fisnik, me diksionin e mrekullueshëm hyjnor, me butësinë dhe madhështinë e veçantë në poetikën e tij, me thellësinë dhe pasurinë e paanë, e të pafund të kuptimeve të tij, me oratorinë dhe elokuencën e tij të përsosur, me shërimin që u jep përmbajtja e tij të gjitha problemeve individuale, familjare, sociale, ekonomike dhe politike të njeriut dhe shoqërisë, me lajmet që sjell prej të fshehtës dhe me nxjerrjen në pah para shumë shekujsh të të vërtetave shkencore dhe të krijimit, të cilat njeriu i ka zbuluar këmbadoras, është një mrekulli e jashtëzakonshme deri në Ditën e Kiametit.

Kurani Fisnik, është sistemi i ligjeve dhe rregullave që ndihmon në kuptimin e qëllimit të krijimit të gjithësisë dhe njeriut, që organizon jetën ndërmjet djepit dhe varrit dhe që përgatit njeriun për paqen shpirtërore në këtë botë dhe lumturinë e përjetshme në botën tjetër.

Kurani Fisnik, përmban pjekurinë, të vërtetën dhe misterin që do ta bartë njeriun deri në Kiamet.

Po ashtu, edhe në soditjen në pasqyrën e zemrës së gjithësisë dhe ngjarjeve, shihet i njëjti dallim në kuptim dhe vetëdije, sepse, se sa është pastruar pasqyra e zemrës prej papastërtive të gjynaheve dhe haramëve dhe se sa është ndriçuar ajo me besim, devotshmëri dhe singëritet, këtë do ta tregojnë manifestimet që pasqyrohen në të.

Një emër tjetër i Kuranit, është edhe *“Dhikr”*. Njeriu e harron premtimin që i ka dhënë Zotit të vet në botën e shpirtave, e harron se do të kthehet përsëri tek Zoti i tij, e harron botën tjetër, qëllimin e krijimit, mëshirën, ndërgjegjen dhe moralin. Ndërsa Dhikri, është përkujtim.

Kur njeriu lexon Kuranin, që është kodi i krijimit dhe udhëzuesi i jetës, ai kujton faktin se është njeri, mediton mbi arsyen e krijimit të tij në këtë botë dhe se për ku po shkon. Më pas fillon të mendojë të nesërmen dhe se çfarë ka përgatitur për të.

Besimtari, ajetet e Kuranit Fisnik mund t'i meditojë aq sa është edhe devotshmëria në zemrën e tij. Shumë njerëz që ulen para të njëjtit Kuran, mund të përfitojnë prej tij në nivele të ndryshme. Mirëpo, ata që zemrat e tyre i kanë të kyçura, nuk mund të përfitojnë asgjë nga Kurani. Në një ajet fisnik urdhërohet:

“Vallë, a nuk përsiatin ata për Kuranin apo i kanë zemrat të kyçura?!” (Muhamed, 24)



EL-FETTAH

AI QË ELIMINON ÇDO PROBLEM DHE HAP DYERT E MIRËSIVE

— Ilir Hoxha —

E cilat janë ato dyer që nuk kemi nevojë që të hapen para nesh? Dyert e udhëzimit dhe mëshirës, dyert e drejtësisë dhe mirësisë, dyert e begatisë dhe bollëkut, dyert e suksesit dhe triumfit, dyert e paqes dhe qetësisë, apo dyert e furnizimit dhe fatit?..

Njeriu ka aq aftësi, sa çka edhe dobësi... Dobësi këto, që një ditë do ta shtrëngojnë atë në ndonjë qoshe. Por jo domosdoshmërisht vetëm dobësitë e tij! Ndonjëherë caktimi hyjnor na vë në provë me sprova të vështira... Ndonjëherë varfëria dhe skamja, e ndonjëherë edhe padija na i mbyll dyert para nesh... Pamundësia për të siguruar edhe nevojat më themelore të trupit dhe qetësinë e shpirtit, na sjellin dhe na vendosin përpara Fettahut... Aq sa kemi nevojë për çdo gjë në të dyja botët, aq kemi nevojë edhe për emrin "Fettah" të Zotit tonë... sepse vetëm Ai mund ta hapë në mënyrën më të mirë çfarëdo dere që dëshirojmë të na hapet. (shih. A'raf, 89.)

Ky emër përmendet në 38 vende të ndryshme dhe në forma të ndryshme në Kuranin Fisnik. Si një mbiemër që shpreh ekzagjerim, kjo fjalë rrjedh nga rrënja "fet'h" dhe ka kuptimet si, *"ai që hap dyert e mirësisë, ai që siguron drejtësinë absolute si gjykatësi i fundit ndërmjet të gjitha mosmarrëveshjeve, ai që ndan të drejtën nga e shtrembëta dhe nxjerr në pah të vërtetën, ai që i ndihmon të dobët dhe u jep fitoren besimtarëve"*. Po ashtu, Ai është që e hap edhe derën e zemrës drejt dijes dhe urtësisë.

Të gjithë çelësat e mirësive që mund të vijnë në mendje apo jo, janë nën urdhrat e Allahut. (shih. Zumer, 63.) Nëse Allahu na i hap dyert e mirësive, nuk ka kush t'i mbyllë ato. Po ashtu, nëse Ai nuk na i hap dyert e mëshirës së vet, s'ka asnjë fuqi që mund të na shpjerë drejt mirësive. (shih. Junus, 107.) Pra, derën që hap Ai nuk e mbyll dot kush, e atë që nuk e hap Ai, nuk e hap dot kush. (shih. Fatir, 2.)

MANIFESTIMET E EMRIT EL-FETTAH

Siç mund ta kujtoni edhe prej emrit Rezzak, furnizimi/riziku nuk është i kufizuar vetëm me nevojat e trupit. Në të njëjtën mënyrë, edhe disa dyer që ndonjëherë e ndjejmë se na mbyllën në fytyrë, nuk janë të kufizuara vetëm në çështjet materiale. Çelja e bimëve, plasja e farave dhe hapja e dymve të furnizimit e mëshirës, janë të gjitha manifestime të emrit hyjnor Fettah. Po ashtu, edhe hapja e zemrave drejt njohjes së Zotit, të mendjeve ndaj së vërtetës dhe të shpirtit drejt paqes, është në sajë të këtij emri hyjnor.

Ashtu siç ua hap robërve të Vet dyert e furnizimit dhe mëshirës, ashtu ua zgjidh Allahu njerëzve edhe punët e ngatërruara, u hap sytë dhe zemrat për të parë të vërtetën, i qetëson dhe i rehaton zemrat pas vështirësive dhe zgjidh me lehtësi të gjitha problemet e pakuptueshme për ta. (shih. Zumer, 22; En'am, 9.)

Mirësia më e madhe e Allahut ndaj birit të njeriut, është shpallja hyjnore, që do të thotë shpallje e dijes hyjnore para tyre. Allahu i Madhëruar, me cilësinë e Tij "el-Fettah", e ka hapur derën e botës së të fshehtës për ne me anë të shpalljes dhe, duke na bërë të ditur aq sa duhet të dimë, ka larguar prej mendjeve tona shumë çështje të pakuptueshme/të mbyllura. Kjo është edhe arsyeja që surja e parë që hap Librin e Allahut të Madhëruar, quhet "el-Fatiha"... Në ajetin 40 të sures A'raf, na bëhet e ditur se atyre, të cilët nuk kalojnë prej kësaj dere që na ka hapur Allahu në këtë botë, duke iu dorëzuar shpalljes së Tij, nuk do t'u hapen as dyert e qiejve dhe nuk do të hyjnë në Xhenet.

Sipas dietarëve, manifestimi i emrit hyjnor el-Fettah, përfshin tre fusha që kanë të bëjnë me të gjitha qeniet:



a) Sjellja në ekzistencë e materies dhe ndodhive, duke hapur kyçin e mosekzistencës.

b) Shpjegimi i të panjohurës me fjalën e Tij dhe zgjidhja e çdo problemi.

c) Hapja e kyçave të furnizimit dhe begatisë.

Nisur nga kjo, manifestimi i këtij emri mund të vërehet si në planin material, siç është shiu pas thatësisë, ose pasuria pas skamjes, ashtu edhe në planin shpirtëror, siç është kthimi i hidhërimit në gëzim, i humbjes në udhëzim, i gjynahut në pendim, i disfatës në fitore dhe i injorancës në dije.

Edhe puna që kryejnë gjykatësit quhet një lloj “hapjeje”, sepse ata zgjidhin çështje të mbyllura kur gjykojnë midis dy palëve, se kush ka të drejtë, e kush jo. Po ashtu, këtë e vërejmë edhe në lutjen që Nuhu (a.s.), i bëri Allahut për të zgjidhur çështjen midis tij dhe popullit të vet, ku përdoret shprehja “iftah/hap”, gjë e cila tregon se manifestimi i së drejtës ka lidhje me emrin el-Fettah. (shih. Shuara, 118.) Dihet se ndonjëherë, drejtësia realizohet me ndëshkimin e fajtorit. Për këtë arsye, ashtu siç hap dyert e mirësive dhe mëshirës, Allahu hap edhe dyert e belave dhe ndëshkimit për ata që e meritojnë. (shih. En’am, 44-45; Kamer, 11; Mu’minun, 76-77.) Në të njëjtën mënyrë, Allahu do të zgjidhë çdo çështje midis njerëzve në Ditën e Kijametit. (Sebe’, 26.) Zgjidhja e problemeve, hapja e dyerve të mbyllura dhe gjykimi me drejtësi midis njerëzve dhe çështjeve, mund të arrihet vetëm me dijen e çdo gjëje, pra me dije dhe urtësi. Për këtë arsye Zoti ynë përmendet me dy emrat e tij Fettah dhe Alim në të njëjtin ajet.

Mistiku i madh Imam Kushejri, thotë se, një rob i cili e di se Allahu i Madhëruar zotëron emrin/cilësinë Fettah, nuk do ta humbasë kurrë shpresën se mirësia dhe bujaria e Allahut do të arrijë patjetër. Ai e di se ndihma e Allahut nuk ndërpritet kurrë dhe se në çdo moment mund të hapet një derë e mirësisë prej botëve të padukshme. Prandaj, është e domosdoshme që kjo të kërkohet prej Allahut dhe duke u kapur pas shkaqeve që Ai ka krijuar.

Cilat janë shkaqet pas të cilave duhet të kapemi ne me qëllim që Zoti ynë të manifestohet me emrin e Tij Fettah dhe të hapë dyert e mëshirës për ne? Çfarë duhet të bëjmë që të gëzojmë mirësinë Allahut si Fettah?

Siç shprehet Imam Kushejri, kjo arrihet duke lehtësuar ata që janë në vështirësi si ne. Një nga shembujt më të bukur të kësaj në Kuranin Fisnik,

është ndodhia e Musait (a.s.), i cili pasi u largua nga Egjipti nga frika e faraonit, arriti pranë një pusi në Medjen, ku u mbështet i lodhur pa pasur ku të shkojë. Aty vuri re dy vajza që kishin vështirësi në dhënien ujë kafshëve të tyre dhe i ndihmoi. Më pas ai iu lut Allahut duke thënë: *“Zoti im unë kam nevojë për çdo gjë që do të më japësh”*. Për rrjedhojë, Allahu i Madhëruar iu përgjigj atij menjëherë duke i siguruar edhe strehim, edhe punë edhe një familje të mirë. (shih. Kasas, 21-28.)

Në këtë ndodhi, Allahu i Madhëruar e ndihmoi Musain (a.s.), duke i dërguar më parë një mundësi që edhe ai të ndihmonte. Prandaj, edhe ne kështu duhet t’i shohim mundësitë që na jepen për t’u ardhur në ndihmë të tjerëve, që Allahu të na i hapë dyert e ndihmës së Tij...

Gjithashtu, Kurani Fisnik, edhe hapjen e dyerve të begative të qiejve dhe të tokës i lidh me besimin dhe devotshmërinë: *“Sikur banorët e atyre qyteteve të besonin dhe të ruheshin prej gjynaheve, Ne do t’u dërgonim bekime nga qielli dhe toka, por ata mohuan, prandaj i dënuam për atë që bënë.”* (A’raf, 96.)

Ndërsa sipas Imam Gazaliut, rob i duhet të bëjë përpjekje derisa të arrijë në atë gradë, që me gjuhën e tij të zgjidhen problemet dhe po ashtu me dijen dhe njohjen e tij të lehtësohen çështjet e popullit në lidhje me këtë botë dhe me botën tjetër, duke e ngritur veten në shkallën e njerëzve të përsosur. Pra, derisa të ketë përfituar prej emrit hyjnor Fettah.

Kurse autori i Komentimit të Esmat Husna, Ali Osman Tatlisu, shpjegon mënyrën se si mund të gëzohen mirësitë e emrit Fettah, duke thënë: *“Mëshiro ata që janë më dobët se ti, që të mos pësosh prej zemërimit të atyre që janë më të fortë se ti! Ndhimjoji të këputurit nëse ke mundësi, që edhe ai i këputuri të të ndihmojë kur të vijë koha! Dhe mos ceno askënd! Sepse në kohë fatkeqësish dhe katastrofash njerëz të tillë nuk i dhimbsen askujt.”*

T’u hapësh rrugën e përparimit njerëzve që drejton, e për këtë t’u sigurosh atyre mundësitë e dhura dhe mbështetje, të zgjidhësh problemet e atyre që ke nën vete dhe të bëhesh prej atyre që të gjithë mund t’ia hapin hallet e tyre dhe ku mund të gjejnë zgjidhje, është nga treguesit kryesor të faktit se je një njeri ku manifestohet emri i Allahut, el-Fettah. Për këtë arsye, nuk duhet të qahemi kurrë nëse jemi prej njerëzve tek të cilët të tjerët qajnë hallet e tyre dhe shpresojnë për zgjidhje...

Refleksione

Nuredin Nazarko

Sa më shumë kohë fizike kalon nga realizimi i projektit në mundësi, aq më reflektiv bëhet njeriu. Kjo, nëse dëshiron të jetë i tillë. Mund edhe të mos ketë aspak dëshirë të meditojë mbi përjetimet e veta, ngjarjet që ka vëzhguar ndër të tjerë, librat që ka shfletuar, nëse. Kjo padëshirë meditimi nuk do ta lejojë të mbledhë frytet e ëmbla të tij. Meditimi mbi jetën na jep në dorë urtësi të cilat nuk mund të vijnë në asnjë mënyrë tjetër. Duhet të kthehemi tek ajo çfarë kemi qenë dhe të kuptojmë përse kemi qenë ata që kemi qenë? Cilat kanë qenë arsyet që kanë ndikuar mbi personalitetin tonë? A është e mundur të ndryshojmë pjesë të caktuara të karakterit tonë? A mund të jemi më ndryshe, duke anuar gjithmonë e më shumë nga mirësia dhe të përpjekurit për të bërë mirë?

Për t'iu dhënë përgjigje këtyre pyetjeve apo dhe shumë e shumë të tjerave, meditimi është i pazëvendësueshëm. Është kusht i patjetërsueshëm nëse duam të përmirësojmë cilësinë e jetës shpirtërore. Përmirësimi i jetës shpirtërore është sfida kryesore e njeriut, veçanërisht kur përballë gjendet vorbullat e lëndës dhe pasioneve që lindin nga lakmia për të. Përballimi i lakmisë kërkon forcë të madhe shpirtërore. Kjo forcë nuk mund të vijë ndryshe vetëm se duke u pastruar vazhdimisht në ujërat e oqeanit të urtësisë. Kredhja në këto ujëra duhet të ndodhë medoemos, edhe pse ka syresh që e shohin të pamundur për arsye nga më të ndryshmet. Në çaste të caktuara nuk do të ishte asnjëherë vonë të nisnim meditimet tona për të nxjerrë mësim dhe për të përfituar nga ajo çfarë ka kaluar, pasi që ajo që vjen ende nuk është e njohur.

1. Nuk duhet të shastisemi pas bukurive përjashtësore e të humbim kohë, duke u hyrë në pjesë qëllimeve tona thelbësore.
2. Nuk duhen humbur shpresat kurrnjëherë. Për çdo problem ka një zgjidhje. Nëse nuk ka zgjidhje, atëherë moszgjidhja është zgjidhje.
3. Qëndro larg të ligjve nëse është e mundur. Nëse nuk ke fuqi të përballesh me fuqinë e tyre përdor fuqinë e mendjes për të ruajtur veten.
4. Shkujdesja ndaj gjërave që i duam na çon drejt harresës ndaj tyre. Duhet të ndodhë një dridhje, thyerje, tronditje që të rikthehemi aty ku ishim para shkujdesjes.
5. Nëse posedon gjëra të çmuara, kujdesu të mos i ekspozosh ndaj syve ziliqarë. Edhe nëse nuk duken të jenë të tillë, posa të shohin bukurinë e të çmuarës do të bëjnë çmos ta përvetësojnë, madje duke të dëmtuar deri në asgjësim.
6. Ruaju nëse i ligu rrethohet nga këshilltarë të djallëzuar dhe për më tepër kur synon atë që të përket ty.
7. Përballimi i të ligut dhe ligësisë ka nevojë të domosdoshme për miq të mirë, të drejtë dhe që të duan pastërtisht.
8. Edhe atëherë kur situatat që duhet të përballosh duken krejt absurde, mos e humb shpresën. Kandili i shpirtit të virtytshëm e mposht errësirën e absurdit.
9. Ndaj ligësisë mos u trego i dobët. Ajo që duhet shkukur nga rrënjët nuk duhet kursyer, përndryshe grami do të ta thithë oksigjenin.
10. Në luftën ndaj së keqes duhet përgatitje, por mbi të gjitha trimëri, e mbi trimërinë zgjuarsia.
11. Nëse përballë ke kundërshtar të egër, barbar dhe shpirtlig dhe më të fuqishëm se vetja, zbullo dhe godite pikën e tij të dobët. Çdokush ka një thembër akiliane.
12. Nuk duhet të mashtrohem nga shkëlqimi për-

jashtësor i gjërave. Një mollë që shkëlqen mund të jetë mbushur me helm, një burim me ujë të ftohtë mund të mos të ta shuajë etjen kurrë, një shtrat i butë mund të mos të të rehatojë asnjëherë.

13. Ndiurma të vjen edhe nga nuk e pret, prandaj vlerësoji mundësitë që fati të dërgon e mos u var pas iluzioneve të atyre gjërave që tashmë i ke humbur e janë bërë pjesë e së shkuarës.
14. Për gjërat që janë përnjështuar me qenien tënde tregohu i kujdesshëm. Ruaji dhe mbroji nga lakmia e vetvetes.
15. Mos i beso askujt pa e provuar më parë besnikërinë e atyre që të rrethojnë. E keqja mund të të vijë edhe nga njerëzit që i konsideron shumë të afërt, madje dhe nga të gjakut tënd.
16. Ruaju e mos u deh nga të mirat që posedon. Nga harresat e vogla vijnë dëme të mëdha. E nëse dëmet vijnë, mos u lëkund! Fati po të shpie ndër burime mjalti me siguri.
17. Dëme të mëdha vijnë nga zemra të mbushura me smirë. Brenda atyre kraharorëve vlon kazani ziftit. Qëndroji larg, por dije se nuk do të qëndrojnë ato larg. Zjarri i smirës është më i fortë se çdo zjarr tjetër.
18. Për gjërat që i do me gjithë shpirt lufto deri në fund për t'i patur. Ia vlen çdo pikë djerse e çdo pikë gjaku që njom udhën e përpjekjeve.
19. Mos i shit lirë gjërat që mbushin me jetë shpirtin tënd, edhe sikur të të paguajnë me ar e argjend.
20. Mos u gëzo para kohe për të mirat që të jepen, duke menduar se je pronar i tyre. Një çast i vetëm të kthen aty ku u nise, edhe nëse udha që ke përshkuar është tepër e gjatë.
21. Fati është në anën e atij që kërkon pareshtur fatin e vet.
22. Bëj mirë, qoftë edhe pak. E mira e paktë është e tepër e madhe për të vuajturin. Me siguri do ta marrësh mirënjohjen në një ditë në të cilën do të kesh shumë nevojë për të t'u bërë mirë.
23. Mos i zër besë ledhave, lazdrimeve dhe bujarisë së të panjohurve edhe sikur fytyrat e tyre të duken plot hijeshi. Nuk dihet se ç'mund të fshehin zemrat e tyre. Njeriu vepron sipas asaj që mban në zemër dhe jo sipas asaj që tregon në fytyrë.
24. Kur të vendosesh përpara zgjedhjeve, mos rend

të zgjedhësh atë që të duket më e afërt për t'u arritur dhe më e lehtë për ta patur. Rezistoi tundimit të së afërtës dhe lakmisë për të lehtën që të shkosh larg, atje ku të pret ajo që vërtet kërkon.

25. Fol me butësi e mirësi. Asnjëherë nuk mund ta dish se çfarë të mirash mund të të sjellë një fjalë e ëmbël.
26. E keqja mund të të vijë edhe nga njerëzit e gjakut. Mos u përgjunj! Vazhdo të ndjekësh virtytet e tua edhe sikur në humnerë të të hedhin.
27. Nëse të pushtetshmit i bën një të mirë dhe prej saj i ndodh ndonjë e pakëndshme, përgatitu për më të keqen. I dobëti është gjithmonë fajtori. Prandaj mos u ngazëlle nga shoqërimi me të pushtetshmin.
28. Mos e shpërfill këshillën e mirë nga askush, qoftë edhe nga ata që nuk i njeh, nëse zemra jote e ndjen se po të qasen pa të keq për të të këshilluar.
29. Pasioni i mirë dhe vullneti i fortë duhet të shkrihen me njëri-tjetrin që të nxjerrin në dritë vepra të mëdha.
30. Që të shkosh larg, mbliidh rreth vetes miq të mirë e të drejtë. Prej tyre vetëm ëmbëlsi shijon.
31. Mos e kurse ujin për shpirtrat e etur. Uji që jepet me mirësi mund të shuajë zjarrin e ligësisë.
32. Gjithmonë do të gjenden shpirtra të dobët që molepsen e thyhen nga zilitë e çastit. Por gjithmonë do të gjenden edhe shpirtra të mëdhenj që dinë të falin e të nxjerrin në pah vlerën e paçmuar të mirësisë.
33. Njeriu nuk duhet nënçmuar kurrsesi. Nuk dihet se në ç'shpiet ka zënë rrënjë mirësia, e nuk dihet se në cilin çast lulëzon e jep fryte.
34. Bëji pengesë pangopësisë. Ajo do të të hapë dyert e makutërisë dhe vetëm nëntoka mund të të kënaqë.
35. Ruaju nga pasioni i keq. Zjarri i dalldisë që del prej tij të djeg zemrën e ta humb arsyen. Nëse ndodh kjo luftë e madhe, duhet për t'u dëlirur. Ka që dëliren, por ka dhe që shkrumbohen.
36. Mos i paragjyko shenjat e stuhisë e mos u frikëso. Pas tyre qëndrojnë rrezet e diellit.
37. Mos iu qas gjërave për të cilat nuk ke njohuri. Pësimet mund të jenë shumë të rënda dhe do të të duhet të paguash çmim të madh për t'u rikuperuar.



RIB'I IBN AMR EL-ENSARI

— Mustafa Erish —

Rib'i ibn Amr el-Ensari (r.a.), ishte një sahab i cili shfaqti një besim të palëkundur dhe një trimëri të pamposhtur përballë armikut!..

Ai ishte i dërguari/përfaqësuesi i dytë i Islamit, i cili u dërgua tek komandanti i ushtrisë perse, Rustumi!..

Ishte një burrë, i cili u bë i njohur me qëndrimin e tij të palëkundur dhe me përgjigjet e matura përballë Rustumit gjatë kumtimit të Islamit. Ai ishte një trim që nuk ngurronte të thoshte të vërtetën dhe nuk trembej prej armikut!..

Falë nofkës “el-Ensari” me të cilën njihet, kuptohet se ai ka lindur dhe është rritur në Medinë. Mirëpo, se prej cilit fis vjen, kur është nderuar me Islam, ku dhe si është takuar me Profetin tonë (a.s.), nuk dihet. Në lidhje me jetën e tij nuk ka shumë të dhëna.

Ai është një prej sahabëve të Bedrit. Transmetohet se ka marrë pjesë në luftën e Bedrit, ndërsa në ndodhinë e Siffinit ka luftuar në anën e Aliut (r.a.). (Isabe, II, 379; Usdu'l-gabe, II, 253.)

Rib'i ibn Amr el-Ensari (r.a.), gjatë periudhës së halifit Omer (r.a.), ka kryer detyrën e përfaqësuesit/ambasadorit islam. Myslimanët që jetonin nën ombrellën e drejtësisë së Islamit në atë periudhë, nga një anë përjetonin kohën e tyre të artë, e nga ana tjetër ushtritë islame luftonin në të gjitha frontet. Fitoheshin vende të reja, arriheshin fitore dhe zgjeroheshin tokat islame.

Kur Profeti ynë (a.s.), u shkruante letra kryetarëve të vendeve, mbretërve dhe sunduesve duke u kumtuar fenë dhe duke i ftuar në Islam, i paralajmëronte ata duke u thënë: *“Pranoni Islamin dhe shpëtoni!”*

Letrën që ia dërgoi mbretit të Persisë, e mori Pervizi dhe e bëri copa-copa. I Dërguari i Allahut (a.s.), u mërzit shumë nga ky veprim dhe në lidhje me mbretin e Persisë, u lut me këto fjalë: *“O Zot! Ashtu siç e copëtoi ai letrën time, copëtoja edhe Ti mbretërinë atij!..”* Ja pra, realizimi i asaj duaje ishte afëruar. Mbreti i Persisë,

Pervizi, u vra me thikë nga djali i tij, Shirveje. Tani, e kishte radhën copëtimi i mbretërisë së tij.

Rib'i ibn Amr el-Ensari (r.a.), mori pjesë në çlirimin e Persisë me ushtrinë që ishte nën komandën e Sa'd ibn Ebi Uakkasit (r.a.), në periudhën e halifatit të Omerit (r.a.). Ushtria islame u afrua në vendin e quajtur Axhem. Komandanti i ushtrisë së mbretit pers nuk dëshironte të përplasej me ushtrinë islame për shkak të grindjeve për pushtet brenda mbretërisë perse. Për këtë arsye, ai po përgatiste terrenin për të bërë paqe me mysli-manët. Mirëpo, ai nuk e linte pas dore as përgatitjen ushtarake.

Përballë ushtrisë Islame prej 34 mijë ushtarësh të gatshëm, qëndronte ushtria e Persisë me 120 mijë ushtarë të gatshëm dhe 80 mijë rezervistëve. 30 mijë prej këtyre të gatshëmëve, ishin të lidhur me zinxhirë me njëri-tjetrin me qëllim që të mos iknin prej luftës. Me gjithë këtë, Rustumi nuk kishte besim tek vetja. Prandaj, ai përpiqej të merrte kohë duke kërkuar shpesh të dërguar prej Sa'd ibn Ebi Uakkasit (r.a.).

Ushtria Islame, në zbatim të parimeve të fesë sonë, në fillim i dërgonte armikut përfaqësues dhe i ftonte në Islam. Për këtë arsye, Rustumi iu dërguan disa përfaqësues. Ndërsa Rustumi e refuzonte vazhdimisht ftesën e tyre.

Rib'i ibn Amr el-Ensari (r.a.), ishte përfaqësuesi i dytë që iu dërgua Rustumit. Trimëria që shfaqti ai përballë armikut, qëndrimi i tij i guximshëm e gjakftohtë dhe kumtimi i fesë së vërtetë pa pasur frikë nga dëmtimi apo vdekja, ishin të jashtëzakonshme. Aq sa, kur ai arriti pranë komandantit pers, Rustumit, u përball me një pamje madhështore të cilën nuk ia kishin zënë kurrë sytë. Vendi ku gjendej, ishte zbukuruar me jastëkë të qëndisur, tapetë prej kadifeje dhe me shumë stoli të tjera si perla dhe xhevahire. Rustumi ishte ulur në një fron të larë në ar. Ndërsa njerëzit përreth i shërbenin si skllëvër.

Rib'i ibn Amr el-Ensari (r.a.), kishte veshur një rrobë

shumë të thjeshtë dhe të vjetër. Ai kishte një shpatë të shtrembër, një mburojë të shtypur dhe një kalë të dobët. Mirëpo, madhështia e Rustumit nuk e joshi dhe nuk e tërhoqi aspak atë. Përballë të gjitha këtyre që shihte, ai kishte një besim të palëkundur dhe një trimëri e guxim të pamposhtur. Kur arriti në vendin e shtruar me tapeta, zbriti nga kali dhe e lidhi kalin aty ku ishte. Armën dhe mburojën e kishte në trup, ndërsa helmetën në kokë. Atij i thanë: “Lëre armën dhe eja!..” Ndërsa ai u përgjigj me maturi dhe guxim të madh duke thënë:

“Nëse më pranoni kështu, mirë, nëse jo kthehem e iki. Unë nuk kam ardhur vetë këtu. Ju më fuat, prandaj erdha.”

Të pranishmit u habitën prej guximit dhe maturisë që tregoi ky njeri me trup të dobët. Ndërsa Rustumi, me një krekosje dhe arrogancë të madhe tha: “Lëreni të vijë!..”

Rib'i ibn Amr el-Ensari (r.a.), shkoi drejt tij me dinjitetin e një myslimanit dhe pa u frikësuar aspak. Kur iu afrua Rustumit, e nguli heshtën në tokë, ku gjendeshin jastëkët e mëndafshhtë dhe i çau ato me majën e mprehtë të heshtës.

Këta jastëkë të zbukuruar, që kishin një vlerë shumë të madhe për Rustumin dhe njerëzit rreth tij, për Rib'in nuk kishin asnjë rëndësi. Mendimi i tij i vetëm, ishte të çonte në vend detyrën e tij në mënyrën më dinjitoze.

Rustumi vazhdoi po me të njëjtën krekosje dhe tha: “Thuaj ç'ke për të thënë!..”

Rib'i ibn Amr el-Ensari (r.a.), me një fisnikëri të lartë, me seriozitet dhe maturi tha:

“Allahu i Madhëruar na ka dërguar një Profet, me qëllim që t'i shpëtojë ata që do prej robërisë së robit, nga vuajtjet e kësaj bote dhe padrejtësitë e feve të kota dhe t'i udhëzojë drejt adhurimit të Tij dhe drejtësisë Islame. Kush e pranon këtë fe, bëhet prej nesh dhe ne kthehemi e ikim. Kush nuk e pranon, do të luftojmë me të derisa të arrijmë atë që ka premtuar Allahu!”

Rustumi tha: “Ç'është ajo që ka premtuar Allahu?”

Rib'i ibn Amr el-Ensari (r.a.), tha: “Xheneti për ata që vdesin në luftë me mohuesit dhe triumfi për ata që mbesin gjallë.”

Rustumi tha: “I dëgjova ato që the. A na jep kohë të mendojmë rreth kësaj çështjeje?”

Ndërsa Rib'i ibn Amr el-Ensari (r.a.), tha: “Po, do t'ju japim kohën që dëshironi.”

Rustumi pyeti: “Sa kohë na jepni?”

Rib'i ibn Amr el-Ensari (r.a.), u përgjigj: “Mund t'ju japim vetëm një ose dy ditë.”

Rustumi u hodh menjëherë e tha: “Jo!.. Kjo kohë është shumë e shkurtër për të shkëmbyer letra me prijësit dhe dijetarët tanë.”

Rib'i ibn Amr el-Ensari (r.a.), pa nguruar aspak tha:

“Profeti ynë na ka urdhëruar që kur të përballemi me armikun, të mos i japim më shumë se tre ditë kohë. Mendohu dhe pyet njerëzit e tu! Brenda kësaj kohe zgjidh njërën prej këtyre tre alternativave! Të bëhesh mysliman, të paguash xhizjen ose të luftosh.”

Rustumi pyeti përsëri: “A mos je ti zotëria i tyre?”

Rib'i ibn Amr el-Ensari (r.a.), u përgjigj: “Jo!.. Por myslimanët janë si një trup i vetëm që i japin forcë dhe mbështetje njëri-tjetrit.”

Pasi mori këto përgjigje prej përfaqësuesit mysliman, Rustumi mblodhi njerëzit e tij dhe tha: “A keni dëgjuar ndonjë fjalë më të çmuar dhe më të vlefshme se këto të këtij njeriu?”

Njerëzit e tij reaguan shumë ashpër ndaj këtyre fjalëve dhe e kundërshtuan atë duke thënë: “Zoti të ruajtë nga braktisja e fesë tënde dhe animi nga fjalët e atij njeriu! A nuk i pe rrobat e tij? E çfarë mund të jenë fjalët e një njeriu që vishet në atë mënyrë?”

Pasi i dëgjoi, Rustumi u tha:

“Turp të keni! Rrobat e tij shikoni ju? Personaliteti i njeriut nuk është tek rrobat e tij, por tek mendja, aftësia. Këta nuk u japin shumë rëndësi ushqimit dhe veshjeve. Për ta, e rëndësishme është mendja.”

Si përfundim, fjalët e përfaqësuesit të Islamit nuk u morën për bazë dhe, për rrjedhojë dy ushtritë u përplasën me njëra-tjetrën.


Ushtria Islame e përbërë prej 34 mijë ushtarësh të veshur si Rib'i ibn Amri (r.a.), arriti të triumfojë brenda një kohe të shkurtër ndaj ushtrisë perse të përbërë prej 200 mijë ushtarësh të veshur me rroba të bukura.

Ushtria Islame hyri në Medajin me ç'rast u realizua edhe lutja e Profetit tonë (a.s.). Të gjithë dëshmuan për këtë. Ndërkohë që prej ushtrisë Islame ranë shumë pak dëshmorë, ushtria perse humbi 120 mijë ushtarë, ndërsa pjesa tjetër u arratisën. (Isabe, I, 503; Hajatu's-sahabe, I, 157; Taberi, III, 518-524.)

Rib'i ibn Amr el-Ensari (r.a.), i cili mori pjesë edhe në ndodhinë e Siffinit në anën e Aliut (r.a.), nuk dihet se ku dhe kur ndërroi jetë. (Isabe, II, 379; Usdu'l-gabe, II, 253.)

Allahu qoftë i kënaqur me të!

Allahu i Madhëruar na bëftë të gjithëve të marrim shembull prej trimërisë, guximit, fisnikërisë dhe entuziazmit të besimit të Rib'i ibn Amr el-Ensarit (r.a.). Amin!



Gjej veten për të mos humbur vetveten!

— Mehmet Dinç —

Jeta është një rrugëtim apo një kërkim për njohjen apo gjetjen e vetes. Ai që njeh veten, ka gjetur veten dhe ai që gjen veten, shpëton jetën.

Pyetja “Kush jam unë?” është një nga pyetjet më të vështira që njeriu ka shtruar gjatë historisë së njerëzimit, në të gjitha kulturat. Në kulturën tonë është thënë: “Kush njeh veten, njeh Zotin” dhe kështu, njohja e vetes është vlerësuar sa njohja e Zotit. Në arkitraun e tempullit të Delfit në kulturën perëndimore, është shkruar me të madhe, sa mund të vërehet që me kilometra larg: “Njih veten!” Në fakt jeta është një rrugëtim apo një kërkim për njohjen apo gjetjen e vetes. Ai që njeh veten, ka gjetur veten dhe ai që gjen veten, shpëton jetën... Ndaj dhe sa më herët që të nisesh rruga aq më shumë do të jesh i saktë dhe vendi ku do të arrish do të afrohet më shumë.

Njeriu me pyetjen: “Kush jam unë?” për herë të parë përballet në periudhën 15 – 18 vjeç, kohë që përkufizohet si adoleshencë e mesme. Atëherë njeriu ka hyrë në një zhvillim të shpejtë në çdo kuptim. Arsyeimi abstrakt dhe koklavitja e përgjithshme që ishte në adoleshencën e parë është kapërcyer si fazë e parë dhe tashmë ka ardhur koha e përballjes me veten. Thënë me shprehjen e Junus Emresë, njeriu është në statusin “Ekziston një “unë”, tek unë, brenda meje!”

Me zhvillimet dhe ndryshimet që kanë ndodhur, individit më shumë ka përjetuar një tëhuajësim

në raport me veten dhe ndihet sikur po bart një unë të ndryshëm me veten.

Prandaj duhet që sa më shpejt të njohë dhe të dijë veten që gjendet brenda tij dhe të plekset me të. Ja pra individit pikërisht në këtë pikë starton të pyesë “Kush jam unë?” Natyrisht që pyetja “Kush jam unë”, nuk ka një përgjigje të lehtë dhe të vetme. Prandaj, duke pasur mundësinë të përpiqen që të njohin veten e tyre, shumica e njerëzve, në vend që të njohin vërtet veten, ta zbulojnë atë apo me shprehjen më të saktë të krijojnë identitetin e tyre, zgjedhin rrugën më të lehtë:

krijojnë identitete mbi identitetet e grupeve dhe njerëzve të caktuar.

Disa njerëz krijojnë identitete të llojit “skllavëri sociale”. Këta lloj njerëzish lidhen me një grup dhe shkrijnë identitetin e tyre brenda atij grupi dhe çdo hap i tyre, çdo fjalë apo sjellje e tyre është në përputhje me pritshmëritë e grupit. Kjo situatë, kalon një fazë të atillë sa në paralel me stilin e grupit, kapërcen në ekstremitete që as vetë grupi nuk ia kërkon. Padyshim që të jesh pjesë e një grupi të mirë do të kontribuojë shumë në zhvillimin dhe identitetin e individit, porse ka një dallim mes të qenit pjesë e një grupi dhe të qenit skllav i tij. Ajo çfarë është e drejtë është që njeriu të jetë pjesë e një grupi të mirë me personalitetin dhe identitetin e vet.

Disa njerëz krijojnë identitetin e tyre brenda asaj çfarë quhet “Izolimi social”. Këta lloj njerëzish, izolojnë veten brenda ambienteve që gjenden, jetojnë pa krijuar komunikim me njeri. Krijojnë një frikë të brendshme mbi tërheqjen e vëmendjes së njerëzve, ndaj dhe përpiqen të sillen në atë mënyrë që të mos bien në sy as me praninë e as me mospraninë e tyre. Disa njerëz krijojnë identitetin e tyre brenda asaj çfarë quhet “Njësimi i tepruar me tjetrin”. Njësimi me të rriturit, që është një nga fazat më të rëndësishme të rinisë, e zhvillon më tej dhe përpiqet të bëhet një kopje e një të rrituri që ka parë përreth apo që ka parë përmes medias; përpiqet të jetë i njëjtë në sjellje, në reagime, në shprehje, në veshje, shkurtimisht me gjithçka të tij. Sado që mund t’i bëjë dobi njësimi me njerëz të drejtë, njësimi i tepruar e pengon njeriun të gjejë identitetin e vet dhe bën që të vonojë të zgjidhë krizën e identitetit të tij.

Disa njerëz krijojnë identitet konfliktual duke përjetuar krizë identiteti. Janë të inatosur me të shkuarën, të pashpresë për të ardhmen dhe në konflikt me të gjithë, duke treguar sjellje aspak të përshtatshme me pozicionet, moshën dhe gjendjen e tyre. Kjo situatë bën që njeriu të dëmtohet brenda proceseve dhe si përfundim, bën që të humbë besimin tek vetja dhe të urrejë veten.

Të gjitha këto janë mënyra që duhen dhënë si përgjigje ndaj pyetjes “Kush jam unë?” Ndërsa, rruga që duhet zgjedhur është vërejtja që njeriu duhet t’i bëjë vetes lidhur me pluset dhe minuset që ai ka; të shtojë pluset, dhe t’i përmirësojë mangësitë; duke pranuar të shkuarën si të shkuar dhe të sotmen si përjetimin më të mirë të mundshëm për veten; duke gjetur aftësitë dhe dhuntitë e veta. Përndryshe, do të jetë shumë e lehtë që të humbin veten e tyre në një botë ku gjenden me miliarda njerëz, që dëshirojnë të jenë sikurse ata.



TË MPREHËSH SËPATËN

Në një pyll, dy burra po prisnin pemë. Burri i parë ngrihej herët në mëngjes dhe fillonte të priste pemë. Ndërsa njëra pemë rrëzohej, ai kalonte menjëherë te tjetra. Edhe në mbrëmje e linte prerjen e pemëve disa orë pas shokut të tij.

Kurse burri i dytë pushonte ndonjëherë dhe kthehej në shtëpi pa filluar të errësohej. Pasi punuan me këtë ritëm për një javë, filluan të numëronin se sa pemë kishin prerë. Si përfundim vunë re se burri i dytë kishte prerë më shumë pemë. I pari pyeti me zemërim: “Unë punova më shumë, por ti preve më shumë pemë? Cili është sekreti i kësaj pune?”

Burri i dytë tha duke buzëqeshur:

“Nuk ekziston ndonjë sekret. Ndërsa ti punoje pa u ndalur, unë pushoja nganjëherë dhe mprehja sëpatën. Me sëpatë të mprehur priten më shumë pemë me më pak mundim.”

Për të përparuar, duhet të mprehim sëpatën. Duhet t'i ndajmë kohë vetes dhe ta vëzhgojmë jetesën tonë me një pikëpamje objektive. Duhet të përqijemi për të zhvilluar aspektet ku jemi më dobët. Ky është një kusht i domosdoshëm për të forcuar inteligjencën, shpirtin dhe karakterin tonë. Sokrati thotë: “O njeri, njihe veten!” Njohja e vetes është rruga ndërmjet pikës ku ndodhemi tani dhe pikës ku dëshirojmë të jemi. Nuk duhet të ketë ndryshim se si e shohim ne veten dhe si na shohin të tjerët. Nëse duam që të jemi të suksesshëm dhe të kënaqur me atë që kemi, duhet t'i ndajmë vetes kohë për të mprehur sëpatën.

NJË THËNIE

*“Kjo botë është një vendbanim me qera.
Nëse vendosesh si zot shtëpie, e ke të
vështirë të largohesh.”*

(Abdulaziz Bekkine)

NJË LUTJE

*“O Zot, Ti je Falës,
e do faljen, andaj më fal mua.”*

(Tîrmidhi, Deavat, 84.)

FAKTE INTERESANTE

- Bima që rritet më shpejt në botë është bambuja. Ajo zgjatet deri në 90 cm në ditë.
- Devetë kanë tre palë vetulla.
- Hëna e plotë është nëntë herë më e shndritshme se gjysmehëna.

Vlera e përmendjes së ALLAHUT

— Ferit Piku —

Allahu (xh.sh.), në Kuranin famëlartë thotë: **“O besimtarë, më kujtoni Mua, t’ju kujtoj edhe Unë ju, më falënderoni dhe mos më mohoni”**. (Bekare, 152)

Dua të flas dy fjalë për përmendjen e Zotit, për përmendjen e emrit të Allahut (xh.sh) me zemrat tona dhe me gjuhën tonë. Njëherë një grup njerëzish të varfër shkuan tek profeti (a.s), që t’i kërkonin diçka. Çfarë mund të kërkojë një i varfër?! Ai mund të kërkojë një kafshatë bukë, diçka për të veshur, një vend ku mund të fusë kokën e tij. Por për çudi ata nuk i kërkuan asgjë nga këto, por thanë: “O profet i Zotit na e kaluan të pasurit në punë të mira. Ata falen siç falemi dhe ne, agjërojnë siç agjërojmë edhe ne, bëjnë punë të mira si ne, por ata kanë pasuri me të cilën japin sadaka, ndërsa ne nuk kemi se çfarë të japim, prandaj ata na e kanë kaluar”.

Profeti (a.s) u tha: **“Mos mendoni se nuk ka të mira për ju. A t’ju mësoj një sekret, që po ta veproni, do t’ua kaloni pasanikëve nga vëllezërit tuaj”**? Ata u përgjigjën: “Posi jo o profet i Zotit, na e trego atë sekret”. Profeti (a.s) tha: **“Thoni pas çdo namazi 33 herë Subhanallah, 33 herë Elhamdulilah dhe 33 herë Allahu ekber. Nëse e bëni rregullisht këtë punë, do t’ua kaloni vëllezërve tuaj”**.

Këta njerëz u kthyen të gëzuar me sekretin, që u kishte mësuar profeti (a.s), siç kthehet dikush që ka gjetur nje thesar të madh dhe do që ta mbajë vetëm për vete. Por pas disa kohësh këta njerëz kthehen përsëri tek profeti (a.s) dhe i thonë: “O Profet i Zotit,

vëllezërit tanë e mësuat sekretin. Tani edhe ata e bëjnë atë dhikër dhe kemi frikë se do të mbetemi pas tyre me sevape”.

Atëherë profeti (a.s) tha: **“Ajo është mirësi prej Zotit dhe unë s’mund ta ndal atë, por ju mundohuni t’ua kaloni atyre me këtë gjë (bëni dhikër më shumë se ata)”**.¹

A e dini se njeriu thotë nga 12 000 deri në 17 000 fjalë në ditë?! Sa përqind të këtyre fjalëve i përdorim për të përmendur Zotin? Ne kalojmë me orë të tëra nëpër kafene, duke bërë muhabete nga më të ndryshmet. Sa e përmendim Zotin në këto biseda? Bëji një llogari të shkurtër vetes tënde. Sa përmendet Zoti në debatet, në fjalimet, në tubimet apo në bisedat që bëjmë me njëri – tjetrin? A e di se vetëm fjalët në të cilat përmendet Zoti, do të kenë kuptim. Pra nga 17 000 fjalë, sa prej tyre e përmendim Zotin: 10, 100, 1000, më shumë apo më pak?! Vallahi kam frikë se shpeshherë as 10 fjalë nuk themi për të përmendur Zotin, sepse shejtani na e ka harruar përmendjen e Zotit, vetja jonë, angazhimi me këtë dynja dhe gjithçka që ka në të, na ka larguar nga përmendja e Zotit.

Na ka rastisur shpesh që në shtëpitë tona, nis muhabeti me fjalë të ëmbla dhe pastaj të gjithë marrosen. Pse kanë kaq shumë probleme njerëzit. Pse vuajnë kaq shumë nga sëmundjet psikike, nga streset, nga mbingarkesa nervore? Sekretin është se nuk përmendet Zoti. Aty ku nuk përmendet Zoti, aty

1. **Hadith i vërtetë**. Buhariu (6329) dhe Muslimi (595, 596).

nuk ka harmoni, paqe e qetësi, sepse Allahu (xh.sh) thotë në Kuranin fisnik: **“Kush i kthen shpinën përmendjes së emrit Tim, Unë do ta bëj, që ta jetojë jetën e kësaj dynjaje të zymtë”**. (Ta Ha: 124). Mos ia kthe shpinën Zotit dhe përmendjes së Zotit, se vallahi do të vuash. Vetëm zemra e di se çfarë heq, kur nuk përmendet Zoti. Allahu thotë në Kuran: **“Ditën e Kijametit Unë do ta ringjall atë të verbër. Thotë njeriu: O Zot pse më ngjalle të verbër, unë kam shikuar në dynja. Thotë (Allahu): Robi Im a nuk të erdhën ty argumentet e Mia dhe ti i harrove ata. Sot të ringjallim ty të verbër, siç e harrove ti Zotin ashtu të harron edhe Zoti ty sot”**. (Ta Ha: 125-126).

Dhikri, pra përmendja e Zotit është një nga adhurimet më të bukura dhe më të lehta. Përmendja e Zotit është adhurimi më i bukur dhe më i lehtë. Është i lehtë, sepse Zotin mund ta përmendë i pasuri dhe i varfri. Ky adhurim nuk do para, nuk do mundim fizik. E përmend Zotin ai që po ha bukë, ai që bëhet gati për të fjetur, ai që po nget makinën, ai që po ecën i vetëm. Përmendja e Zotit është një adhurim, që nuk do shpenzim energjish.

Nga ana tjetër është adhurimi më i bukur, sepse ka shpërblimin më të madh. Vallahi ky adhurim e ka shpërblimin më të madh. Njëherë profeti (a.s) u tha shokëve të tij: **“A e dini se keni një adhurim shumë të bukur, por që ju e harroni. Vallahi është më i vlefshëm sesa dikush prej jush të japë florinj në rrugë të Zotit, është më i madh se lufta në rrugë të Zotit”**. Shokët e tij e pyetën: “Cili është ky adhurim o profet I Zotit”? Profeti (a.s) tha: **“Ta përmendësh Allahun (xh.sh)”**.²

Përmende Zotin pa pushim, sepse ka vlerë më shumë se sadakaja dhe xhihadi në rrugën e Zotit.

Pse e obligoi Allahu (xh.sh) namazin, agjërimin, haxhin dhe leximin e Kuranit? Sepse me këta adhurime përmendet Zoti dhe nuk ka më mirë, se kur ti e ndjen veten afër Zotit.

Kush e përmend Allahun (xh.sh), le ta dijë se atë e përmend vetë Zoti i gjithësisë. Allahu (xh.sh) thotë: **“Unë jam për robin, ashtu siç mendon ai për Mua. Nëse ai më kujton në veten e tij, edhe Unë e kujtoj në Veten Time. Nëse robi më përmend në një kuvend, Unë e kujtoj në kuvende më të mira se të atij”**.³

Nëse njeriu e përmend Zotin qotë edhe në fund të ujit, ajo përmendje shkon tek Allahu (xh.sh).

Junusi (a.s) ishte profet i Zotit. Ai e pa veten në fund të detit, në barkun e balenës, për një gabim që ai bëri. Por në këto momente e kuptoi gabimin e tij dhe tha dy fjalë: “I lartësuar je Ti o Zoti im, unë i bëra padrejtësi vetes time”. Kur po i thoshte këto fjalë, melekët I thoshin Zotit: “O Zoti Ynë! Ne

po dëgjojmë një zë të njohur, që vjen nga një vend i panjohur”. Melekët nuk e kuptonin se nga vinte zëri. Allahu (xh.sh) u thotë: **“Është zëri i robit Tim, Junusit. Ai po përmend emrin Tim, prandaj nxirreni prej andej”**. (Sad: 41). Pastaj Zoti e urdhëroi balenën, që ta nxjerrë Junusin në breg të detit.

Ndonjëherë e ndjejmë zemrën të ngurtë në vetet tona. Tamam sikur dikush të ketë vënë një gur në vend të zemrës dhe të rëndohet kraharori. Kjo ndodh, sepse nuk përmendet Zoti. Allahu (xh.sh) thotë në Kuranin fisnik: **“Me përmendjen e Zotit qetësohen zemrat”**. (Rrad: 28). Është tamam si toka, që plasaritet dhe vetëm uji e mbledh atë dhe i jep jetë. Kështu ndodh edhe me zemrën e njeriut. Vjen një moment që ajo bëhet si hekur apo si gur. Nëse ndodh diçka e tillë, dije se ajo zemër nuk e ka përmendur Zotin. Allahu (xh.sh) duhet përmendur shpesh.

Njëherë dikush i tha profetit (a.s): “O profet i Zotit! Adhurimet janë shtuar shumë e nuk mund t'i bëj dot të gjitha, por më trego për një punë, që po ta bëj, do ta ndjej veten mirë”. Profeti (a.s) i tha: **“Mbaje gjuhën të lagur nga përmendja e Zotit”**.⁴

Njeriu ndjen kënaqësi nga pasuria apo nga fëmija i tij. Por betohem në Zot, se nuk ka kënaqësi më të madhe sesa ajo e përmendjes së Zotit, me kusht që ta ndjesh atë që po thua. Duhet ta mundosh veten shumë, derisa të arrish që ta përjetosh dhikrin e Zotit. Nëse e arrin këtë, dije se ke arritur kulmin e kënaqësisë. Ekziston një thënie e bukur: “Nëse e përmend Zotin, nuk mërzhitesh dhe nëse mërzhitesh, nuk e ke përmendur aq sa duhet”.

Ka pasur njerëz që kanë pasur aq shumë pasuri, sa askush nuk krahasohej me ta. Sulejmani (a.s) pati pushtetin e njerëzve, xhindëve, kafshëve, erës dhe ujit, por ai nuk e krahasonte atë kurrë me përmendjen e Zotit. Thonë që njëherë një bujk pa ushtrinë e Sulejmanit (a.s). Ai hapi sytë dhe tha: “La ilahe il Allah, sa e madhe qenka pasuria jote o Sulejman”. Sulejmani (a.s) iu afrua dhe i tha: “O njeri i mirë mos u mashtro prej kësaj. Vallahi sikur njëherë të thuash “Subhanallah”, kjo është më e madhe se gjithë ushtria ime. E gjithë ushtria do të ikë një ditë dhe do të mbetet vetëm fjala SUBHANALLAH.

Prandaj besimtarët, që e përjetonin dhikrin (përmendjen) e Zotit, thoshin: “Sikut ta dinin mbretërit, se çfarë kemi në zemrat tona, do të mundoheshin të na e merrnin qoftë edhe duke na hapur kraharorët tanë me shpatat e tyre”. Ky është efekti i përmendjes së Zotit, i qetësisë që gjen njeriu kur rri duke përmendur Allahun (xh.sh).

Do përmend shumë shkurt disa hadithe, që tregojnë vlerën e përmendjes së Zotit dhe gabimin e madh që bëjmë, kur nuk e përmendim Zotin”.

- Profeti (a.s) ka thënë: **“Kush thotë gjithmonë**

2. **Hadith i vërtetë**. Ahmedi (6/446) dhe Tirmidhiu (3377). Shejh Albani dhe shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të vërtetë.

3. **Hadith i vërtetë**. Buhariu (7405) dhe Muslimi (2675).

4. **Hadith i vërtetë**. Tirmidhiu (3375) dhe Ibn Maxheh (3793). Shejh Albani dhe shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të vërtetë.

“ESTAGFIRULLAH” (duke e ndjerë këtë fjalë), **Zoti do t'ia zgjidhë çdo hall dhe do ta furnizojë atje ku nuk ia pret mendja**.⁵

- Profeti (a.s) ka thënë në një hadith tjetër: **“Kush thotë SUBHANALLAHU UE BIHAMDIHI 100 herë, Zoti do t'ia shlyejë mëkatet atij njeriu, edhe sikur të jenë sa shkuma e detit**”.⁶ Provoje se sa kohë të merr thënia e kësaj fjale. Jo më tepër se dy minuta. Nëse e thua me gjithë zemër, t'i fshin Zoti mëkatet, edhe sikur të ishin sa shkuma e detit dhe kjo ndodh në harkun kohor të dy minutave. A e shikon se çfarë tregtie e madhe është, të cilën për fat të keq e humbasin shumë njerëz?!

- Profeti (a.s) ka thënë: **“Fjala më e mirë që kam thënë unë dhe të gjithë profetët e tjerë para meje është fjala LA ILAHE IL ALLAH**.”⁷ Besimi vjetërohet në zemrat tuaja, prandaj ripërtërijeni atë me fjalën **LA ILAHE IL ALLAH**”.⁸

- Profeti (a.s) ka thënë: **“Kush thotë ELHAMDU-LILAH, i mbushet peshorja e tij**”.⁹

- Gjithashtu profeti (a.s) ka thënë: **“Kush thotë 100 herë LA ILAHE IL ALLAH UAHDEHU LA SHERI-JKE LEH, LEHUL MULKU UE LEHUL HAMDU UE HUUE ALA KUL-LI SHEJ-JIN KADIR, është sikur të ketë liru për çdo ditë nga 10 skllëvër, sikur të ketë fituar 100 sevape, t'i jenë fshirë 100 të këqija. Pasha Zotin atë njeri nuk e gjen e keqja prej shejtanit nga mëngjesi deri në mbrëmje dhe nuk ka njeri më të mirë se ai, përveç atij që e ka thënë këtë fjalë më shpesh**”.¹⁰ Kjo është përmendja e Allahut (xh.sh).

Le ta përmendim Zotin tonë, kur jemi mirë dhe kur jemi keq, kur jemi të gëzuar dhe kur jemi të mërzhitur. A e ke provuar ndonjëherë ta përmendësh Zotin kur je i nevrikosur?! A të ka ndodhur që të gjendesh i vetëm e të mos dish se çfarë të bësh?! Mos mendo kurrë se ke kohë të lirë dhe nuk di si ta shfrytëzosh, por përmende Zotin se do ta ndjesh kënaqësinë e besimit tënd. Përmende njëherë Allahun (xh.sh) dhe le të rrjedhin lot sytë e tu për Zotin e gjithësisë, sepse ai sy që loton për Zotin, atë sy nuk e prek kurrë zjarri i xhehenemit.

Përmende Zotin kur ta veshësh një rrobë, përmende Zotin kur të hash, kur të ngrihesh nga ushqimi, kur të dalësh nga shtëpia, kur të futesh në shtëpi, apo kur të nisësh për udhëtim. Përmende Zotin në çdo situatë. Nëse je afër Zotit, Ai do të të mbajë gjithmonë afër dhe nuk humbet as në këtë

jetë as në jetën tjetër.

Vallahi fjalët për dhikrin e Zotit nuk kanë fund. Ne mund të justifikohemi duke thënë: “Vallahi nuk di t'i them arabisht”. Dikush tjetër mund të thotë: “Vallahi jam i zënë me punë të tjera”. Por ta dini mire, se kush e do diçka, e gjen atë, qoftë edhe nën tokë.

Nëse nuk ke mundësi ta përmendësh Zotin në çdo hap të jetës tënde, mos harro ta përmendësh Zotin kur fal namaz, përmende Atë në shtëpinë e Tij, në xhami. A nuk e keni vënë re një fenomen të pahijshëm, që për fat të keq është përhapur tek besimtarët?! Mbaron namazi dhe të gjithë turren kush e kush të dalë më parë jashtë xhamisë. A mos ka ndonjë gjë me kaq shumë vlerë, që të gjithë garojnë se kush të dalë më parë nga xhamia?! A mos ka xhevahire, margaritarë, pasuri, kënaqësi jashtë xhamisë, të cilat presin të parin që del nga xhamia për t'i marrë ato?! Kënaqësia është në xhami, por kjo do durim, duhet ta mundësh veten. Në fillim do ta kesh vështirë të thuash 33 herë SUBHANALLAH, por nëse e mund veten një herë, dy apo tre herë vetëm për pesë minuta, do fillosh ta shijosh në zemër ëmbëlsinë e përmendjes së Zotit. Nëse ke punë, dil dhe përmende Zotin gjatë rrugës, por mos bëj zhurmë kur del jashtë xhamisë. Nëse ti nuk e përmend dot Zotin në xhami, apo të duket se nuk ke nevojë ta përmendësh Zotin, atëherë të paktën lere vëllain tënd ta përmendë Zotin.

Kur të jesh vetëm, mundohu ta përmendësh Zotin. E di që është e vështirë, por duhet ta luftosh shejtanin në këto momente. Nëse arrin ta përmendësh Zotin në vetmi dhe të të rrjedhin sytë lot, dije se je në një nga 7 grupet, që do të jenë nën hijen e Arshit të Zotit, atë ditë kur dielli do të afrohet një milje mbi kokat e njerzve dhe nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së Arshit të Zotit.

E lus Zotin e gjithësisë me cilësitë e Tij më të larta dhe me emrat e Tij më të bukur, që të na ndihmojë të gjithëve, ta përmendim Atë. E lusim Zotin t'i mbushë zemrat tona me përmendjen e emrit të Tij, t'i zbusë zemrat tona me emrat e Tij të bukur. Zoti i bëftë shtëpitë tona, vende ku përmendet Zoti i gjithësisë. Zoti na mundësoftë që ta mbyllim jetën tonë më fjalën **LA ILAHE IL ALLAH, MUHAMEDUN RESULULLAH**. E lus Allahun (xh.sh) t'i falë gabimet tona, neglizhencën tonë dhe t'i mbushë zemrat tona me përkujtimin e Tij. Allahu na ndihmoftë që ta përmendim Atë kur jemi në këmbë, kur jemi ulur apo kur jemi shtrirë. E lus Zotin që të na bëjë ne shkak për triumfin e Islamit. Allahu na faltë ne, fëmijët tanë, prindërit tanë, të gjithë muslimanët kudo që janë. Allahu na mundësoftë që jetën ta jetojmë si muslimanë, shpirtin ta japim si besimtarë dhe të na ringjallë bashkë me profetin (a.s).

Amin!..

5. **Hadith i dobët.** Ebu Daudi (1518) dhe Ibn Maxheh (3819). Shejh Albani dhe shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të dobët.

6. **Hadith i vërtetë.** Buhariu (6405) dhe Muslimi (2691).

7. **Hadith i pranuar për shkak të dëshmime përforcuese.** Tirmidhiu (3585). Shejh Albani dhe shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të pranuar për shkak të dëshmime përforcuese.

8. **Hadith i pranuar.** Ahmedi (2/359). Shejh Ahmed Shakiri e vlerëson hadithin të pranuar.

9. **Hadith i vërtetë.** Muslimi (232).

10. **Hadith i vërtetë.** Buhariu (3293) dhe Muslimi (2691).



DHIKRI, MENDIMI DHE MEDITIMI

— M. Sami Ramazanollu —

Që një besimtar të zhvillohet në shtatë cilësitë e nefsit/egos së vet, ai duhet të edukojë dhe të pastrojë shtatë qendrat e trupit të tij me dhikër, mendim dhe meditim. Këto shtatë qendra të trupit, janë: Kalb, ruh, sir, hafi, ahfa, nefsi dhe xhesed.

Pesë të parat, pra kalb, ruh, sir, hafi dhe ahfa janë prej “alem-i emr/botës metafizike”. Ndërsa “anasir-i erbaa/katër elementet” që përmbajnë nefsi/egoja dhe xhesedi/trupi, që janë, zjarri, ajri, uji dhe toka, janë prej “alem-i halk/botës fizike”. Qendrat që janë prej botës metafizike, janë shpirtërore dhe të ndritshme, ndërsa të tjerat që janë prej botës fizike, janë materiale dhe të errëta. Ajo që i dallon njerëzit prej kafshëve, janë “letaif-i hamse/pesë qendrat” (kalb, ruh, sir, hafi, ahfa). Kur drita pranë zemrës fillon të shkëlqejë, kjo botë duket e pavlerë, sepse zemra është vendi i vetëm që ndriçon drita e njohjes së Allahut, prej nga ku lind edhe dielli i besimit. Aty fshihen edhe të gjitha sekretet hyjnore. Me lindjen e atij dielli të vërtetë hyjnor në zemër, këto vepra të shndritshme shfaqen në të gjitha organet e njeriut. Pikërisht atëherë ai i kryen me dëshirë dhe kënaqësi të thellë detyrat e tij të devotshmërisë.

Përçimi i rehatisë së zemrës në trup, shpjegohet në këtë mënyrë në një hadith fisnik të shënuar në Sahihun e Buhariut:

“Bëni kujdes! Në trupin e njeriut ndodhet një copë mishi, e cila nëse është e mirë, të gjitha organet e tjera të trupit janë mirë. Por nëse ajo është e prishur, prishet i gjithë trupi. Ajo copë mishi është zemra!”

Ja pra, nëse zemra është e mirë, arrihet lumturia. Dashuria për hir të Allahut fillon në zemër. Në këtë mënyrë, mund të arrihet lehtë edhe synimi i dëshiruar që është bashkimi, mirëkuptimi dhe familjarizimi me besimtarët. Vëllezër të tillë të fesë, e ndihmojnë njëri-tjetrin me gjithë shpirt. Mirëpo, nëse ndërmjet njerëzve lindin ndasi në mendime, fillojnë dhe shfaqen rezultate të padëshiruara, përçarje dhe përfundime të hidhura. Këto ajete fisnike urdhërojnë për ruajtjen nga përçarjet dhe forcimin e bashkimit dhe të dashurisë ndërmjet besimtarëve:

“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë! Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut

(Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër...” (Al-i Imran, 102-103)

Siç theksohet edhe në komentimin e këtij ajeti fisnik, fiset Eus dhe Hazrexh, edhe pse ishin prej një nëne dhe një babai, pas një kohe të gjatë, kur ishin shumë mjaft, midis tyre u shtua urrejtja dhe armiqësia, duke hyrë kështu në luftëra të përgjakshme me njëri-tjetrin. Mirëpo, Allahu i Madhëruar, me dritën e Islamit e ktheu në dashuri, urrejtjen dhe armiqësinë ndërmjet tyre.

“Mos u bëni si ata që, pasi u erdhën provat e qarta, u përçanë dhe u grindën. Për këta do të ketë dënim të madh!” (Al-i Imran, 105)

“Binduni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t’ju lërë fuqia. Bëhuni të durueshëm, se Allahu, me të vërtetë, është me të durueshmit.” (Enfal, 46)

*

Nefsi/Egoja ka shtatë cilësi të këqija:

Pëlqimi i vetvetes, mendjemadhësia, syfaqësia, zemërimi, smira, dashuria për pasuri dhe pozitë. Edhe Xhehenemi ka shtatë dyer. Kush e pasturon egon e vet prej këtyre cilësive të këqija, këto shtatë dyer të Xhehenemit i mbyllën dhe ai hyn në Xhenet.

*

Tre gjëra janë tregues të prishjes së zemrës:

1. Pakënaqësia prej bindjes ndaj Allahut.
2. Mungesa e frikës nga rënia në gjynah.
3. Mosmarrja mësim prej vdekjes së të tjerëve.

*

Katër gjëra janë tregues të poshtërsisë

1. Syri që nuk qan.
2. Zemra e ngurtë (që nuk drithërohet).
3. Dëshirat e pafundme.
4. Pasioni dhe lakmia e tepërt për këtë botë.



A legjitimon Dashuria çdo gjë?

Melike Shahin

Zoti ynë, i Cili zotëron cilësinë “el- Vedud”, është burimi i dashurisë dhe është Ai që u ka dhuruar njerëzve dashuri... Çdo krijesë e ka marrë dashurinë nga Ai; një akrep, një gjarpër që do të voglin e vet... Dashuria është diçka hyjnore...

Allahu ua ka dhuruar dashurinë njerëzve... Nën-at, që janë simbol i dashurisë dhe dhembshurisë janë gati të sakrifikojnë çdo gjë për hir të fëmijëve të vet... Librat dhe historia na flasin për njerëz që kanë dhënë jetën për dashurinë, për njerëz jeta e të cilëve është bërë burg si pasojë e vuajtjeve të dashurisë e për të tjerë që kanë kaluar male dhe fusha për hir të këtij pasioni... Dashuria është një fuqi e papërballueshme...

Dashuria nuk vjen me porosi. Një njeri nuk e ka në dorë që ta dojë dikë apo që ta urrejë atë... Zemra nuk bindet me arsye.

Kjo do të thotë që zemra mund të dashurohet me atë që ka dëshirë, me atë njeri për të cilin ndjen diçka? A nuk ka dashuria asnjë kufi, asnjë rregull? Sigurisht që ka. Arsyja dhe logjika janë cilësitë që e ndajnë njeriun nga të gjitha gjallesat e tjera. Njeriu e kalon dashurinë nga filtrat e mendjes. Nuk vrapon pas saj para se të dëgjojë zërin e matur të arsyes.

Allahu i ka dhuruar shumë të mira njeriut. Në goftë se do të fillonim të numëronim të gjitha të mirat që zotërojmë nuk do t'ia dilnim dot. Syri, veshi, dora, këmba janë disa nga organet kryesore që na ndihmojnë për të krijuar lidhje me botën e jashtme; ato janë dritaret tona. Mendja, shpirti dhe ndërgjegjja janë qendrat e vlerësimit; ato studiojnë të dhënat që na vijnë nga jashtë. Në goftë se ne nuk kontrollojmë dot këto të fundit

atëherë jemi të detyruar që të kontrollojmë organet që dërgojnë këto sinjale. E thënë më qartë: Duke qenë se kontrolli i zemrës është i vështirë, duhet që t'u presim rrugën sinjaleve që vijnë nga jashtë. Ne duhet të qëndrojmë larg imoralitetit sepse në një vend rrëshqitës është vështirë që të frenosh, shumë herë është e pamundur.

Allahu do t'i marrë në llogari të gjithë pejgamberët me radhë dhe çdo individ të thjeshtë. Kjo llogari do të jetë kaq e detajuar sa të gjitha organet e njeriut do të fillojnë të flasin dhe të tregojnë se çfarë kanë bërë në këtë botë; syri, këmba, dora, lëkura do të jenë dëshmitarë. Në suren Jasin na tërhiqet vëmendja nga ajeti:

“Sot, Ne do t'ua vulosim atyre gojë e do të Na flasin duart e tyre dhe do të dëshmojnë këmbët e tyre për atë që kanë bërë.” (Jasin, 65)

Njeriu duhet që vazhdimisht ta ketë mendjen tek dita në të cilën do të japë llogari. Sot kemi mundësi që t'i mashtrojmë të gjithë njerëzit që na rrethojnë, edhe veten; por atë ditë asnjë justifikim nuk do të jetë i vlefshëm dhe e vërteta do të dalë në shesh.

Pas këtyre dijeve themelore, mund t'i japim një përgjigje pyetjes që kemi parashtruar në fillim:

Sigurisht që dashuria ka burim hyjnor dhe njeriu në të shumtën e rasteve nuk e zgjedh vetë njeriun që dashuron. Njeriu sprovohet nga i/e dashura. Nganjëherë bashkohet me njeriun e zemrës e nganjëherë nuk ia arrin qëllimit... Ne të gjithë e dimë që kjo botë është e mbushur me sprova nga më të ndryshmet.

Personi që bashkohet me njeriun e zemrës sprovohet duke u munduar që t'i provojë partnerit që është i denjë për të. Të dy të dashuruarit kalojnë nga sprova e dashurisë. Në qoftë se njeriu e harxhon të gjithë dashurinë që mban në zemër vetëm ndaj një njeriu do të dëmtojë veten dhe njeriun që do. Nganjëherë një dashuri e gabuar bëhet shkak për vuajtje të rënda në këtë botë dhe në tjetrën.

Edhe njeriu që nuk bashkohet me të dashurin e zemrës është në sprovë. Në qoftë se është e shkruar që të bashkohet me dikë tjetër, zemra i sprovohet dy herë. Në cilat limane i shëtisin zemra, trupi dhe mendja... Por në qoftë se i nënshtrohet kaderit të vet me sinqeritet, çdo gjë merr një kuptim tjetër... Në momentin kur njeriu nuk i nënshtrohet përcaktimit të Allahut, zemra e tij është e trazuar dhe shejtani e egoja i ngrenë kurthe pa reshtur. Një njeri i tillë nuk duhet ta harrojë asnjëherë ajetin:

“Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjitha këta do të merren në përgjegjësi.” (Isra, 36)

Njeriu që bashkohet me atë që do duke e shikuar këtë veprim si një shkallë dhe jo si një stacion të fundit, afrohet me Allahun.

Edhe njeriu që nuk bashkohet me të dashurin fiton sevape nga malli që ndjen. Ajo që njeriu fiton prej mallit humbet në momentin e takimit. Njeriu i virtytshëm që digjet në zjarrin e dashurisë por që nga frika e ndëshkimit të Allahut nuk del nga veprimet e lejuara, do të ketë shpërblime në këtë botë dhe në Ahiret. Pejgamberi ynë i nderuar ka dhënë lajmin e mirë për kënaqësinë e përgjeshme të besimit që do të ndjejnë këto njerëz të virtytshëm.

Allahu e njeh shumë mirë njeriun edhe shejtanin mashtrues sepse Ai i ka krijuar të dy. Zoti ynë i di edhe ndjenjat e përkohshme që kalojnë në zemrën tonë edhe fidanët e dashurisë që lulëzojnë në të. Njeriut që i frikësuar nga shkelja e rregullave të fesë ruhet nga dashuria e vet, Allahu i dhuron mirësi pafund.

Pejgamberi ynë i nderuar salallahu alejhi ve selem, ka thënë:

“Njeriut që e fsheh dashurinë, e ruan nderin e vet dhe bën durim; Allahu ia fal mëkatet dhe e vendos atë në Xhenet.” (Ibn Asakar)

“Ai që vdes duke e fshehur dashurinë dhe ruajtur nderin është dëshmor (shehid).” (Hakim, Hatib)

“Njerëzit më të lartësuar të ymetin tim janë ato që e ruajnë nderin kur janë në telashin e dashurisë.” (Dejlemi)

Le t'i hapim duart dhe t'i lutemi Zotit tonë:

O Allah që ke krijuar dashurinë;

Ti që na do dhe që na ke dhënë edhe neve pjesë nga dashuria Jote!..

Na bëj që të duam njerëzit që na afrojnë me Ty. Bëj që punët, fjalët dhe veprimet tona të jenë të dashura tek Ti. Na dhuro neve një fat që të mos na shuhet kurrë dashuria që ndjejmë për Ty. Bëj që të jemi larg punëve dhe fjalëve që mund të na largojnë nga Ti. Na afro me njerëzit e Tu më të dashur. Bëj që drita e tyre të ndriçojë zemrat tona. Bëj që të duam robërit e Tu më të dashur dhe të ndjejmë mall për to. O Allah na ruaj neve nga njerëzit që Ti nuk i ke bekuar me dashurinë Tënde, nga njerëzit me zemër, fytyrë e punë të zezë. Amin, o Muin...



BESNIKËRIA

Fatma Nur Xhihan

Kuptimi në fjalor i fjalës besnik është mbajtja e fjalës. Një mënyrë tjetër për ta shpjeguar është: të qenit i drejtë, përkimi i mendimeve me veprimet dhe të pasurit e një zemre të mirë...

Allahu u ka kërkuar robërve të Vet që të jenë të drejtë, një besim të pandotur me mohim dhe rebelim, një zemër të mbushur me drejtësi dhe pastërti... Arrijtja e një imani të tillë është i mundur vetëm me qëndrimin bashkë me njerëzit e drejtë.

Kjo besnikëri është kërkuar edhe prej të gjithë peygamberëve. Allahu ka dëshiruar që peygamberët të jenë shembuj të mirë për të gjithë njerëzit në të gjitha kohërat. Allahu do t'i begatojë me të mirat e veta të gjithë njerëzit të cilët i qëndrojnë besnikë. Për të gjithë njerëzit që do të zbatojnë rregullat e fesë është premtuar Xheneti si shpërblim. Allahu (xh.sh.), ka premtuar se njerëzit besnikë do të jenë së bashku me peygamberët, dëshmorët dhe njerëzit me moral të lartë. Sa shoqëri e mirë është kjo! Allahu u ka dhuruar atyre vende në Xhenet pranë të cilave rrjedhin lumenj të pashtershëm. Allahu është i kënaqur prej tyre edhe ata janë të kënaqur nga Allahu. Kjo është rruga e vërtetë e fitores.

Siç e kuptuam, besnikëria është zgjedhja e të gjithë njerëzve të dashur të Allahut. Sigurisht që në këtë rrugë mund të futemi vetëm me ndihmën e Krijuesit tonë dhe patjetër që qëndrimi në të bëhet i mundur vetëm me anë të ndihmës së Tij. Mendja dhe arsyeja e ndihmojnë njeriun që të shkojë rrugës së drejtë, por shpëtimin Allahu (xh.sh.) ua dhuron njerëzve që dëshiron.

ATA QË NUK JANË BESNIKË NDAJ ALLAHUT

Njerëzit që nuk janë besnikë në të kryerit e de-

tyrave të tyre fetare nuk ka se si të jenë besnikë me njëri-tjetrin. Lidhjet e tyre me njerëzit në përgjithësi janë plot gabime dhe shpeshherë bazohen në përfitime. Besnikëria e tyre sipërfaqësore është e bazuar vetëm në interesa vetjake.

Ai që nuk është besnik ndaj Krijuesit të vet nuk mund të jetë besnik ndaj shoqërisë, familjes apo kolegëve të punës. Njeriu, miqtë e tij duhet t'i kërkojë mes njerëzve që janë të drejtë në fenë islame, sepse në të kundërt, në momentin e parë që do të gjendet në vështirësi do të mbetet i vetëm dhe pa ndihmë. Bile mund të ndodhë edhe më keq se kaq dhe të jenë vetë ata "shokë" që ta fusin atë në grackë.

Allahu ka bërë që besimtarët të jenë miq me njëri-tjetrin. Myslimani është shok me atë që e thërret në rrugë të drejtë, e këshillon për mirë, fal namazin dhe jep zekatin. Shoqëria e një besimtari nuk ngjason asnjëherë me shoqërinë e jobesimtarit, sepse ky i fundit fton vazhdimisht për në rrugën të gabuar...

BESIMTARËT NUK MARTOHEN ME POLITEISTËT

Sipas Kuranit, njerëzit që nuk e duan fenë e tyre dhe Krijuesin, nuk mund të ndjejnë dashuri për njerëzit e tjerë. Besimtarët janë këshilluar me anë të këtij ajeti:

“Mos u martoni me paganet, gjersa të bëhen besimtare. Skllavja besimtare është më e mirë se pagania, edhe nëse kjo e fundit mund t'ju pëlqejë. Mos i martoni myslimanet me paganë, gjersa ata të bëhen besimtarë. Skllavi besimtar është më i mirë se pagani, edhe nëse ky i fundit mund t'ju pëlqejë. Ata ju thërrasin në zjarr, kurse Allahu, me mirësinë e Tij, ju thërret në Xhenet e falje (të gjynaheve). Ai ua shpjegon

njerëzve shpalljet e Veta, që ata të mendojnë.
(Bekare, 221)

Ky ajet na e bën shumë të qartë faktin që besimi dhe mohimi janë kufijtë më të qartë mes njerëzve. Besimtarët bëjnë përpjekje të krijojnë shoqëri dhe lidhje vetëm me njerëzit që ashtu si ata vetë, besojnë në Allahun, Krijuesin e pashoq. Në të kundërt, do të kenë fituar shokë për t'i shoqëruar në rrugën drejt Xhehenemit.

DËLIRËSIA NË MARTESË

Për besimtarët që do të martohen, tipari kryesor për të cilin duhet të kenë kujdes është dëlirësia. Në suren Nur thuhet:

“Laviri mund të martohet vetëm me laviren apo idhujtaren, kurse laviren mund ta marrë vetëm laviri apo idhujtari. Këto janë të ndaluara për besimtarët.” (Nur, 3)

Dijetarët që e kanë studiuar këtë ajet, kanë arritur në përfundimin që besimtari dhe besimtarja e kanë të ndaluar martesën me idhujtarët. Gjithashtu, besimtari dhe besimtarja që kanë kryer imoralitet mund të martohen me njëri-tjetrin. Kjo barazi që vendoset mes këtyre personave vjen nga fakti se ata e kanë të lehtë që të mos “shqetësohen” nga ky ves. Njerëzit me shpirt të pastër nuk mund të martohen me njerëz të këtij rangu, vetëm në qoftë se janë të detyruar.

Në qoftë se një besimtar apo besimtare nuk i merr parasysh këto rregulla që ka vendosur Allahu, por martohet vetëm sepse i pëlqen bukuria apo se ndjen afeksion pas dikujt, le të përgatitet për ato që do ta presin në këtë botë dhe në Ahiret.

MUNGESA E BESNIKËRISË

Mos pritni besnikëri nga një njeri që nuk adhuron Allahun dhe nuk i nënshtrohet Atij pa kushte.

Një njeri që nuk e njeh dhe nuk e do Allahun, si mund të ndjejë dashuri për krijesat e Tij? A nuk është edhe dashuria e tij false? A nuk zgjat lidhja me të deri në një moment kur nuk ka më interesa?

Ai që e njeh Allahun, ai që e do Atë dhe frikësohet nga Krijuesi për hir të dashurisë që ndjen; a nuk kujdeset edhe për krijesat e Allahut dhe a nuk përpiqet që të sillet sa më mirë me to? A nuk bëhet një prind i mirë, një burrë/ grua e mirë? Besimtari, njerëzit që e rrethojnë nuk i shikon si krijesa të cilat mund t'i përdorë, por si persona për të cilët do të japë llogari në botën tjetër. A janë të njëjta gabimet që bën një besimtar (gabime të bëra pa qëllim) me ato që bën një njeri i cili nuk ka frikë askënd?!

Në qoftë se kërkon një bashkëshort besnik, bëni përpjekje që të gjeni një njeri besnik ndaj Allahut.

Ai që është besnik ndaj Krijuesit, është besnik edhe ndaj krijesave.

DY LLOJE STREHASH FAMILJARE

Familjet që e kanë harruar Allahun dhe që besojnë se janë në rrugë të drejtë janë ato familje që kanë më shumë mundësi për t'u shkatërruar. Në këto streha familjare të gjithë pjestarët e familjes ankohen gjatë gjithë kohës. Babai ankohet për fëmijët dhe fëmijët nga babai; grua nga burri dhe burri nga grua... Kur je në gjendje të mirë ekonomike të gjithë të buzëqeshin, kur bie në vështirësi të gjithë largohen... Në kohët e rinisë dhe të bukurisë ke shoqëri me të gjithë, por kur koha kalon të shtohen vetëm lotët dhe vuajtjet. Në një shoqëri të tillë që është kryefortë në gabime, rritet edhe ndëshkimi i Allahut... Miqësia e këtyre njerëzve është false, lumturia e tyre është false dhe ashtu është edhe jeta e tyre. Ashtu si një shtëpi loje, e bërë nga kartoni, çdo gjë e tyre priset me një goditje të lehtë. Nga larg jeta e tyre duket e mahnitshme dhe tërheqëse, por brenda tyre ka vetëm gërmadha... Problemi më i vogël që e godet këtë familje është në gjendje që ta ndezë krejtësisht shtëpinë me të gjithë pjestarët e saj. Secili nga njerëzit e familjes është gati që të braktisë të afërmit e vet në pengesën e parë që i del përpara.

Një familje tjetër është ajo që është themeluar mbi bazat e Islamit... Qenia e tyre si familje është një, vuajtja përballohet bashkarisht... Çdo gjë që vjen nga Allahu mirëpritet. Ka kujtime nga ditët më të bukura të jetës edhe nga ato më të vështirat... Sofrat e plota dhe të bukura konsumohen së bashku, ashtu ndahet edhe një thërrimë buke... Nganjëherë sëmundjet dhe vështirësitë bëhen shkak që pjestarët e familjes të afrohen më shumë me njëri-tjetrin. Secili prej familjarëve është i vetëdijshëm për detyrat e veta fetare. Ata janë të frikësuar për ditën kur do të dalin para llogarisë dhe shqetësohen nga fakti se mos do të turpërohen atë ditë. Hidhërimi dhe gëzimi përjetohet nga të gjithë pjestarët njëjloj... Lumturia shtohet, kur e ndan me të tjerët, kurse hidhërimi pakësohet. Ata ndajnë kafshatën edhe problemet; ndajnë detyrat fetare dhe adhurimet. Familja përpiqet që duke kryer detyrat e veta në këtë botë të jetë në gjendje që të jetë e bashkuar edhe në botën tjetër.

Allahu bëftë që të takohemi me njerëz besnikë!.. Bëftë që ne të jemi në mesin e tyre si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër! Allahu na begatoftë me të mira në të dyja botët!

Amin!..



Zgjedhja E BASHKËSHORTIT

— Tylaj Kok —

Pyes një vajzë të re, në moshë për martesë:

“Si do të doje të ishte burri yt i ardhshëm? A e ke menduar?”

“Po, e kam menduar. Dua që të ketë tipare të rregullta, nuk po them që të jetë i bukur, por duhet që ta pëlqej, pra të ketë pak elektricitet mes nesh. Më pas, duhet të ketë shtëpi. Edhe makina është e nevojshme, një punë të mirë dhe rrogë. Nuk dua që të heq keq.”

Nëse bisedoni me njerëz që janë në moshën e martesës, do të shikoni se sa janë shtuar kërkesat materiale. Sigurisht që do të hidheni e thoni: “Pse a nuk është pasuria e rëndësishme? Në kohët tona, çdo gjë bëhet me para. Si mund të jetohej kur nuk ke as punë dhe as rrogë?” Sigurisht që e shikuar nga ky këndvështrim, njerëzit që mendojnë një gjë të tillë, kanë shumë të drejtë. Paraja është e rëndësishme dhe është bukur kur ke një shtëpi ku të fusësh kokën. Por martesë nuk ka lidhje me asnjërën prej këtyre, dhe në momentin kur zgji-

dhet personi me të cilin do të kalosh jetën, anëtarë materiale janë të fundit në listë.

Le të flasim pak për arsyet...

Le të themi se ka pasuri, ka tipare të rregullta, ka mendime të ngjashme me të tuat dhe dëshiron të martohesh me të me idenë se do të keni një jetë të qetë. Por burri juaj është i papërgjegjshëm dhe shumë dembel. Sa herë që ka një problem, shet gjërat që i kanë mbetur nga prindërit. Në vend që të punojë vetë, shfrytëzon trashëgiminë që ka. Në fund, kuptoni se nuk ju ka mbetur më asgjë në duar. Për më tepër që ai është një njeri i pamësuar të punojë.

Atëherë, mos vallë duhet të shikojmë karakterin e njeriut përpara se të shikojmë pasurinë e tij? Nga ana tjetër, as kjo nuk është e mjaftueshme sepse idealet ndryshojnë, sidomos në kohët tona që ndryshojnë shumë shpejt. Idealet dhe mendimet nuk janë të mjaftueshme për të mbajtur të bashkuar një çift.

Pasuria dhe idealet në një pikë mbarojnë dhe ndryshojnë. Po nëse këto të dyja nuk janë të mjaftueshme për të zgjedhur njeriun e jetës, çfarë është?

Ajo që e forcon një martesë është ecja në të njëjtën rrugë dhe forca për t'i luftuar së bashku të gjitha vështirësitë e jetës. Beteja e përbashkët e çiftit për të përballuar edhe sfidat më të vogla të jetës është më e rëndësishme se përpjekjet për hir të idealeve. Por këtu kemi një pengesë. Rritja e moshës së martesës.

Me kalimin e kohës, mosha kur njerëzit martohen po rritet gjithmonë e më shumë. Sa të mbaroj shkolla, të gjej punë, të bëj pajën, të kursej ca para, të blej një makinë, të bëjmë qejf me lekët e rrogës. I mendojmë të gjitha këto pa kuptuar që po na ik mosha. Pikërisht këtu fillon fatkeqësia.

Mbaron shkollën dhe je vetëm, ke blerë shumë gjëra por je vetëm, ke kursyer por je vetëm, ke pasur probleme por i ke kaluar e vetme...

Një njeri që i ka kaluar të gjitha vështirësitë i vetëm, a mund të ndiejë nevojën për t'u martuar? Në veçanti, djemtë që nuk e ndiejnë nevojën për t'u martuar janë të prirë për t'u larguar prej asaj. Djali vetëm në momentin kur dëshiron të bëhet baba, fillon ta shikojë martesën me më shumë dëshirë.

Njerëzit që edhe pse janë vetëm kanë sukses, e shohin martesën si diçka krejt të panevojshme. Mendimi "unë jam i vetëmjaftueshëm" ushqen egon. Ndërkohë, njerëzit me ego të fryrë e kanë shumë të vështirë që të lidhin jetën me dikë tjetër.

Për këtë arsye, ne kemi nevojë që ta eliminojmë idenë "sa t'i rregulloj të gjithë gjërat, pastaj do të mendoj për martesën." Në këtë pikë, prindërit kanë rol shumë të rëndësishëm. Familja nuk duhet të ketë pritshmëri të paarritshme. Teksa presim që çdo gjë të jetë perfekte, koha e çiftit kalon me shpejtësi. Mjafton që të ekzistojë diçka mesatare dhe çifti do t'i rregullojë gjërat me kalimin e kohës. Le të kenë një histori për të treguar.

Cilat janë cilësitë që duhet t'i ketë njeriu që do zgjedhim për bashkëshort?

Gjëja e parë që duhet të vëzhgojmë tek kandidati për martesë është sistemi i vlerave të tij. idealet ndryshojnë me kalimin e kohës, por vlerat që qëndrojnë në thellësi të karakterit nuk ndryshojnë. Për shembull, disa nga vlerat kryesore janë: familja, paraja, dashuria, suksesi, përgjegjësia, dëshira për

të ndihmuar, respekti, puna dhe thjeshtësia. Kur jeni duke u njohur me një njeri, mundohuni që të kuptoni se cilave prej tyre u jep më shumë rëndësi. Një burrë që ka prioritet parane nuk mund të ketë martesë të lumtur me një grua që ka prioritet ndihmën ndaj të tjerëve. Një bashkësi e përbashkët vlerash është kushti kryesor për një martesë të suksesshme. Nëse njëra palë i jep rëndësi familjes, ndërsa tjetra suksesit, familja do të ketë probleme. Një burrë që punon shumë mund ta ketë të vështirë të kalojë kohë me familjen e vet. Nëse gruaja e tij i jep më shumë rëndësi parasë se familjes, do ta kuptojë burrin e vet që punon deri në orët e vona të darkës dhe nuk do të nxjerrë probleme, por nëse është grua që vë familjen para të gjithave, martesa e tyre do të ndikohet negativisht.

Përmbledhje:

✓ Duhet të njihni mirë sistemin tuaj të vlerave. Më pas studioni atë të njeriut tjetër dhe krahasojini për të shikuar nëse keni pika të përbashkëta. Nëse është e nevojshme mund të kërkonin ndihmë nga njerëz më të mëdhenj.

✓ Mos e shtyni shumë moshën e martesës. Nëse ju del përpara një njeri që ju përshtatet, mos e shtyni më shumë me dëshirën për të pritur sa të rregullohen të gjitha gjërat.

✓ Mos i jepni rëndësinë maksimale anës materiale. Njerëzit e përgjegjshëm, të drejtë dhe punëtorë, në fund të fundit e marrin atë që duan.





Diabeti

Zgjidhja gjendet tek Ushqimi

Kur bëhet fjalë për diabetin, zgjedhjet tona ushqimore janë shumë të rëndësishme.

Pavarësisht se disa ushqime janë më të mira se të tjerat, kjo nuk do të thotë që duhet të ketë kufizime në larmshmërinë e ushqimeve që mund të konsumojmë.

Ka ushqime që etiketohen si tepër të këqija, por kjo nuk nënkupton se ato duhen shmangur tërësisht. Nëse konsumohen në sasi të vogla, këto ushqime “të këqija” janë të padëmshme.

Megjithatë kur vjen puna tek vlerat, ushqyesit dhe aftësitë për të ndihmuar në menaxhimin e diabetit, gjithmonë duhen zgjedhur ushqimet më të mira.

Trupi ka nevojë për karbohidrate. Megjithatë zgjidhni me kujdes.

DRITHËRAT

Zgjedhjet më të mira

- Drithërat e plotë si orizi kaf dhe tërshëra
- Patatja e ëmbël e pjekur
- Ushqime të bëra me drithëra të plota dhe me pak ose më mirë aspak sheqer të shtuar

Zgjedhjet më të këqija

- Drithërat e përpunuara si orizi i bardhë apo mielli i bardhë
- Drithërat jo të plotë dhe me shumë sheqer
- Buka e bardhë
- Patatet e skuqura

PERIMET

Zgjedhjet më të mira

- Perimet e freskëta, të gatuar në avull, të pjekura ose në zgarë

- Perimet e ngrira të gatuar me pak avull
- Barishtet si spinaqi dhe rukola.
- Perimet e konservuara por me pak ose me aspak kripë

Zgjidhni një menu shumëngjyreshe me barishte të gjelbra, perime të kuqe, portokalli (karrota ose specia), të bardha (qepë) ose vjollcë (patëllxhanët). Duhet të konsumoni 2 filxhanë e gjysëm me perime në ditë.

Zgjedhjet më të këqija

- Perimet e konservuara me kripë
- Perimet e gatuar me shumë gjalpë, djathë ose salcë
- Turshitë, vetëm në rastet kur duhet të kufizoni kripën, në të kundërt mund t'i konsumoni
- Lakra turshi, për të njëjtat arsye si më sipër. Nëse vuani edhe nga tensioni i lartë i gjakut duhet t'i shmangni

FRUTAT

Plotësojnë nevojat për karbohidrate, vitamina, minerale dhe fibër. Shumica përmbajnë pak yndyrë por kanë më shumë karbohidrate se perimet.

Zgjedhjet më të mira

- Frutat e freskëta
- Frutat e ngrira ose të konservuara pa sheqer shtesë
- Reçeli ose konserva frutash pa sheqer shtesë
- Puretë e frutave pa sheqer shtesë

Zgjedhjet më të këqija

- Frutat e konservuara me shurup dhe sheqer
- Reçeli, konservat, kompostot e zakonshme (mund t'i konsumoni vetëm në sasi të vogla)
- Pijet ose lëngjet me koncentrat frutash

PROTEINA

Zgjedhjet në këtë rast janë të shumta dhe përfshijnë mishin e viçit, pulës, peshkut, derri, gjeljtë të detit, frutat e detit, fasulet, djathin, vezët dhe arrorët.

Zgjedhjet më të mira

- Proteinat me bazë bimore si fasulet, arrorët dhe farat
- Peshkun dhe frutat e detit
- Pulën dhe shpendë të tjerë
- Vezët dhe produktet e bulmetit me pak yndyrë

Nëse hani mish mundohuni të zgjidhni pjesët pa dhjamë. Nëse hani mish shpendësh hiqni pjesën e lëkurës.

Përfshini proteinat bimore nga fasulet, arrorët edhe nëse nuk jeni vegjetarianë ose veganë. Nëpërmjet tyre do të merrni ushqyes dhe fibër që nuk gjenden në produktet shtazore.

Zgjedhjet më të këqija

- Mishi i skuqur
- Mishi me dhjamë
- Proshuta e derri
- Djathi
- Lëkura e shpendëve të gatuar
- Peshku i skuqur

PRODUKET E BULMETIT

Kujdes me yndyrnat dhe konsumoni sasi të vogla

Zgjedhjet më të mira

- Qumësht i skremuar ose me 1 % yndyrë
- Kos me pak yndyrë
- Gjizë me pak yndyrë
- Kremërat e bulmetit me pak yndyrë

Zgjedhjet më të këqija

- Qumështi i plotë
- Kosi i zakonshëm
- Gjiza e zakonshme
- Kremërat dhe salcat
- Akullorja e zakonshme

YNDYRNAT, VAJRAT DHE ËMBËLSIRAT

Janë të pamundura t'u rezistosh por të këqija për diabetin.

Zgjedhjet më të mira

- Burimet natyrale të yndyrnave nga perimet si arrorët, farat dhe avokatot. (kanë shumë kalori ndaj kujdes me racionet)
- Ushqimet e pasura me acidet yndyrore omega-3 si salmoni peshk ton
- Vajrat bimore

Zgjedhjet më të këqija

- Yndyrnat e plota të cilat i bëjnë keq zemrës. Lexoni etiketat dhe nëse në të shkruhet "pjesërisht i hidrogjenizuar" mos e konsumoni, pavarësisht pretendimit se ka zero gram yndyrna.
- Sasi të mëdha të yndyrnave të ngopura nga produktet shtazore apo vaji i arrës së kokosit ose palmës.

ZBULOHEK ADN-JA E KULTURËS

Pas shekujsh debatesh mbi raportin mes natyrës dhe kulturës, vjen prova e parë që edhe kultura ka një ADN të sajën, sipas një zbulimi të publikuar në revistën shkencore “Science”.

“Është një përzierje genetike shumë e çuditshme, që influencohet nga gene të heshtura, që ndonëse nuk trashëgoohen drejtpërdrejtë nga prindërit, mund të influencojnë aspekte shumë të ndryshme, nga rendimenti në shkollë tek shëndeti, madje influencën edhe moshën që do të lindë fëmija i parë deri tek numri i cigareve që mund të pihen”, thuhet në këtë zbulim të bazuar në ADN-në e më shumë se 21 000 islandezëve dhe të zhvilluar nga Augustine Kong që punon në universitetet e “Oxford” dhe atë të Islandës, si dhe në kompaninë “Code Genetics”.

“Prindërit kalojnë tek fëmijët vetëm 50% të ADN-së, por studiuesit kërkuar të shohin se çfarë peshe kanë genet që nuk transmetohen”, thekson gjenetisti Giuseppe Novelli, rektor i universitetit “Tor Vergata”.

U zbulua se edhe 50% e geneve që nuk trashëgohej kishte influencë në çdo individ nëpërmjet impaktit që këto gene kanë mbi prindërit dhe vëllezërit.

Studimi është kryer në 21 637 persona të lindur në vitet 1940 dhe 1983, në të cilët është analizuar lidhja mes nivelit të shkollimit dhe geneve që nuk janë transmetuar nga prindërit.

Nga ky studim ka dale se genet e patrashëguar të pranishëm tek baballarët kanë influencuar rreth 30% në përgatitjen shkollore të fëmijëve, ndërsa ato të mamave influencojnë shëndetin dhe sjelljet në të ushqyer.

Në përgjithësi është e qartë se ekziston një trashëgimi genetike në gjendje të influencojë individët pa një transmetim të drejtpërdrejtë.

Pas shekujsh debatesh në të cilat natyra dhe kultura janë konsideruar dy botë të papajtueshme, të dhënat e reja tregojnë se ekziston një “kulturë genetike”, në të cilën genet e patransmetuar mund të influencojnë karakteristikat e fëmijëve.

Falë këtyre të dhënave tani mund të shihen me një tjetër sy disa probleme sociale, si ato të lidhura me rendimentin shkollos, ose disa sëmundje, si për shembull ato të lidhura me shqetësime si skizofrenia apo të qenurit antisocial.

ZBULOHEK PAX7 ÇELËSI QË HAP ADN-NË

Në qeliza ekziston një çelës molekular që mund të hapë ADN-në dhe mundëson që të lexohen informacione deri tani të fshehura, shkruhet në revistën shkencore “Nature Genetics”.

Të koordinuar nga Jacques Drouin, studiuesit e Universitetit kanadez të Montrealit kanë analizuar këtë çelës të gjenit brenda dy llojeve qelizash në hipofizë, një gjendër që ndodhet në qendër të trurit dhe që rregullon shumë procese fiziologjike të rëndësishme.

Ky çelës që quhet “PAX7”, pasi hap ADN-në, bën të arritshme 2 500 zona.

“Bëhet fjalë për një numër të konsiderueshëm që tregon rëndësinë e PAX7 në zhvillimin embrional”, tha gjenetisti, Giuseppe Novelli, rektor i Universitetit të Romës, “Tor Vergata”.

“Kjo molekulë njihej më parë dhe me këtë studim

të ri, kompleks dhe të bërë mirë, kemi filluar të kuptojmë se si PAX7-a bën punën e saj”, shtoi ai.

Çdo qelizë ka të njëjtin grup gjenesh dhe ajo që i bën të dallohen, për shembull, një qelizë të zëmër nga një qelizë e lëkurës, është lloji i gjenit që qëndron aktiv.

Këtë aktivizim e rregullon një grup molekulash që quhet “faktor transkriptimi”, njësoj si një përkthyes i një libri, ndihmojnë në dekodifikimin e ADN-së.

Hapi i radhës do të jetë që të gjenden molekulat që punojnë me PAX7 për të arritur pjesë të fshehura të ADN-së.

“Një gjueti thesari që mund t’i hapë rrugën shumë terapive rigjeneruese të bazuara mbi qelizat staminale, duke na ndihmuar të kuptojmë se si të drejtojmë specializimin e këtyre qelizave në provës”, thekson Novelli.



SI FUNKSIONON TRURI KRIJUES

Shkencëtarët e Kembrixhit kanë identifikuar fusha specifike në tru ku kanë identifikuar tre rrjete të ndryshme të neuroneve që punojnë në një mënyrë veçanërisht të integruar.

Nuk është e lehtë të kemi një tru krijues dhe në fakt nuk është dhuratë për të gjithë.

Për të marrë ide të reja dhe të papritura, fusha të veçanta të tre rrjeteve të ndryshme të neuroneve duhet të punojnë në mënyrë të integruar. Këto tre rrjete janë: Rrjeti i modalitetit të paracaktuar, Rrjeti i Kontrollit Ekzekutiv dhe Rrjeti i Saliencës, ku secila prej tyre luan një rol të veçantë në procesin krijues.

E para, e përfaqësuar mbi të gjitha nga lëvorja e pasme e trurit, gjeneron ide të reja duke peshkuar në kujtesë dhe duke bërë simulime mendore; e dyta, e përfaqësuar nga lëvorja parazgjedhore, zgjedh idetë më të mira dhe i dërgon ato në rrjetin e ardhshëm, i treti, i përfaqësuar nga ana e majtë anësore, vlerëson dhe përpunon idenë përfundimtare.

Një analizë e detajuar neurobiologjike e procesit krijues është rezultat i hulumtimit të kryer nga një grup psikologësh njohës të udhëhequr nga Profesor Roger Beaty i Departamentit të Psikologjisë në Universitetin e Harvardit në Kembrixh.

Studiuesit i nënshtuan 163 subjekte në rezonancë funksionale magnetike, të rekrutuar për krijimtarinë e tyre të fortë në fusha të ndryshme artistike ose shkencore, ashtu siç bënë një detyrë që kërkonte përdorimin e aftësive kreative dhe në veçanti përdorimin e të ashtuquajturit të menduarit ndryshe.

Një lloj mendimi veçanërisht i dobishëm për gjetjen e zgjidhjeve të reja, për shembull nëpërmjet shpikjes së përdorimeve të papritura të objekteve të përbashkëta. Përkundrazi, ata që nuk përdorin mendime të ndryshme, kanë tendencë të bien në përgjigjet e mësuara më parë, nga të cilat arrijnë të largohen me vështirësi.

Perspektivat

“Kreativiteti mbetet një ndërthurje komplekse që ende do të kërkojë shumë kërkime për të zbuluar manifestimet e shumta në tru,” thonë autorët e studimit.

“Në kundërshtim me atë që ka ndodhur për disa aspekte specifike të njohjes që kanë qenë të besueshme në rajone të caktuara të trurit, kreativiteti është ndoshta produkt i mekanizmave komplekse nervore që përfshijnë tërë trurin. Pra, përveç përpjekjes për t’iu përgjigjur pyetjeve klasike se ku krijimi krijohet në tru, një drejtim premtues i hulumtimeve të ardhshme do të fokusohet në mënyrën se si mendon tërë truri në mënyrë krijuese “. Duke identifikuar qartë disa rrjete të neuroneve që përfshihen përfundimisht në të menduarit krijues, është një hap i rëndësishëm drejt kuptimit të një prej funksioneve më të larta mendore, si kreativiteti, i cili është një veçori veçanërisht dalluese e njeriut. Mendimi shkon tashmë se si, të identifikohen saktësisht shtigjet e ndryshme neurobiologjike të krijimtarisë, do të jetë e mundur të stimulohen ato, në mënyrë që të gjenerohen ide gjithnjë e më inovative dhe spektakolare.



KOPSHTI

Aromë Trëndafili



KOPSHTI
“Aromë Trëndafili”!

**Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe i kontrolluar,
staf i kualifikuar, çmime të arsyeshme,
transporti është i garantuar.**

Ju mirëpresim!



1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR

(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË



“Nuk barazohet
e mira me të keqen!
Të keqen ktheje
me të mirë
e atëherë
armiku yt
do të të bëhet
menjëherë
mik i ngushtë.”

(Fussilet, 34)

